



Komiteti Shqiptar i Helsinkit
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

RAPORT MBI SITUATËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT TË PERSONAVE TË
PRIVUAR NGA LIRIA

NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË
DHE

INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE
PENALE

MONITORIMET JANË REALIZUAR GJATË PERIUDHËS
MAJ - DHJETOR 2014

Tiranë, dhjetor 2014



Financed by the European Union



Civil Right Defenders

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinki në partneritet me Civil Rights Defenders dhe mbështetet financiarisht nga Swedish International Development Cooperation Agency, si dhe në kuadër të projektit “Së bashku për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria”, financuar nga Bashkimi Evropian.



Financed by the European Union



Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky publikim është botuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e grupit të punës dhe nuk reflekton qëndrimin e Bashkimit Evropian dhe të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Udhëheqëse e projektit: Dr. Edlira Papavangjeli
Punuan raportin: M.A. Klejda Ngjela dhe Dr. Edlira Papavangjeli
Mbledhje të dhënash: M.A. Olta Qejvani
Përkthimi: Anri Pashaj

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigada VIII-të, Ap. 10, Kati 5
P.O Box 1752
Tirane, Albania
Tel/fax: ++ 355 4 2233671
Mob: ++ 355 68 213 55 17
<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki>
E-mail: office@ahc.org.al;
www.ahc.org.al

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e botuesit.

Botues: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

TABELA E LËNDËS

HYRJE

Përmbledhje ekzekutive për situatën në institucionet policore dhe të ekzekutimit të vendimeve penale (burgje)

- a. Përmbledhje për situatën në institucionet e policisë
- b. Përmbledhje për situatën në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (burgje)

Metodologjia e vëzhgimeve

Pjesa e parë SITUATA NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË

- I. Gjetje lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet e policisë
 - 1.1 E drejta për trajtim dinjitoz
 - 1.1.1 Kushtet infrastrukturore;
 - 1.1.2 Tortura dhe keqtrajtimi;
 - 1.1.3 Procedura e marrjes në pyetje;
 - 1.1.4 Përdorimi i forcës;
 - 1.1.5 Procedura e transferimit;
 - 1.1.6 E drejta për ankesë.
 - 1.2 E drejta e njoftimit/informimit (të akuzës dhe njoftimit të familjarëve)
 - 1.3 E drejta për t'u mbrojtur me avokat
 - 1.4 E drejta për shërbim shëndetësor
 - 1.5 Të tjera

- II. Sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave në institucionet e policisë

Pjesa e dytë SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE (Burgje)

- III Gjetje lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare

3.1 Kushtet e jetesës në institucionet penitenciare;

3.2 E drejta e ankesë dhe e kërkesës;

3.3 Siguria dhe të ndjerit të sigurt

3.4 Trajtimi i të dënuarve. Rehabilitimi dhe riintegrimi; individualizimi i dënimit; program ditor.

3.5 Kujdesi shëndetësor;

3.6 Politika disiplinore në institucionet lokale penitenciare

3.7 Lejet shpërblyese dhe ato të veçanta

3.8 Punësimi

3.9 Trajtimi i grupeve në pozita të dobëta: të miturit, gratë, të sëmurët etj mendorë

3.10 Të tjera

- IV. Sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave në institucionet penitenciare

Shtojcat

Shtojca Letra dërguar autoriteteve shtetërore

HYRJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) i krijuar në 16 dhjetor 1990, ka për mision promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në përmbushje të këtij misioni, fokus i veçantë mbetet edhe monitorimi i institucioneve të policisë (drejtoritë, komisarariatet e policisë) dhe institucionet e paraburgimit dhe burgjeve në Republikën e Shqipërisë. Një nga fushat më të spikatura të punës ndër vite të KShH-së ka qënë monitorimi i respektimit të të drejtave të personave në konflikt me ligjin që gjenden në të institucionet lartpërmendur. Po ashtu, fokus i vëzhgimeve tona është zbatimi në mënyrë korrekte i kuadrit ligjor, i cili përbën edhe garancinë konkrete për trajtimin e duhur të personave të privuar nga liria.

Institucionet e policisë, gjatë realizimit të detyrës së tyre, kanë mision të dyfishtë. Nga njëra anë garantimin e qetësisë publike dhe nga ana tjetër respektimin e të drejtave të personave në konflikt me ligjin që gjenden në këto institucione. KShH e drejton vëmendjen kryesore tek trajtimi i personave në konflikt me ligjin të cilët shoqërohen/ ndalohen/ arrestohen. Bazuar në përvojën monitoruese të KShH-së, është vënë re se është pikërisht kjo periudhë e cila mbart shkeljet dhe abuzimet më kritike në lidhje me respektimin e të drejtave dhe trajtimin e personave në konflikt me ligjin.

Dimensioni tjetër i fokusit të vëzhgimeve të KShH janë institucionet e paraburgimit/burgjet. Sistemi i burgjeve në Shqipëri ka për mision të kontribuojë për një shoqëri të sigurt nëpërmjet zbatimit me efektivitet e në mënyrë humane të dënimeve me burgim, duke u mundësuar personave të cilët i janë besuar kujdesit të këtij shërbimi, ndërtimin e një mënyre jetese të pranuar sociale me rikthimin e tyre në shoqëri. Realizimi i këtij misioni kërkon jo vetëm një kuadër ligjor në përputhje me standardet dhe të drejtat e njeriut, por më së shumti varet nga zbatimi sa më korrekt i kuadrit ligjor në fuqi.

Cilësia e mirë e jetës dhe realizimi i procesit të riedukimit në një institucion penitenciar varet kryesisht nga marrëdhëniet mira të krijuara mes personelit dhe personave të privuar nga liria nëpërmjet trajtimit njerëzor dhe me dinjitet të tyre. Gjithashtu, rëndësi merr zbatimi i një programi kuptimplotë dhe i larmishëm i veprimtarive, si edhe kushtet e përgjithshme të infrastrukturës në institucion. Në këtë kuptim, klima e sigurt e krijuar nëpërmjet frymës së hapur të komunikimit mes personelit dhe personave të privuar nga liria merr rëndësi të veçantë në garantimin e sigurisë fizike dhe dinamike të këtyre personave, si edhe në riedukimin e tyre.

KShH falenderon autoritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPSSH), të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe institucione relevante të monitoruara për krijimin e hapësirave gjatë kryerjes së vëzhgimeve të kryera. Bashkëpunimi me administratën e institucioneve të vëzhguara ka qënë i mirë, i udhëhequr nga mirëkuptimi reciprok për të kryer vëzhgimet, në një atmosferë të sigurt dhe duke na garantuar privatësinë e duhur.

Qëllimi i i vizitave monitoruese në institucionet e policisë dhe atyre të burgjeve është të paraqesë gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet konkrete, për t'i ardhur në ndihmë autoriteteve përkatëse shtetërore për përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore, për respektimin e të drejtave ligjore dhe trajtimin e duhur të personave të privuar nga liria.

- **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

- **Përmbledhje për situatën në institucionet e policisë.**

Për vlerësuar situatën e respektimit e të drejtave të personave që u kufizohet liria nga ana e strukturave të policisë për vitin 2014, KShH ka realizuar 22 vizita monitoruese në disa institucione policore në të gjithë vendin gjatë muajve maj-dhjetor 2014. Këto vizita të planifikuara vëzhguese janë pjesë e misionit të KShH-së në parandalimin e shkeljeve të të drejtave dhe keqtrajtimin të shtetasve në konflikt me ligjin dhe qëmtimin nga afër të rasteve të cilat trajtohen më tej nga KShH përmes rrugëve administrative pranë institucioneve përkatëse dhe përmes rrugëve gjyqësore dhe shërbimeve ligjore falas.

Realizimit të vizitave monitoruese i ka paraprirë nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. KShH ka angazhuar në monitorime vëzhgues me përvojë të profesioneve të ndryshme si mjekë, juristë, psikologë e punonjës socialë. Realizimi i vizitave monitoruese është udhëhequr nga parimet e objektivitetit, paanësisë, si dhe e respektimit të dinjitetit të personave të privuar nga liria dhe personelit të policisë.

KShH vlerëson pozitivisht përpjekjet e drejtuesve të institucioneve të policisë për rregullimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të jashtme, si dhe të sallave të pritjes së qytetarëve të disa prej institucioneve të policisë. Gjithashtu, KShH vlerëson faktin se në përmbushje të detyrimeve ligjore për ofrimin e trajtimit dinjitoz të personave në konflikt me ligjin, nëpërmjet Urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është vlerësuar mbyllja e disa prej dhomave të shoqërimit/ndalimit/arrestimit, për shkak të gjendjes së tyre në kushte që s'i përlligjen standardeve minimale ligjore.

Megjithatë, shqetësuese mbetet gjendja e dhomave të ndalimit në disa komisariate. Mungesa e hapësirës, e ndriçimit, prania rëndom e lagështirës përbëjnë problematika që nevojitet të përmirësohen nga strukturat drejtuese të institucioneve të policisë. Higjiena e varfër dhe ajri i rëndë në ambientet e tualeteve, dusheve si dhe kushtet e këqija të shtrojeve të higjienës personale lenë shumë për të dëshiruar.

Statusi i të qenit i shoqëruar/arrestuar/ndaluar nuk legjitimon strukturat e policisë për të ushtruar forma presioni, dhunë psikologjike/fizike, apo torturë mbi këta persona.

Ndër komisariatet më problematikë në këtë drejtim kanë qenë Komisariati i Beratit, Komisariati i Vlorës, Komisariati i Sarandës, Komisariati i Tropojës, Komisariatet Nr. 1, Nr. 3, Nr. 5 në Tiranë etj..

Respektimi i garancive procedurale ligjore të shtetasve në mjediset e policisë vihet në zbatim që në momentin njoftimit të akuzës dhe marrjes në pyetje të personave në konflikt me ligjin. Gjatë monitorimit janë hasur ende raste ku të tilla të drejta procedurale nuk garantohen. Arsyet për shkelje të garancive procedurale ligjore janë të ndryshme, por shpesh herë fillojnë nga një mentalitet i vjetruar i cili beson se mjet efikas për zbulimin dhe luftimin e krimit është përdorimi i metodave të shtrëngimit fizik. Ky mentalitet nevojitet të ndryshohet. .

KShH vlerëson pozitivisht vendosjen e pankartave informuese me të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar në ambientet e komisariateve, si dhe praktikën e dhënies së deklaratës së të drejtave të tyre. Megjithatë, këto të drejta duhen komunikuar me gojë personave, që në momentin e parë të kufizimit të lirisë, sikurse sanksionohet në legjislacionin në fuqi.

KShH ka ngritur çështjen se e drejta për mbrojtje ligjore përmes avokatit duhet të garantohet që në momentet e para të shoqërimit/ndalimit/arrestimit. Garant të saj duhet të jenë së pari vetë punonjësit e strukturave të policisë. Shpesh kjo e drejtë nuk garantohej që në momentin e parë të kufizimit të lirisë.

Evidentimi dhe ndjekja mjekësore të rasteve ku personat që u është kufizuar liria paraqiten me shenja të ushtrimit të dhunës në komisariate e policisë, apo kanë pretendime për ushtrim dhune nga forcat e policisë duhet të mbetet përgjegjësi parësore e mjekut të institucionit të policisë.

Duke marrë parasysh që shtetasit e ndaluar/arrestuar mund të rrinë për disa ditë në mjedise të izoluara të komisariateve, atyre duhet t'u krijohet mundësia për kryerjen e ajrimit në mjedise të përshtatshme.

KShH dëshiron të vlerësojë pozitivisht praktikën e furnizimit me ushqim të personave të ndaluar në disa prej komisariteve të policisë të vëzhguara. Ndaj sugjeron që kjo praktikë e mirë të shtrihet në të gjithë komisariatet e policisë së vendit.

Mungesa e personelit femër për ofrimin e shërbimit në raste të shoqërimit /ndalimi /arrestimit të grave /vajzave ishte evidente sidomos në disa komisariate në zonat e largëta të vendit. Gjithashtu, të drejtat dhe garancitë ligjore të trajtimit të të miturit në konflikt me ligjin kërkohet të realizohen domosdoshmërisht me praninë e prindërve/kujdestarit ligjor, mbrojtësve ligjorë dhe të psikologut. Raporti ka sjellë raste që këto garanci ligjore janë shkelur nga autoritetet e policisë.

Problematike mbetet situatat sa i përket trajtimit të personave të sëmure mendore në komisarate e policisë. KShH ka evidentuar nevojën e një trajtimi të diferencuar kundrejt personave të sëmure mendore, në përputhje me nevojat specifike që ata kanë. Rritja profesionale e strukturave të policisë sa i takon aspekteve teorike dhe praktike të zbatimit të ligjit është një nevojë e vazhdueshme për përmbushjen e standardeve të punës në këtë drejtim.

Bazuar në gjetjet konkrete të prezantuar në raport, KShH ka ofruar edhe sugjerimet e tij shërbime qëllim përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave të personave që iu është kufizuar liria nga strukturat e policisë.

- Përmbledhje për situatën në institucionet e paraburgimit/burgje

Prej vitesh KShH monitoron sistemin shqiptar të burgjeve për të vlerësuar respektimin e të drejtave ligjore të të paraburgosurve dhe dënuarve që gjenden në këto institucione. Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2014 KShH ka realizuar vizita monitoruese të planifikuara. Kështu, gjatë periudhës maj-dhjetor 2014 janë realizuar 18 vizita monitoruese në institucionet lartpërmendur. Këto vizita vëzhguese janë pjesë e misionit të KShH-së në parandalimin e shkeljeve të të drejtave dhe keqtrajtimit të shtetasve të privuar nga liria dhe qëmtimin nga afër të rasteve të cilat trajtohen më tej nga KShH përmes rrugëve administrative pranë institucioneve përkatëse dhe përmes rrugëve gjyqësore dhe shërbimeve ligjore falas.

Kryerjen e vizitave e ka paraprirë trajnimi i vëzhguesve të KShH-së, të cilët kanë përvojë të gjatë në realizimin e vëzhgimeve. Grupet monitoruese janë përbërë nga mjekë, juristë, punonjës socialë dhe psikologë. Realizimi i vizitave monitoruese është udhëhequr nga parimet e objektivitetit, paanësisë, si dhe të respektimit të dinjitetit të personave të privuar nga liria dhe personelit të sistemit të burgjeve shqiptare.

Nga vëzhgimet ka rezultuar se çështja më shqetësuese me të cilën po përballet aktualisht sistemi i burgjeve në vendin tonë është mbipopullimi, i cili arrin deri në 32% mbi kapacitetin e lejuar, si një ndër përqindjet më të larta këto vitet e fundit. Nga monitorimet është konstatuar se mbipopullimi ka shkaktuar shkelje të standardeve ligjore të trajtimit të të burgosurve. Këto pasoja janë bërë më të rënda edhe për faktin se mbipopullimi nuk është shoqëruar me shtim të personelit, të buxhetit financiar, të furnizimit me medikamente apo pajisjeve të nevojshme mjekësore të institucioneve etj.. Si shkaqe të mbipopullimit janë zbatimi me përparësi i masës së sigurimit “*Arrest me burg*” nga ana e gjykatave, ashpërimi i masave të dënimeve penale, si dhe rritja e presionit ndaj institucioneve zbatuese të ligjit për të ashpërsuar masat e sigurimit e të dënimit ndaj veprimeve të paligjshme si, vjedhja e energjisë elektrike, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, ndërtime pa leje etj..

Kushtet e jetesës në institucionet penitenciare përfshijnë të gjitha mjediset e institucionit në të cilat zhvillohet dinamika e përditshme e jetesës në institucion. KShH vlerëson pozitivisht kalimin në mjediset e reja të paraburgimit të IP Tropojë, kalimin e të miturve të IP “Jordan Misja” në IVM Kavajë, kalimin e grave të paraburgosura të IP “Jordan Misja” tek IEVP “Ali Demi” Tiranë, apo hapat e ndërmarrë për kalimin në institucionin e ri të Beratit. Po ashtu, pozitive është edhe marrja e masave për përmirësimin e paraqitjes së jashtme të këtyre institucioneve.

Megjithatë, nga misionet e monitorimit që KShH ka realizuar këtë vit, ka rezultuar se ka problematika të qenësishme sa i takon kushteve të jetesës në institucionet e paraburgimit dhe burgjet e vendit, të ndikuara këto nga mbipopullimi i lartë, si dhe mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme për ta përballuar këtë situatë.

Sa i takon ushqimit të ofruar në këto institucione përgjithësisht u konstatua shërbim i mirë. Ndërsa sa i takon njësisve tregtare si edhe të blerjes së ushqimeve nga këto njësi, KShH ka konstatuar çmime mbi mesataren e tregut për asortimentet e tregtuara.

Përgjithësisht është konstatuar se nuk ka probleme me aksesin që duhet të kenë të burgosurit në tualete dhe dushe. Megjithatë, evidentohet nevoja e menjëhershme e ndërhyrjes për të përmirësuar situatën e higjienës në këto mjedise. Për më tepër mungesa e ujit ose ardhja me orar e tij në disa institucione e përkeqësonte situatën e higjienës së përgjithshme. Sidomos në institucionet e vjetra ende në funksion, me mbipopullim të lartë kushtet në dhoma nuk plotësonin standardet e hapësirës personale, të dritës, kohës së ajrimit etj..

Siguria dhe të ndjerit të sigurt është një element kyç në mbarëvajtjen e jetës së të para/burgosurve dhe personelit në burgje. Sa i takon këtij aspekti, KShH dëshiron të sjellë në vëmendje rastet e konstatuara në disa institucione të tentativave për vetëvrasje apo të vetëvrasjeve të kryera gjatë vitit 2014 të cilat janë rritur në numër krahasuar me vitet e kaluara. Sigurisht, tentativat për vetëvrasje apo vetëvrasjet kanë arsye të ndryshme pse ndodhin, por për këtë, nevojitet krijimi i një atmosfere ku si shtetasit e paraburgosur dhe ata të dënuar nga njëra anë dhe personeli nga ana tjetër, duhet të bashkëpunojnë në kushtet ku të gjithë të ndihen të sigurt. Kjo është edhe baza e një funksionimi të mirë të institucionit që parandalon situata dhe incidente të rënda.

E drejta e kërkesës dhe e ankesës përgjithësisht respektohej në institucionet e monitoruara. Përveç ndonjë rasti sporadik, KShH nuk mori ankesa në lidhje me funksionimin e mekanizmit të kërkesë-ankesave.

Trajtimi i të dënuarve përbën një objektiv të rëndësishëm të punës së punonjësve të burgjeve. Individualizimi i dënimit dhe programi ditor me aktivitete larmishme dhe kuptimplote, janë pjesë e integruar e punës së çdo punonjësi. Nga monitorimi ka rezultuar që IEVP “Ali Demi”, IVM Kavajë dhe IP Vlorë (për sektorin e të miturve) janë institucionet ku ofrohen më shumë aktivitete për grupet e të burgosurve që trajtohen në këto institucione.

Për t'u vlerësuar janë përpjekjet e disa institucioneve për të lidhur marrëveshje me drejtoritë rajonale profesionale për të bërë të mundur ofrimin e kurseve profesionale (hidraulik dhe saldator) për meshkujt e rritur, por jo të gjitha institucionet realizojnë kurse profesionale si pjesë e programit për përgatitje për lirim. Në fund të vitit 2014 Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi për të garantuar bashkëpunim ndërinstytucional mes burgjeve dhe drejtorive rajonale të punësimit për të realizuar kurse profesionale në të gjitha burgjet shqiptare si pjesë e programeve të para-lirimit. Kjo MB përshëndetet nga KShH, mbetet të shihet funksionimi në praktikë i kësaj MB-je në vijimësi.

Një instrument i rëndësishëm organizativ i hartimit dhe zbatimit të planit të individual të dënimit është edhe dosja psiko-sociale e të burgosurve. Nga vëzhgimi u konstatua se hartimi dhe plotësimi në vijim i këtij dokumenti orienton një sërë çështjesh të cilat duhet të adresohen, të tilla si: plotësimi standard i dosjeve, varfëria në plotësimin e problematikave individuale dhe mungesa e pasqyrimit të vlerësimit më të shpeshtë të gjendjes së të paraburgosurit apo të dënuarit. KShH në komunikimet zyrtare me DPB-në ka evidentuar nevojën e përdorimit të dosjeve psiko-sociale si mjete të qenësishme në rrugëtimin e trajtimit sipas nevojave specifike të personave të paraburgosur dhe të dënuar, sidomos kur bëhet fjalë për kategori të veçanta siç janë të miturit, gratë, të sëmurët mendorë etj., po ashtu ka sugjeruar thjeshtësimin e dosjeve psiko-sociale dhe futjen e disa instrumenteve konkretë të vlerësimit të ecurisë për personat me probleme të shëndetit mendor.

Ndër çështjet më të rëndësishme të konstatuara sa i takon kujdesit shëndetësor në burgje është çështja e furnizimit me ilaçe, ku thuajse në të gjitha IP/IEVP vëreheshin mungesa në medikamente. Përgjithësisht mungesa e personelit mjekësor ishte tejkaluar pasi institucionet kishin lidhur kontratave më kohë të pjesshme me mjek, hap ky që duhet vlerësuar pozitivisht. Megjithatë, duhet vlerësuar me kujdes cilësia e shërbimit shëndetësor në burgje pasi KShH ka marrë ankesa në këtë drejtim. Veçanërisht mbipopullimi i lartë e përkeqëson shërbimin mjekësor si në planin parandalues, po ashtu në dhënien efektive të shërbimit të të sëmurëve në institucione.

Në krahasim me gjetjet e monitorimit të vitit të kaluar, gjatë 2014 KShH vëren një ndërgjegjësim të personelit të institucioneve në lidhje me zbatimin e duhur të politikës disiplinore. Gjithsesi, në disa prej institucioneve të vëzhguara janë konstatuar disa probleme që lidhen së pari, me mjediset e dhomave të veçimit, të cilat linin shumë për të dëshiruar për sa i takon kushteve higjieno-sanitare dhe pajisjeve të tyre; së dyti, u vërejt mos-kujdes i personelit mjekësor dhe atij psiko-social, për të takuar çdo ditë personat e vendosur në veçim; së treti, në mjediset e veçimit ishin vendosur edhe persona të tjerë, të cilët, më së shumti për arsye sigurie, dhe me miratimin e tyre, qëndronin në këto sektorë/dhoma prej kohësh. Për këtë kategori duhet të përmirësohet dokumentacioni që pasqyron veçimin, arsyet dhe programin për t'i ndihmuar ata për t'u rikthyer sa më shpejt në regjimin e zakonshëm.

Zbatimi i politikës disiplinore në institucionet e paraburgimit/burgjet duhet gjithmonë të reflektojë frymën e ligjit dhe të standardeve ndërkombëtare, si dhe të mos reflektojë arbitraritet gjë që mund të çojë në keqtrajtim apo trajtim degradues të personave që mbahen në këto mjedise. KShH tërheq vëmendjen që ndaj të miturve dhe ndaj personave me probleme të shëndetit mendor ky mjet disiplinimi duhet të përdoret si masë e fundit pasi janë ezauruar të gjitha mjetet e tjera të këshillimit dhe masat pedagogjike. Nëse këta persona vihen në dhomë veçimi si masë disiplinore, duhet të synohet nga ana e personelit të burgjeve mbajtja sa më pak në kohë e tyre në këto mjedise. Ka tashmë një udhëzues administrativ që rregullon procedurën disiplinore për të miturit dhe për personat me probleme të shëndetit mendor. Thënë këtë, KShH sugjeroj që gjithë personeli i burgjeve të njihet dhe të trajnohet në vazhdimësi për zbatimin e këtyre politikave disiplinore.

Sa i takon të drejtës për leje shpërblyese dhe të veçanta, gjatë monitorimeve KShH ka marrë ankesa nga të burgosurit sa i takon proceduarave të zbatuara nga drejtuesit e institucioneve të burgjeve, me pretendime të ngritura për korrupsion kundrejt personelit, apo për vonesa procedurash dhe moskthim përgjigjesh nga zyrat juridike të institucioneve përkatëse. Është për t'u vlerësuar fakti që DPB udhëzon institucionet vartëse për të vlerësuar, rast pas rasti, dhënien e lejeve shpërblyese, duke theksuar se lejet shpërblyese duhen meritohen nga të dënuarit. Ekziston një udhëzim i MD dhe një Letër Porosi e DPB-së për sa i takon lejeve shpërblyese dhe ato të veçanta që jepen në burgje. KShH sugjeron që të dy këta dokumente udhëzues të rishikohen duke garantuar që vendimet për leje shpërblyese të jepen konform kritereve ligjore, me profesionalizëm dhe pa diskriminim për gjithë të burgosurit, si edhe të mos përfshihet mjeku i institucionit në procesin e dhënies së lejeve të veçanta. .

KShH përshëndet nismat e fundit të DPB-së sa i takon krijimit të mundësive reale për punësimin e të burgosurve, megjithatë aktualisht në institucionet e burgjeve ka një numër të vogël të dënuarish të angazhuar në veprimtari punësimi në raport me numrin e përgjithshëm të të burgosurve për institucion . KShH së fundmi ka ofruar mendime ligjore për projekt-VKM për punësimin dhe shpërblimin e të dënuarve dhe shpreson që sugjerimet e ofruara të merren parasysh nga MD dhe autoritetet ligjvënëse.

Trajtimi i të sëmurëve mendorë ka qenë në fokus të veçantë të vëzhgimeve të kryera gjatë vitit 2014, dhe është konstatuar një ndërmarrje pozitive nga DPB për hapjen e sektorëve të kujdesit të veçantë në disa burgje si në IEVP Lezhë, IP Elbasan, IP Berat (institucioni i ri), IP Durrës, IEVP Korçë, së fundmi në IP "Jordan Misja" Tiranë dhe IEVP Peqin. KShH inkurajon DPB-në që të mbikëqyri dhe mbështesë në vazhdimësi personelin e këtyre institucioneve në mënyrë që të konsolidojnë këtë përvojë të re për burgjet shqiptare. KShH, përmes korrespondencës zyrtare me DPB-në dhe IP/IEVP ku janë hapur tashmë këta sektorë, ka ofruar disa sugjerime për marrjen e masave organizative dhe përmbajtësore në lidhje me trajtimin e diferencuar e sipas nevojave për këtë kategori të burgosurish si edhe ka ofruar disa instrumente vlerësimi dhe model

plan dënimi e plani udhëzimi për ndjekjen e situatës së këtyre pacientëve nga ana e stafit multi-disiplinor. Gjatë monitorimit KShH ka konstatuar se në institucionet ku ka të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, ka mungesë kujdesi sa i takon standardeve të dhomave të qëndrimit, higjienës së varfër vetjake, të shtrojave personale dhe të mjediseve rrethuese. Shërbimi shëndetësor i ofruar linte për të dëshiruar në aspekt të kryerjes së vizitave periodike dhe të cilësisë së mjekimeve të ofruara. Dhe së fundi nevojiten të përmirësohen ndjeshëm programet e trajtimit për këta persona nga gjithë personeli mjekësor dhe ai psiko-social në burgje. Ka ndonjë rast pozitiv si ai i sektorit të kujdesit të veçantë në IP Durrës ku reflektohet përmirësimi i programeve të trajtimit për këtë kategori të burgosurish.

Një tjetër problem tejet shqetësuesi evidentuar vazhdon të mbetet mbajtja e personave me vendim gjyqësor me masë "Mjekim të detyrueshëm" dhe "Shtrim të përkohshëm" të cilët mbahen aktualisht në I EVP Krujë dhe QSB, në shkelje flagrante me ligjin dhe standardet ndërkombëtare që çon në trajtim ç'njerëzor të këtyre pacientëve. Rezulton se, në harkun kohor të rreth 10 viteve të fundit, numri i personave që kanë marrë nga gjykata masën "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" është dyfishuar, disa prej të cilëve qëndrojnë padrejtësisht në burgje për më shumë se 10 vjet.

KShH po ndjek në rrugë gjyqësore disa raste të tilla flagrante, duke kërkuar ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor të këtyre personave të mbajtur në burgje, ka kërkuar si të kundraligjshëm ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga prokurorët e çështjeve konkrete të cilët i vendosin këta persona në burgje dhe njëkohësisht është kërkuar edhe dëmshpërblimi civil i këtyre personave ashtu siç parashikohet në ligj

Trajtimi i të miturve vlerësohet pozitivisht, nëpërmjet ndërmarrjes së hapave pozitivë nga DPB për transferimin e të miturve të paraburgosur të IP "Jordan Misja" Tiranë për në IVM Kavajë. Po ashtu, vlerësohet qasja e përgjithshme që kanë institucionet ku ka të mitur për një kujdes të shtuar ndaj tyre, qoftë sa i takon arsimimit dhe formimit të tyre profesional, qoftë sa i takon larmishmërisë së aktiviteteve që iu ofrohen të miturve në burgje. Por, nga monitorimi janë konstatuar gjithashtu mangësi të cilat lidhen me higjienën në disa prej dhomave/mjediseve të qëndrimit të të miturve, me kuptueshmërinë dhe zbatimin e politikës disiplinore për të miturit, si dhe me orarin e realizimit të veprimtarive ditore me ta.

Trajtimi i grave në paraburgim/burgje është një tjetër fokus i monitorimit, duke qenë një grup në pozita të dobëta në këto institucione. Vlerësohet fakti i transferimit të grave të paraburgosura nga IP "Jordan Misja" Tiranë, tek I EVP "Ali Demi" gjatë muajit dhjetor të vitit 2014, pasi situata e vëzhguar në IP "Jordan Misja" përpara se gratë e paraburgosura të transferoheshin ishte vërtet shqetësuese. KShH vlerëson pozitivisht trajtimin që i bëhet grave tek I EVP "Ali Demi" Tiranë, nëpërmjet një sërë aktiviteteve të nevojshme për këtë grup. Infrastruktura e këtij të fundit le shumë për të dëshiruar në aspekt të garantimit të të drejtave ligjore të sanksionuara në ligj për këtë grup të paraburgosurash/të dënuarash. KShH inkurajon DPB të ndërmarrë hapa të shpejtë për ndërtimin e institucionit të ri ku të mund të akomodohen gratë e paraburgosura

/dënuara. Hartimi i planeve individuale të dënimit duhet të hartohen në konsultim me gratë e burgosura si dhe duhet të reflektojnë hapat konkretë/specifikë të punës së realizuar për arritjen e objektivave. Gjithashtu, programet e përgatitjes për lirim të tyre duhet të fillojnë që me ditën e parë kur gratë vendosen në paraburgim dhe duhet të realizohen në bashkëpunim me struktura të tjera të kujdesit të shërbimeve sociale dhe punësimit në nivel vendor dhe rajonal.

KShH ka konstatuar gjithashtu se kohëzgjatja e qëndrimit të grave në pritje të vendimit të formës së prerë dhënë nga gjykata, në shumë raste ishte e gjatë. Kohë-qëndrimi i tyre në paraburgim varionte nga 14 muaj deri në 2 vjet.

KShH, së fundmi dëshiron të nënvijëzojë edhe një herë rëndësinë e bashkëpunimit midis sektorëve të ndryshëm të punës në burgje. Përgjithësisht, punonjësit e institucioneve të vëzhguara pohojnë se kishin bashkëpunim të mirë midis tyre. Megjithatë, mosmarrëveshjet në lidhje me mënyrën e zbatimit të planeve të sigurisë së institucionit, sillnin edhe pengesa në dëm të realizimit të aktiviteteve të planifikuara nga sektorët e kujdesit social.

Pas një diskutimi të hapur mbi gjetjet e konstatuara gjatë kryerjes së vëzhgimeve në institucionet e paraburgimi/burgjet, me autoritet e DPB, KShH bën prezent edhe sugjerimet e tij për përmirësimin e situatës së respektimit të të drejtave të njeriut të të paraburgosurve/të dënuarve të cilat i gjeni në vijimësi në këtë raport.

Metodologjia e vëzhgimeve

KShH prej vitesh monitoron institucionet e policisë dhe atyre të burgjeve, duke realizuar vizita të rregullta monitoruese të planifikuara dhe vizita verifikuese.

Gjatë periudhës Maj - Dhjetor 2014, janë realizuar në total 40 vizita monitoruese, në kuadër të projektit “Për më shumë fuqizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Shqipëri”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinki në partneritet me Civil Rights Defenders dhe mbështetet financiarisht nga Suedish International Development Cooperation Agency, si dhe në kuadër të projektit “Së bashku për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria”, financuar nga Komisioni Evropian në Tiranë.

Në institucionet e policisë janë realizuar 22 vizita monitoruese, përkatësisht në **Komisariatet e Policisë në Tropojë, Kukës, Shkodër, Koplík, Përmet, Pogradec, Librazhd, Korçë, Ersekë, Fier, Lushnje, Berat, Krujë, Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastrë, në komisaritet e Policisë Nr. 1, Nr. 2, Nr. 3, Nr. 4, Nr. 5, Nr. 6 në Tiranë.**

Po ashtu, janë realizuar 18 vizita monitoruese në institucionet e paraburgimit/ burgjet, përkatësisht në **institucionet e Tropojë, Kukësit, Lezhës, Durrësit, Peqinit, Rrogozhinës, Lushnjes, Beratit, Tepelenës, Sarandës, Vlorës, Korcës, Krujës, Fushë-Krujës, Kavajës, “Ali Demi” dhe “Jordan Misja” në Tiranë dhe Qendra Spitalore e Burgjeve.**

Qëllimi kryesor i vizitave monitoruese është vëzhgimi i respektimit të të drejtave ligjore të garantuara nga standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm, i personave të privuar nga liria në këto institucione. Vëmendje të veçantë gjatë këtyre monitorimeve i është dhënë respektimit të të drejtave dhe trajtimi i duhur i personave në pozita të dobëta në këto institucione¹.

Vizitat monitoruese janë udhëhequr nga parimet e përgjithshme të së drejtës, standardet ndërkombëtare, legjislacioni shqiptar si dhe rekomandime të organizmave që veprojnë në këtë fushë. Konkretisht, listojmë si më poshtë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;
3. Direktivat e Bashkimit Evropian, Rekomandimet për Shqipërinë;
4. Kodi Penal;
5. Kodi i Procedurës Penale;
6. Ligji nr. 9331, dt.21.04.1998, ndryshuar me ligjin nr.10024, dt.27.11.2009 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”
7. Ligji nr.9888, dt.10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8328, dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”
8. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve;
9. Ligji nr.9749, dt.04.06.2009 “Për policinë e shtetit”
10. Ligji nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”
11. Rekomandimet e Komitetit për Parandalimin e Torturës, Avokatit të Popullit dhe KShH.

Për realizimin e misionëve të vëzhgimit, janë angazhuar vëzhgues me përvojë shumë vjeçare dhe me profesione të ndryshme, në përputhje me kërkesat profesionale të monitorimit, të tillë si: juristë, psikologë, punonjës socialë, si dhe mjekë psikiatër dhe të specialiteteve të tjera. Grupet e vëzhgimit janë përbërë nga 2 ose tre vëzhgues të profesioneve të ndryshme. Disa prej vizitave monitoruese janë realizuar në bashkëpunim me Mekanizmin për Parandalimin e Torturës, pranë Avokatit të Popullit.

¹ Persona në pozita të dobëta janë të miturit, gratë, personat LGBTI, të sëmurët mendorë, të moshuarit, etj..

Në përmbushje të misionit dhe objektivave konkrete të monitorimeve, KShH, paraprakisht dhe në vijimësi, ka trajnuar grupin e vëzhguesve për metodologjinë e vëzhgimeve, çështje të përditësuara nga situata aktuale e institucioneve të policisë dhe burgjeve, si në planin teorik dhe në atë praktik. Parandalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe keqtrajtimit në vendet e privimit të lirisë, parë nën dritën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ishte një tjetër këndvështrim i aftësimit të vëzhguesve të KShH-së, për t'u mbajtur parasysht gjatë kryerjes së vëzhgimeve.

Ekspertët e KShH-së hartuan pyetësorë të detajuar të cilët shërbyen për strukturimin e vëzhgimit, si dhe për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit në përputhje me qëllimin e vëzhgimeve, duke lënë hapësirë edhe për monitorimin e çështjeve të tjera me rëndësi.

Gjatë vëzhgimeve grupet e monitorimit, pasi janë prezantuar në institucionet përkatëse, kanë marrë takim me drejtuesit e tyre dhe më tej, kanë realizuar vizitat monitoruese në regjimet e brendshme dhe të jashtme të institucioneve. Një pjesë e rëndësishme e vëzhgimit ka qënë zhvillimi i një numri të madh intervistash me të shoqëruar/ndaluar/arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar. Pjesë e vëzhgimeve ka qënë edhe kqyrja dhe konsultimi i dokumentacionit përkatës në institucionet e vëzhguara.

Në përfundim, grupet monitoruese, u kanë bërë prezent drejtuesve të institucioneve, gjetjet më të rëndësishme që kanë dalë nga vëzhgimi konkret. Kur është vlerësuar se ka qënë e nevojshme marrja e masave urgjente në nivel qendror për përmirësimin e problemeve të konstatuara, KShH i është drejtuar me korrespondencë zyrtare drejtuesve të lartë të DPB-së, DPPSH-së, Ministrive të Drejtësisë dhe asaj të Brendshme.

Vlen të theksohet se KShH-së, për çështje të tilla si marrja e masave për zvogëlimin e mbipopullimit në sistemin e burgjeve dhe mbajtja e personave me "masë mjekësore të detyruar" në institucione penale në shkelje flagrante të standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit vendas i është drejtuar me korrespondencë zyrtare Presidentit të RSH-së, Kryeministrit, Prokurorit të Përgjithshëm, Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Një rëndësi të veçantë gjatë kryerjes së vëzhgimeve iu është kushtuar trajtimit të grupeve në pozita të dobëta që mbahen në komisariatet e policisë apo institucionet penitenciare. Trajtimi i diferencuar që iu duhet ofruar këtyre grupeve me nevoja specifike trajtimi, buron nga ligji dhe reflekton kujdesin e shtuar që duhet të kenë strukturat policore dhe ato të burgjeve në raport me këta persona.

Ky raport përmbledh gjetjet, përfundimet dhe sugjerimet e vizitave monitoruese, parë nën një këndvështrim objektiv dhe të paanshëm, të udhëhequr nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me strukturat e monitoruara, në respekt të plotë të

punës së vështirë dhe dinamike që realizojnë administrata e policisë së shtetit dhe ajo e burgjeve.

Pjesa e parë SITUATA NË DREJTORITË DHE KOMISARIATET E POLICISË

II. Gjetje lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet e policisë

Ligji “Për Policinë e Shtetit” sanksionon se *“Përmbushja e misionit dhe përgjegjësi të Policisë së Shtetit kryhet vetëm me mjetet dhe atributet që i njej ligji policisë, duke respektuar të drejtat e njeriut”*. Në përputhje me këtë dispozitë KShH përmes vëzhgimeve të realizuara në institucionet e policisë ka vlerësuar se si e përmbush PSH misionin e saj.

2.1 E drejta për trajtim dinjitoz

2.1.1 Kushtet infrastrukturore

Infrastruktura është baza themelore e cila garanton trajtimin dinjitoz që duhet t'i ofrohet të shoqëruarve/ndaluarve/arrestuarve. Tërësia e kushteve materiale në një institucion të policisë, që të përmbushin standardet e trajtimit të personave që mbahen aty, përbën domosdoshmëri për realizimin e misionit të strukturave të policisë.

Komiteti për Parandalimin e Torurës, i cili monitoron periodikisht dhe ad hoc Shqipërinë shprehet qartë se *“Të gjitha dhomat e policisë duhet të jetë të pastra dhe me një madhësi të arsyeshme për numrin e personave që akomodojnë dhe, të kenë ndriçim adekuat (dmth i mjaftueshëm për të lexuar, duke përjashtuar periudhën e gjumit); dhomat mundësisht duhet të kenë dritë natyrore. Më tej, dhoma duhet të jetë e pajisur me mjete të tjera (p.sh. karrige të fiksuara ose stol) dhe për personaat që janë të detyruar të qëndrojnë gjatë natës aty, duhet të pajisen me një dyshek të pastër dhe batanije të pastra. Personat në ambietet policore duhet të kenë akses në tualet të përshtatshëm, me kushte të denja dhe, t'u ofrohet mjete të mjaftueshme për të larë veten e tyre. Ata duhet të kenë akses për ujë të pijshëm dhe t'u jepet ushqim në kohë të përshtatshme, duke përfshirë të paktën një vakt të plotë (dmth diçka më substanciale sesa një*

*sanduiç) çdo ditë. Personat që mbahen nën kujdesin e policisë për 24 orë ose më shumë duhet, sa më shumë të jetë e mundur, t'u ofrohet dalje / ajrim në natyrë çdo ditë"*².

KShH vlerëson pozitivisht përpjekjet e drejtuesve të institucioneve të policisë për **rregullimin dhe mirëmbajtjen** e mjediseve të tilla si risistemimi apo lysterja e ndërtesave në disa institucione të vëzhguara. Shpeshherë fondet siguroheshin nga bashkëpunimi me subjekte privatë, në mungesë të burimeve të fondeve shtetërore siç ishte rasti në Komisaratin e Përmetit, Komisaratin e Librazhdit etj.). Ndërkohë që investohet për përmirësimin e mjediseve të jashtme të komisarateve të policisë, nga vëzhgimet rezultoi se situata infrastrukture e dhomave të shoqërimit/ndalimit shpesh mbetet po ajo, duke mos pasur investime të qënësishme për përmirësim e standardeve të trajtimit të individëve që mbahen aty.

KShH vlerëson faktin se në përmbushje të detyrimeve ligjore për ofrimin e trajtimit dinjitoz të personave në konflikt me ligjin, nëpërmjet Urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është vlerësuar **të mbyllen** disa prej **dhomave të shoqërimit/ndalimit/arrestimit**, për shkak të ndodhjes së tyre në kushte që s'i përlligjen standardeve minimale të kërkuara. Megjithatë, në disa prej komisariateve të monitoruara (si në Komisaratin e Shkodrës, të Pogradecit etj..) këto ambiente nuk ishin mbylluar sipas procedurës së përcaktuar³, gjë që lë hapësirë për hamendësime për vazhdimësinë e përdorimit të këtyre mjediseve. Për më tepër, në këto mjedise u gjetën pajisje dhe sende që ishin përdorur së fundmi, çka e rëndon edhe më shumë situatën në fjalë.

Gjithashtu, duhet vlerësuar si pozitiv fakti se ka një përpjekje të vazhdueshme të strukturave të policisë për përmirësimin e ambienteve/sallave të pritjes së qytetarëve (në Komisaritet Nr. 2, Nr. 3 Tiranë, në Komisaratin e Tropojës etj.).

Megjithatë, situata në dhomat e ndalimit në disa prej institucioneve të vëzhguara (në Komisaritet Nr. 2, Nr. 3 Tiranë, në Komisaratin e Tropojës etj.) ishte tejet shqetësuese dhe në shkelje të rëndë të standardeve minimale të sipërcituara të KPT-së. Këto mjedise ishin pa dritë dhe hapësirë të mjaftueshme, pa mundësi ajrimi, me shtroje shumë të vjetëruara dhe aspak të përshtatshme me normat e higjienës dhe pastërtisë.

Gjatë vëzhgimeve të realizuara, u vu re se kishte predispozitë nga personeli i institucioneve të policisë për të siguruar mjedise sa më të përshtatshme – të veçanta për **trajtimin e të miturve dhe grave**. Kështu, në komisaratin e Librazhdit kishte vetëm një dhomë për të miturit dhe gratë, por personeli bëri të ditur se për shkak të kushteve të këqija të këtij mjedisi, nuk përdorej për trajtimin e këtyre kategorive. Të miturit dhe gratë e shoqëruara mbaheshin nëpër zyrat e punonjësve. Megjithë predispozitën e mirë,

² Raporti i Përgjithshëm 12, i KPT-së, §47.

³ Me drrn dhe me vulë të dyllosur.

duhen siguruar mjedise të përshtatshme të veçanta për të dy këto kategori ashtu siç e parashikon edhe ligji.

Shqetësuese mbetet gjendja e dhomave të ndalimit në Komisaratin e Vlorë, Sarandës, Lushnjës, Shkodrës, Krujës Komisariteve Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, në Tiranë etj. **Mungesa e ndriçimit**⁴, prania rëndom e **lagështirës** apo **zhgarravinat nëpër mure** përbëjnë disa problematika që nevojitet të adresohen nga strukturat drejtuese të institucione policore për rregullim. Higjiena e varfër dhe ajri i rëndë në ambientet e tualeteve, dusheve si dhe kushtet e këqija të shtrojeve të higjienës personale lenë shumë për të dëshiruar.⁵

Sa i takon dhomave të shoqërimit, shqetësuese mbetet gjendja infrastrukurore në Komisaratin e Tropojës, (mjedis i vogël, pa derë por me zgarë hekuri, më shumë si kafaz sesa si dhomë shoqërimi⁶), në Komisaratin e Shkodrës, Koplikut, Krujës, etj. Këto mjedise nuk kishin pajisjet e nevojshme për qëndrim deri në 10 orë (karrige dhe tavolinë), ishin në kushte jo të mira higjienike, me dritare pa xham⁷.

Një problem tjetër i konstatuar lidhur me infrastrukturën në një numër të madh komisaratesh ishte mungesa e bazës materiale të nevojshme për realizimin e punës së përditshme në përmbushje të detyrave funksionale dhe misionit të strukturave të policisë. Shpesh drejtuesit dhe personeli bazë ngrinte shqetësimin e mungesës së zyrave të përshtatshme, të kancelarive të nevojshme, apo edhe pajisjeve të tjera të punës.

2.1.2 Tortura dhe keqtrajtimi;

Respekti për dinjitetin e personave të shoqëruar/ndaluar, duhet të jetë vlerë etike themelore që duhet të udhëheqë punën e punonjësve të drejtorive dhe komisarateve të policisë. Ky parim themelor mbizotëruet, është i shprehur qartë në nenin 10 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të Kombeve të Bashkuara: "Të gjithë personat e privuar nga liria duhet të trajtohen me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin njerëzor të personit". Mbi të gjitha, tortura dhe dënimi mizor, ose trajtimi çnjerëzor ose degradues, janë **absolutisht** të ndaluara dhe nuk mund të justifikohen në asnjë rrethanë.

Po ashtu, një parashikim i tillë gjendet në nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore*

⁴ Mungesë ndricimi natyror dhe artificial (llampa të thyera apo me voltazh të ulët) i pamjaftueshëm.

⁵ Sipas informacioneve zyrtare të DPPSH, rikonstruktimi I këtyre ambienteve bëhet sipas planeve afatmesme që ka qeveria shqiptare. Ka rreth dy vjet që është gati plan-projekti i rikonstruktimit të ambienteve të ndalimit në Vlorë, i cili nuk ka gjetur mbështetje financiare buxhetore për t'u realizuar.

⁶ Ajo që binte në sy nga monitorimi ishte përdorimi i një dhome/kafaz, me përmasa rreth 1.5 m² x 1.5 m² për qëndrimin e personave të ndaluar gjatë kohës së zbatimit të proceduarve, deri në transferimin e tyre në dhomat e ndalimit pranë ambienteve të IP Tropojë.

⁷ Nga informacioni zyrtar i marrë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, vërehet se shpesh, pajisjet e këtyre ambienteve dëmtoheshin nga personat që mbahen aty, sidomos nga individët e dehur, të varurit nga substancat narkotike apo të sëmurët mendorë.

ose degraduese". Ndalimi i torturës dhe formave të ndryshme të keqtrajtimit parashikohet edhe në nenin 25 të Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 86 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, specifikisht i sanksionuar si veprë penale.

Fazat më të hershme të shoqërimit/ndalimit, dhe veçanërisht ato që përfshijnë arrestimin në flagrancë, marrjen në pyetje dhe hetimin, janë fazat me rrezikshmëri më të lartë për sa i takon përdorimit të keqtrajtimit dhe torturës. Mjetet e kufizimit fizik përbëjnë instrumente me rrezikshmëri të shtuar nëse keqpërdoren në momentet e sipërpërmendura.

KShH është e vetëdijshme që rastet e pretenduara të keqtrajtimit apo torturës janë sa të vështira për t'u vërtetuar, po aq edhe të ndjeshme sa i takon reagimeve të personelit të institucioneve të policisë për t'u pranuar. Gjejmë me vend të përmendim këtu çështjet e ngritura në një letër zyrtare drejtuar Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Policisë së Shtetit, ku KShH, ndër të tjera, ngre shqetësimin e koncepteve apo qëndrimeve jo-njerëzore të punonjësve të policisë, të shprehura gjatë trajnimit të ofruar nga KShH, me temë parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues në institucionet policore.

KShH ka konstatuar se të ndaluarve në komisariatet e Lushnjes gjatë natës u lihej një kovë plastike për të kryer nevojat personale pasi dhomat e ndalimit nuk ishin të pajisura me tualet brenda. Kjo situatë mund të përbëjë trajtim degradues si dhe cenim të dinjitetit njerëzor të të ndaluarve që mbahen në të tilla kushte.

Statusi i të qenit i shoqëruar/arrestuar/ndaluar nuk legjitimon strukturat e policisë për të ushtruar forma presioni, dhunë psikologjike/fizike, apo torturë mbi këta persona.

Nga vizitat monitoruese në institucionet e policisë, ndër më problematikët kanë qenë Komisarati i Beratit, Komisarati i Vlorës, Komisarati i Sarandës, Komisarati i Tropojës, Komisarati Nr. 1, Komisarati Nr. 3, në Tiranë etj.. Pretendimet e personave të intervistuar lidhen me ushtrim të presionit psikologjik dhe ushtrim dhune fizike gjatë momentit të marrjes në pyetje nga punonjësit e strukturave të policisë, kryesisht për të pranuar veprën penale për të cilën akuzoheshin, apo për të pranuar edhe vepra të mëparshme penale për të cilat dyshoheshin si autorë.

Moment tjetër i evidentuar si pretendim dhune i ushtruar nga punonjësit e policisë të Komisaritit të Beratit ishte ndalimi/arrestimi në mjediset e banimit të një shtetasi me probleme të shëndetit mendor. Ky shtetas pohoi se ishte goditur disa herë me shkop gome në kurriz⁸ dhe në kokë nga punonjësit e policisë në shtëpinë e tij në prani të të gjithë familjarëve. Në po këtë komisarati, një tjetër shtetas i paraburgosur akuzonte personelin e tij, për ushtrim dhune. Shtetasi në fjalë kishte disa dhëmbë të thyer dhe shenja goditjesh në trup, të cilat ishin në shërim e sipër në kohën e vëzhgimit. Nga

⁸ Ai kishte ende disa shenja të gotitjeve në shpinë.

kqyrja që iu bë rregjistrin të mjekut në këtë institucion, i cili ishte hapur më datë 15.10.2014, për muajin tetor rezultoi në 29 persona të dërguar në spital për të marrë mjekim dhe, për muajin nëntor 27 persona.

Problematike paraqitej situata edhe në Komisaratin e Sarandës, ku shumë prej të paraburgosurve që gjendeshin në Institucionin e Paraburgimit Sarandë, të intervistuar nga KShH, pohuan se dëgjonin shpesh zhurma të forta goditjesh dhe ulërime të individëve që kërkonin të mos goditeshin⁹. Ndërsa në komisaratin e Tropojës nga disa punonjës të strukturave të policisë iu pohua grupit vëzhgues se “druri ishte për ata që e kishin hak”. Gjithashtu, gjatë intervistave të realizuara me dy persona të ndaluar që gjendeshin në komisaratin e Gjirokastrës, nga këta shtetas i ngrit pretendimi se ishin goditur disa herë me shuplaka nga oficerët të policisë të Komisarariatit të Këlcyrës.

Siç është përmenduar edhe më lart, mjetet e kufizimit fizik apo të ushtrimit të forcës janë instrumente që përdoren nga strukturat e policisë si mjete presioni gjatë marrjes në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar. KShH vëren se në mjediset e komisarariatit të Vlorës, në Komisaratin e Shkodrës etj.. janë gjetur të tilla pasjije si shkopa gome, pranga, sëpatë apo shkopinj, këmbë karrigesh prej hekuri, thupra të ndryshme etj.. Kur është pyetur personeli për arsyen e pranisë së këtyre mjeteve, përgjigjja ka qenë që këto sende janë prova materiale, të cilat punonjësit e policisë kanë vendosur t’i mbanin aty. Këto gjetje vijnë në kundërshtim me procedurën e ruajtjes së provave materiale dhe si edhe në kundërshtim me standardet e trajtimit të shtetasve në mjediset e policisë. Për këtë arsye KShH e ka ngritur këtë shqetësim edhe përmes letrave zyrtare drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Personeli i policisë duhet të jetë i vetëdijshëm se mjetet e shtërngimit fizik të gjendura në ambientet e zyrave të punës, përbëjnë shkelje ligjore, si dhe ngre hamendësime për ushtrim dhune ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar. KShH, pas realizimit të një trajmini disa ditore me punonjës të policisë nga i gjithë vendi, ku u trajtuan edhe tema që lidhen me keqtrajtimin dhe torturën, nëpërmjet një letre zyrtare drejtuar Ministrin të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ka shprehur ndër të tjera shqetësimin se ende gjenden në radhët e policisë së shtetit punonjës që kanë mentalitete të vjetruara të ushtrimit të metodave antiligjore dhe jo në përputhje me standardet e trajtimit të personave në ambientet policore.

2.1.3 Procedura e marrjes në pyetje

Marrja në pyetje mbetet një nga momentet kyçe të procedimit administrativ dhe atij penal, në lidhje me të shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht në nenet 27-33 mbron pozitën e personave të shoqëruar/arrestuar/ ndaluar duke i bërë të qarta të drejtat që gëzojnë individët gjatë marrjes në pyetje nga strukturat e policisë. Specifikisht, marrja në pyetje parashikohet në nenin 38 të Kodit të Procedurës Penale me përmbajtjen e mëposhtme:

⁹ Të tipit “boll më godite se më vrave” etj..

“I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i ëshë hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve. Para se të ketë filluar pyetja, të pandehurit i shpjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet, procedimi do të vazhdojë”. Respektimi i rregullave procedurale dhe ruajtja e thelbit të të drejtave për personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar mbetet me rëndësi për vijueshmërinë normale të këtij procesi.

Duke e vlerësuar gjithashtu si një fazë të rëndësishme të respektimit të të drejtave të shtetasve në konflikt me ligjin, KShH e monitoron nga afër procedurën e marrjes në pyetje. Kështu, vëzhgimi përqendrohet tek vlerësimi dhe respektimi i garancive ligjore të qëndrimit të shtetasve në institucionet e policisë, sipas statusit që u atribuohet.

Si rezultat i vëzhgimeve të kryera, vihet re se të shoqëruarit mbahen në dhomat e shoqërimit të komisariateve jo më shumë se 10 orë, kurse të ndaluarit/arrestuarit mbahen maksimalisht 72-96 orë. Marrja në pyetje e shtetasve, pothuajse në të gjitha institucionet e monitoruara, realizohet në zyrat e punës së oficerëve të policisë. Shtetasit e ndaluar apo personat nën hetim, merren në pyetje ose në zyrat e punës së punonjësve të policisë, ose në dhomat e hetimit¹⁰. Nuk kishte investime të mëtijshme¹¹ sa i takon pajisjes me infrastrukturën e nevojshme për regjistrim audio dhe video të intervistave të marrjes në pyetje të shtetasve.

KShH vëren përgjithësisht një qasje të ndryshme të trajtimit që iu ofrohet të miturve dhe grave në lidhje me këtë moment, krahasuar me trajtimin e shtetasve meshkuj të rritur. Vërehet një ndërgjegjësim më i lartë i strukturave të policisë sa i takon zbatimit të procedurës së marrjes në pyetje të të miturve në prani të psikologut, i cili sigurohet si formë e bashkëpunimeve me psikologët e shkollave apo spitaleve të ndryshme lokale. Lajmërimi i familjarëve të të miturve realizohet me përparësi nga punonjësit e policisë duke e konsideruar kusht të nevojshëm për trajtimin sa më dinjitoz dhe të kujdesshëm ndaj të miturve si kategori që gëzojnë kujdes të veçantë.

Megjithatë, KShH, gjatë vëzhgimit të realizuar në Komisaritin e Shkodrës, konstatoi rastin e një të mituri, i cili ishte marrë nga patrulla e policisë në shtëpinë e tij, pa e vënë në dijeni arsyen e shoqërimit në mjediset e policisë. Ky i mitur kishte rreth 3 orë që priste në korridorin e komisaritit për t'u marrë në pyetje nga një punonjës i policisë së sektorit të Hetimit të Krimeve të Rënda. I mituri ishte i pashoqëruar nga familjarët e vet.¹²

¹⁰ Në Komisaritin e Shkodrës ishte një dhomë e posaçme, brenda mjediseve të ndalimit, e cila përdorej për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar.

¹¹ Përveç investimeve në Komisaritin e Vlorës dhe të Shkodrës, si investim i organizatave jo-fitimprurëse.

¹² Në raste të ngashme të ngritura nga Avokati i Popullit, DPPSH ka marrë masa ndaj punonjësve që kanë shkelur dispozitat ligjore përkatëse.

Nga intervistat e zhvilluara me personelin e policisë në institucionet e vëzhguara, KShH nuk u vu në dijeni në asnjë rast për ndjekjen e procedurave të diferencuara për personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar të cilat janë të sëmure mendore, të varur nga droga apo persona LGBT¹³. Përveç marrjes në pyetje nga oficerë të policisë gjyqësore të të njëjtit seks me të shoqëruarit/ndaluarit/arrestuarit nuk u paraqit ndonjë procedurë tjetër e diferencuar.¹⁴ Më së shumti, punonjësit e policisë nuk ishin në dijeni të nevojës për trajtim të veçantë që i duhej ofruar të tillë individëve në ambientet policore.

2.1.4 Përdorimi i forcës;

*“Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike: është tërësia e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i policisë, duke filluar nga forma verbale e bindjes deri në përdorimin e forcës në mënyrë proporcionale për rivendosjen e rendit, në përputhje me legjislacionin, duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut”.*¹⁵

*“Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura”.*¹⁶

Këto përcaktime ligjore shprehin qartë raportin mes domosdoshmërisë në përmbushje të detyrës dhe respektimit, garantimit të të drejtave dhe lirive themelore. Strukturave të policisë u lejohet përdorimi i forcës vetëm nëse është thelbësisht e domosdoshme dhe në proporcion me situatën e krijuar. Ruajtja e një raporti korrekt mes përdorimit të forcës në proporcion me situatën e krijuar përbën sfidë dhe kërkon profesionalizëm nga ana e punonjësve të policisë. Shpeshherë tejkalimi i masës së proporcionalitetit të kërkuar të përdorimit të forcës çon drejtpërdrejtë te rastet e veprimeve të dhunshme, keqtrajtimit apo dhe torturës në momentet e ndalimit dhe arrestimit. Ndërsa, sa i takon shoqërimin të shtetasve në komisariatet e policisë, duhet kuptuar vetëm si një akt administrativ.

KShH dëshiron të evidentojë rastin e konstatuar gjatë monitorimit në Komisaratin Nr. 5 në Tiranë. Shtetasi me inicialet Q. L., i kontaktuar nga grupi monitorues, kishte shenja të dukshme të pësimit të goditjeve forta (të dy sytë e nxirë dhe në vetullën e majtë kishte një fashë tek një çarje). Personi pohonte se ishte dëmtuar gjatë kohës së shoqërimit në komisarati. Ai fillimisht ishte ndaluar nga patrulla e policisë për verifikim dokumentacioni të motorit, por për shkak të rezistencës ndaj kontrollit personal dhe, si rezultat i kundërshtimit të forcave të policisë (njërit prej efektivave të policisë), ai u

¹³ Gjatë vëzhgimit në komisaratin e Fierit, strukturat drejtuese të këtij komisarati u shprehën me tone diskriminuese dhe joetike ndaj realizimit të një procedure të tillë.

¹⁴ Nga informacioni i marrë nga DPPSH, rezulton se punonjësit e policisë kanë pak ose aspak njohuri për trajtimin e personave më probleme të shëndetit mendor, ndaj nevojiten trajnime relevante.

¹⁵ Neni 6, pika 11, ligj nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”

¹⁶ Neni 133, ligj nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”.

shoqërua në komisariat me forcë. Nga informacionet e marra si nga vetë personi i dëmtuar, po ashtu edhe nga punonjësit e intervistuar, përpara se të sillej në ambientet e komisariatit, personi ishte mjekuar¹⁷ në Qendrën Shëndetësore Kamëz për shkak të dëmtimeve në fytyrë. Në regjistrin e mjekut në komisariat, nuk kishte asnjë shënim në lidhje me këtë rast, me justifikimin që personi ishte mjekuar në qendrën shëndetësore Kamëz. Ky shtetas konfirmoi që kishte komunikuar me familjen dhe kishte pasur takim me avokatin e tij gjithashtu.

Sa më sipër KShH shpreh shqetësimin e tij në lidhje me proporcionalitetin e forcës së ushtruar në këtë rast në përputhje me nenin 93 të ligjit “Për policinë e shtetit” në të cilin sanksionohet se *“Masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë dhe ajo nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur”*. Në rastin në fjalë, personi është dëmtuar gjatë kohës kur ai shoqërohej për në komisariat e policisë, pra kur shkalla e rrezikshmërisë së veprimeve të tij ishte e ulët, si dhe kur numri i punonjësve të policisë ishte disa herë më i lartë. Gjithashtu, në çdo rast të tillë, evidentimi në regjistrin mjekësor apo në dokumentet e tjera zyrtare, duhet të evidentohen dëmtimet fizike të çdokujt që procedohet administrativisht apo penalisht (thirret, shoqërohet, ndalohet apo arrestohet).

KShH sugjeron që situata të tilla të shmangen në të ardhmen, sepse përbëjnë shkelje të ligjit dhe të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve në konflikt me ligjin. Përdorimi i forcës duhet konceptuar sipas kuptueshmërisë së drejtë ligjore dhe të përdoret si mjeti i fundit që duhet ndjekur, kur metodat e tjera të neutralizimit të situatës konfliktuale nuk kanë qenë efektive.

KShH, e vetëdijshme për raportin e ngushtë që ekziston mes përdorimit të forcës dhe veprimeve të keqtrajtimit apo torturës, tërheq vëmendjen se standardet e sotme kërkojnë gjetjen e raportit të drejtë mes garantimit të sigurisë publike dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personave. Në këtë mënyrë, përdorimi i forcës s’duhet ushtruar si tregues i pushtetit, por të shërbejë si parametër funksional sipas kornizës që e drejta ofron.

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, raste të tilla ku shtetasit pretendojnë dhunë të ushtruar nga punonjësit e policisë nuk duhet të kalohen pa një shqyrtim të hollësishëm dhe të plotë të rastit në fjalë nga organet përkatëse të policisë dhe prokurorisë, për të hequr çdo dyshim të arsyeshëm të përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë së shtetit.

2.1.5 Procedura e transferimit;

Praktika në realitetin shqiptar ka treguar se personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar qendrojnë në ambientet e policisë përgjithësisht në afatet maksimale ligjore.

¹⁷ Në zbatim të nenit 64/2 “Detyrimi për garantimin e ndihmës mjekësore” të ligjit “Për policinë e shtetit”.

Rekomandimet e KPT si dhe të tjera të standardeve ndërkombëtare sugjerojnë vazhdimisht se koha e qëndrimit në këto ambiente duhet të jetë sa më e shkurtër, në respektim të afateve kohore ligjore të paracaktuara.

Nga vëzhgimi ka rezultuar se nuk janë konstatuar shkelje të afateve ligjore të përcaktuara për shoqërimin dhe për ndalimin. Në përgjithësi, personeli i policisë ishte i vetëdijshëm që nuk duhet t'i mbante të shoqëruarit/ndaluarit përtej afateve ligjore të përcaktuara.

Megjithatë, problematikë të spikatur sa i takon kësaj procedure përbën situata në komisariatet e policisë Nr. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 në Tiranë. Në të gjitha këto komisariate janë gjendur shtetas me masë arresti "Arrest në burg" dhënë nga gjykata, të cilët qëndronin në ambientet e komisariateve deri në 10 ose në ndonjë rast edhe 15 ditë. Personeli drejtues i këtyre institucioneve, i vetëdijshëm për situatën, u shpreh se përballej me këtë vështirësi për shkak të pengesave që haste për transferimin e tyre në institucionet e paraburgimit¹⁸.

Problematikë tjetër, madje në shkelje më të rëndë, paraqitet dhe ajo e vonesave në transferimin e personave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (të dënuar me vendim të formës së prerë, persona në kërkim). Procedura që ndiqej në këto raste fillonte me një kërkesë që paraqitej në afate të arsyeshme (pa u krijuar vonesa nga komisariatet) drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Kësaj kërkesë i bashkëngjiteshin aktet e mëposhtme:¹⁹

- a) Procesverbali i ekzekutimit të Urdhërit të Prokurorisë për zbatimin e vendimit penal të arrestit;
- b) Aktet për ekzekutimin e vendimit penal për të dënuarin;
- c) Urdhëri i Prokurorisë për ekzekutimin e vendimit penal;
- d) Vendimi i Gjykatës për dënimin e personit;
- e) Procesverbali i kontrollit personal;
- f) Të dhënat personale nga sistemi i gjëndjes civile;
- g) Kartela ditore e shërbimit shëndetësor;
- h) Gjurmët e gishtërinjëve.

Për shkaqe objektive ose subjektive, kthimi i përgjigjes nga DPB-ja vononte disa ditë, shpesh herë për 1 javë, apo në disa raste edhe deri në 20 ditë. Punonjësit e policisë shpreheshin të shqetësuar për mosmarrjen nga strukturat penitenciare të personave me

¹⁸ Institucionet e paraburgimit ngrinin pretendimin se nuk kanë vende për të akomoduar të arrestuarit. Megjithatë nga informacioni i përditësuar i marrë nga DPPSH, ky problem është zbutur në mënyrë të ndjeshme, pasi janë ndërmarrë hapa nga DPB për të "riformuar" institucionet e paraburgimit të Tiranës, gje që ka sjellë uljen e mbipopullimit të tyre.

¹⁹ Një procedurë e tillë, na u bë e qartë duke pasqyruar kështu realizimin e punës së tyre stafi i policisë në komisariatet e Korçës.

masë arresti “Arrest në burg” dhënë nga gjykata, me justifikimin se ishin të mbipopulluar. Ky mosfunksionim midis strukturave të policisë dhe ato të burgjeve, së pari është në dëm të personave të arrestuar, të cilët duhet të trajtohen në institucionet penitenciare sa më parë dhe, së dyti, krijon ndërçës dhe vështirësi për realizimin e punës së të dy strukturave shtetërore.

Një nga problemet po aq të rëndësishme e konstatuar gjatë vëzhgimeve, kishte të bënte me numrin e paktë të makinave të policisë, mungesën e karburanteve, si dhe pajisjeve të tjera të domosdoshme për mirëmbajtjen e automjeteve. Kjo bënte shpeshherë që transferimet të realizoheshin përmes zgjidhjeve sporadike duke përdorur shpeshherë edhe mjetet e patrullimit. Një mungesë e tillë e planit logjistik krijonte vështirësi në transferimet që duheshin kryer.

1.1.6 E drejta për kërkesë-ankesë;

E drejta e kërkesë/ankesës është një e drejtë universale. Ajo garantohet dhe promovohet nga aktet ndërkombëtare duke u sanksionuar si e tillë edhe në Kushtetutën tonë, në Kodin e Procedurave Administrative si dhe në ligje të tjera të posaçme.

Një parashikim i tillë bën të mundur garantimin e drejtpërdrejtë të kësaj të drejte të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar. Një parashikim i tillë, i detyron forcat e policisë ta konceptojnë të drejtën për të bërë kërkesa apo ankesa që kanë personat me liri të kufizuar, si një formë e ruajtjes së integriteti fizik dhe psikologjik të tyre si edhe si një mjet komunikimi mes shtetasve që ata kanë në kujdesin e tyre dhe vetë punonjësve të policisë.

Prej rreth 3 vitesh tashmë në drejtoritë dhe komisariatet e policisë së vendit është dërguar një model i regjistrimit të kërkesë ankesave, së bashku me udhëzuesin përkatës të përdorimit të tij. KSHH vlerëson pozitivisht këtë iniciativë për të garantuar këtë të drejtë ligjore, por me keqardhje konstaton se thuajse në të gjitha komisariatet e monitoruara ky rregjistrim ishte i pa plotësuar, i keq plotësuar²⁰ ose i plotësuar fare pak. Në disa komisarate këto regjistra mbaheshin në zyrat e shefit të komisariatit dhe jo pranë dhomave të sigurisë²¹. Shpeshherë nga regjistri rezultonte se nuk kishte asnjë kërkesë/ankesë. Kolonat e vrojtuar dhe regjistrat e posaçëm në shumicën e rasteve nuk ishin të plotësuar. Edhe në rastet kur në to kishte shënime, ato nuk pasqyronin dhe dokumentonin qartë llojin e kërkesë/ankesës. Përgjithësisht, plotësimi i regjistrave ishte me fjali standarde dhe “të pakujdesshme”. Po ashtu, kërkesë/ankesat qoftë ato të shkruara, qoftë ato të gjendura në regjistra, nuk arkivoheshin.

Nga vëzhgimet ka rezultuar se shtetasit e shoqëruar/ndaluar/arrestuar e ushtronin të drejtën e tyre të ankesës edhe duke e paraqitur atë përmes një letre të shkruar.

²⁰ Si në rastin e Komisarariatit të Fierit.

²¹ Përveç komisaritatit të Fierit, Përmetit, Korçës, Shkodrës etj.

Zakonisht, kjo ofrohej nga stafi i policisë në rastet kur kërkohet diçka e tillë. Megjithatë ka pasur edhe raste si ai vërejtur në komisariatit e Korçës ku pranë dhomave të sigurisë ishte vendosur një kuti për kërkesë/ankesat mbi të cilën ishin vendosur shkopa gome.

Një rast i tillë mbetet flagrant jo vetëm në shkelje të rregullave për mbajtjen e mjeteve të përdorimit të forcës, por dhe krijimit të një klime presioni që mbjell frikë tek shtetasit e ndaluar/arrestuar nëse ata guxojnë të bëjnë kërkesë apo ankesë. Kjo çon në mosgarantimin dhe shkeljen e të drejtës të kërkesë/ankesës.²²

KShH rekomandon që mbajtja e rregullt e dokumentacionit, të mos konsiderohet si një përmbushje e parëndësishme (formale), por të krijohet mendësia dhe praktika se dokumentacioni i rregullt pasqyron dhe reflekton dinamikën ditore të punës.

1.2 E DREJTA E NJOFTIMIT/INFORMIMIT (TË AKUZËS DHE NJOFTIMIT TË FAMILJARËVE);

E drejta e njoftimit/informimit të akuzës, si dhe njoftimi i familjarëve përbëjnë dy elementë të cilat parashikohen në mënyrë të veçantë, si të drejta themelore nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Konkretisht, neni 5, paragrafi 2 i KEDNJ shprehet si më poshtë:

“Çdo person i arrestuar duhet të informohet brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me çdo akuzë që i bëhet”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 28, pika 1 si më poshtë:

“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.

Rëndësia e njoftimit të akuzës, si dhe familjarëve apo personave të tjerë të kontaktit, qendron te elementi bazik i cili ofron garantimin e të drejtave dhe lirive themelore konform dispozitave ligjore dhe normative.

KShH ka evidentuar rastin e të miturit të shoqëruar në Komisariatit e Shkodrës, i cili nuk ishte informuar se përse ishte shoqëruar në mjediset e policisë dhe po kështu, familjarët nuk ishin njohur me shkaqet e këtij shoqërimi.

Sa i takon njohjes me të gjitha të drejtat gjatë momentit të shoqërimit/ ndalimit/ arrestimit, u konstatua se personave të shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar u bëheshin të ditura të drejtat me gojë, gjatë procedurës së marrjes në pyetje në ambientet e

²² Nga informacioni i marrë nga DPPSH, deri në muajin Nëntor 2014 janë marrë 37 kërkesë ankesa nga disa prej DPQ Durrës, Kukës, Vlorë etj. të cilat janë ndjekur nga strukturat përkatëse.

komisariatit. Përgjithësisht, komunikimi me gojë i të drejtave nuk realizohet që në momentin e parë të kufizimit të lirisë (shoqërimit, ndalimit, arrestimit).

Gjatë vëzhgimeve rezultoi që përgjithësisht pankarta me të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar gjendej e afishuar në dhomat e shoqërimit/ndalimit/arrestimit, si dhe në vende të dukshme të mjediseve të komisariateve.

Aspekt tjetër pozitiv shënon dhe ndjekja e praktikës së kundërfirmës. Në momentin që të drejtat iu lexoheshin personave të shoqëruar/ ndaluar /arrestuar pasi u ishin bërë të ditura me gojë, u jepej kopje këtyre të fundit përkundrejt firmës, kur vendoseshin në dhomat e ndalimit. Kjo praktikë e mirë u has në Komisaratin e Gjirokastrës, Përmetit, Shkodrës, Fierit, Korçës etj.. Megjithatë ka edhe raste si në komisaratin e Vlorës ku u konstatua se Deklaratat e të Drejtave u ishte dhënë të ndaluarve pak momente para mbërritjes së grupit të monitoruesve të KShH-së.

Dimension tjetër i të drejtës për informim lidhet me njoftimin e familjarëve/personave të afërm për vendodhjen familjarit të tyre në komisarati. Vlen për t'u evidentuar përpjekja e stafit të policisë që, edhe në rast të pamundësisë të personave ose mungesës së fondeve buxhetore për të realizuar telefonatën, një komunikim i tillë realizohej me të ardhurat personale të personelit. Tendenca kryesore është realizimi i njoftimit të familjarëve, sidomos në rastet e shoqërimit/ndalimit/arrestimit të të miturve. Megjithatë, në disa komisarite, si psh në komisaratin e Koplikut etj., u hasën problematika me **plotësimin formal dhe të paplotë** të regjistrave/kolonave përkatëse të dokumentimit të procedurës së njoftimit të familjarëve, për shkak të formateve të vjetruar të regjistrave ose të praktikave të trashëguara të plotësimit të tyre.

1.3 E DREJTA PËR T'U MBROJTUR ME AVOKAT;

E drejta për t'u mbrojtur përbën një nga garancitë më thelbësore për personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar në një shtet demokratik. Si një e drejtë themelore bazë, ajo sanksionohet nga legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar. Kështu KEDNJ parashikon në nenin 5, pika 3/b dhe c si më poshtë:

“Çdo i akuzuar për një veprë penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”.

Po ashtu, në nenin 28, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e gjejmë këtë të drejtë të shprehur, si vijon:

“Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.

Sigurimi i të drejtës për t’u mbrojtur me avokat mundëson në mënyrë efektive të drejtën e mbrojtjes që iu duhet ofruar personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

Gjatë vëzhgimeve u vërejt ndjeshmëri e personelit të policisë për ofrimin e mbrojtjes me avokat ndaj personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar. Megjithatë, e drejta e mbrojtjes, njoftimit të avokatit u bëhej e ditur personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar vetëm gjatë procedurës së marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e parë të kufizimit të lirisë. Për shkak të cilësimit si të ligjshme të procedurave të sipërpërmendura, është e domosdoshme prezenca e avokatit²³.

Në rastet kur këta persona nuk kishin mundësinë e sigurimit të një avokati, ky i fundit sigurohej me avokatë nga lista e shpalluar (lista e avokatëve të caktuar kryesisht). Listat zakonisht gjendeshin në mjediset e drejtorive të policisë (komisariatet pranë drejtorive), ndërsa në komisariatet e tjera, përgjithësisht nuk kishte të tilla lista.

Në përgjithësi në institucionet e vëzhguara, u vu re se personeli mbante në rregull regjistrin e takimeve me avokatët (ora e takimit, numri i licencës, nënshkrimi etj.). Po ashtu, u vërejt se në rubrikën shënime të avokatëve, nuk kishte asgjë të shënuar nga avokatët²⁴ për raste shkelje të mundshme të procedurave. KShH e ka evidentuar edhe më parë këtë gjetje si të pazakontë, duke marrë parasysh se ka shumë pretendime dhe ankesa për shkelje të të drejtave të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

Megjithatë vlen të evidentojmë sërish se e drejta për mbrojtje ligjore përmes avokatit nuk respektohet që në momentet e para të ndalimit, por edhe në ndonjë rast, kjo e drejtë nuk garantohet në komisariat, por në Gjykatë. Më konkretisht, vlen të evidentohet rasti i Komisarariatit të Tropojës, ku personeli i policisë nuk ishte në dijeni për ekzistencën e listës së avokatëve (të caktuar kryesisht). Për më tepër, personi i ndaluar në këtë komisariat, i intervistuar nga vëzhguesit e KShH-së, bëri të ditur se ishte marrë në pyetje pa prezencën e avokatit.

1.4 E DREJTA PËR SHËRBIM SHËNDETËSOR;

Ofrimi i shërbimit shëndetësor parashikohet si një nga objektivat sociale në nenin 59 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë:

²³ Nevojitet që në process-verbalin që hartohet për këtë qëllim, të jetë firma e avokatit, nëse personi e ka kërkuar një të tillë.

²⁴ Në të gjitha institucionet e vëzhguara në të gjithë vendin, nuk u vërejt asnjë shënim specifik për raste shkeljesh të procedurave (që lidhen me të drejtat që gëzojnë shtetasit e shoqëruar/ndaluar/arrestuar).

“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjesisë private, synon:

....c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm...”

Po ashtu, standardet e KPT-së sanksionojnë se "Personat nën kufizim e policisë duhet të kenë të drejtën e njohur zyrtarisht për akses tek një mjek. Me fjalë të tjera, një mjek duhet gjithmonë të thirret pa vonesë nëse një person kërkon një ekzaminim mjekësor; oficerët e policisë nuk duhet të filtrojnë kërkesa të tilla. Më tej, e drejta e aksesit tek një mjek duhet të përfshijë të drejtën e personit për t'u ekzaminuar, nëse ai dëshiron, nga një mjek i zgjedhur prej tij / saj (përveç ndonjë ekzaminimi mjekësor të nevosjshëm, të kryer nga një mjek i thirrur nga policia). Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave nën kufizim policor duhet të kryhet në konfidencialitet, jo në prezencë të zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe, përveç nëse mjeku në fjalë kërkon ndryshe në ndonjë rast të veçantë, në prezencë të punonjësve të policisë. Është gjithashtu e rëndësishme që personat të cilët janë liruar nga kufizimi policor, pa dalë përpara një gjykate, kanë të drejtë të kërkojnë drejtpërdrejt një ekzaminim mjekësor / certifikatë nga një mjek i njohur i mjekësisë ligjore²⁵".

Përgjithësisht, nga vëzhgimet ka rezultuar se të gjitha drejtoritë e policisë kanë personel mjekësor në detyrë, kryesisht mjekë, të cilët përpiqen të mbulojnë me shërbim mjekësor të gjitha komisariatet e policisë në varësi. Mjekët kishin dhomat e tyre të punës si dhe dokumentacionin ku evidentonin punën e përditshme (regjistrin e vizitave mjekësore). Nga intervistat me mjekët, rezultuan mungesa të theksuara të furnizimit me ilaçe, si një gjendje e cila nuk po gjen zgjidhje prej një kohe të gjatë. Në një letër drejtuar DPP, lidhur me situatën e konstatuar në komisariatit e Beratit, KShH ka bërë prezent se shërbimi shëndetësor i ofruar në këtë institucion vuante nga mungesa e burimeve financiare për të mundësuar efektivisht ofrimin e shërbimit. Prej më se 4 vitesh, zëri përkatës i buxhetit për medikamente mjekësore ishte 0 Lek.

KShH vlerëson përpjekjet e stafit të policisë në komisariate për sigurimin e shërbimit shëndetësor përmes bashkëpunimit me spitalet civile, si dhe mjekëve të caktuar të shërbejnë në komisariate.

Aksesi i menjëhershëm tek një mjek i personit të shoqëruar/arrestuar/ndaluar merr rëndësi thelbësore sidomos në rastet e evidentimit të tejkalimit të forcës nga punonjësit e policisë në momentet e para të ndalimit. Evidentimi dhe ndjekja mjekësore e këtyre rasteve mbetet përgjegjësi parësore e mjekut të institucionit policor. Ndaj merr rëndësi funksionimi i këtij shërbimi jo vetëm si shërbim shëndetësor, por edhe si një garanci më shumë për parandalimin dhe raportimin e rasteve kur përdorimi i dhunës ka ndodhur.

²⁵ Standardet e KPT, fq.11-12, §42

1.5 KONSATIME TË TJERA

Gjatë këtij raundi vëzhgimesh i është kushtuar rëndësi edhe **të drejtës për ajrim** që kanë personat që mbahen në mjediset e policisë. Kjo është një e drejtë themelore që është theksuar edhe në raportet e Komitetit për Parandalimin e Torturë (KPT) si edhe në raportin e dy viteteve të fundit të KShH²⁶. Duke marrë parasysh që shtetasit e ndaluar/arestuar mund të rrinë për disa ditë në mjedise të izoluar, atyre duhet t'u krijohet mundësia për kryerjen e ajrimit në mjedise të përshtatshme. Kjo është një e drejtë ligjore dhe për rrjedhojë duhen marra masa të menjëhershme për sigurimin në praktikë të kësaj të drejte për të gjithë personat që mbahen në këto mjedise të mbyllyra.

Furnizimi me ushqim i personave të ndaluar përgjithësisht rezultoi funksional. Strukturat policore e kishin zgjidhur këtë shërbim nëpërmjet lidhjes së kontratave për sigurim të vakteve ushqimore me katering, shërbim ky i vërejtur në të gjitha komisariatet që gjendeshin pranë drejtorive të policisë. Ndërsa në disa komisariate të policisë së rrethinave të qyteteve nuk ofrohej ushqim, por lejoheshin familjarët e personave të ndaluar ta mbulonin këtë shërbim. Dyzimit të standardeve duhet t'i jepet fund.

Vëzhgimi i KShH-së u përqendruara edhe në raportin ose përqindjen midis **personelit femër dhe atij mashkull** që shërben në strukturat e policisë. Në përgjithësi, në komisariatet e policisë pranë drejtorive të policisë kishte personel femër të strukturave policore (nga 5 deri në 10 punonjëse). Ndërsa në komisariatet e policisë jo pranë drejtorive përkatëse (si psh në Koplik, Lushnje, Sarandë, Tropojë etj.), mungesa e personelit femër përbënte problem për ofrimin e shërbimit në raste të shoqërimit/ndalimi/arrestimit të grave/vajzave.²⁷

I mituri në konflikt me ligjin gëzon disa të drejta shtesë, që rrjedhin nga parimi kushtetues i "Interesit me të lartë të fëmijës". Po ashtu, respektimi i kërkesave të Kodit të Procedurës Penale kërkon që gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me personat e mitur (*shoqërimi, marrja e deklarimeve, kryerja e veprimeve të tjera procedurale*) nga oficerët e policisë gjyqësore duhen realizuar domozdoshmërisht me praninë e prindërve, mbrojtësve ligjorë dhe të psikologut. Dëshirojmë të risjellim në vëmendje, rastin e konsatuar në komisariatin e Shkodrës, në të cilin një person i mitur u gjet në korridoret e këtij institucioni, tek priste të merrej në pyetje nga një punonjëse i sektorit të krimeve të rënda. I mituri ishte marrë nga forcat e policisë në shtëpinë e tij, pa e vënë në dijeni për motivet e marrjes, pa u shoqëruar nga një nga prindërit dhe, për më tepër, kishte rreth 3 orë që priste për t'u marrë në pyetje.

²⁶ Raport "Mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në drejtoritë dhe komisariatet e policies në institucionet eparaburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale" 2012, 2013.

²⁷ Nga informacioni i marrë nga DPPSH u informuam se aktualisht janë duke përfunduar trajnimin një grup prej 550 punonjësish të rinjë, 250 prej të cilëve janë gra/vajza, të cilat do të planifikohen të punojnë në komisariatet ku nevojitet shtesë personeli policor.

Problematike mbetet situatat sa i përket **trajtimit të personave të sëmurë mendorë**. Ka dy çështje që vlejné të përmenden. Çështja e parë lidhet me shoqërimet e kryera nga forcat e policisë të këtyre të sëmurëve në spitalet psikiatrike. Të ndikuar nga kërkesat e familjarëve apo e të afërmeve, strukturat e policisë forcërisht bëjnë shoqërimin e këtyre të sëmurëve drejtpërdrejt në spitalet psikiatrike. Shpesh, nga mosnjohja e trajtimit specifik në rastet e pacientëve të axhituar, ose nga perceptimi stigmatizues, forcat e policisë ushtrojnë forcë të panevojshme. Çështja e dytë lidhet me personat në konflikt me ligjin që kanë probleme të shëndetit mendor. Pak ose aspak trajtim i diferencuar u ofrohet këtyre personave gjatë qëndrimit të tyre në mjediset e policisë.

II. Sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave në institucionet e policisë

Në përputhje me gjetjet e prezantuara në kapitullin e mësipërm, KShH dëshiron të bëjë prezent sugjerimet e tij, me synim përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut të individëve që mbahen në mjediset e policisë duke pasur parasysh legjislacionin vendas dhe standardet ndërkombëtare të fushës. KShH sugjeron si më poshtë:

E drejta për trajtim dinjitoz

- KShH vlerëson punën dhe përpjekjet e strukturave policore për përmirësimin e mjedisëve të jashtme dhe ndërtesave të disa drejtorive dhe komisariateve të policisë, megjithatë sugjeron që i njëjti kujdes duhet treguar edhe për gjendjen infrastrukturore të ambienteve të shoqërimit/ndalimit/arrestimit ku mbahen individët e privuar nga liria. Siç është konstatuar në pikën 2.1.1 të këtij raporti gjendja në disa prej këtyre mjedisëve shkakton nevojën e ndërmarrjes së hapave urgjente për përmirësimin e situatës së konstatuar.
- Detyrimi për respektimin e dinjitetit të personave të privuar nga liria, është kryefjala e punës së strukturave të policisë në një shtet demokratik. Në këtë kontekst, nevojitet ndryshimi i mentalitetit të vjetruar, shprehje e të cilit është forca fizike si mjet efikas për luftimin e krimit. Praktika të të cilat shkelin ligjin dhe nuk ofrojnë standardet minimale të trajtimit të shtetasve, si ato të konstatuara në pikën 2.1.2 të këtij raporti duhet t'u jepen fund. KShH sugjeron që strukturat drejtuese të policisë, të marrin masa konkrete kur konstatojnë raste të shkeljes së ligjit dhe përdorimit të dhunës duke i vënë përpara përgjegjësive penale dhe administrative këta punonjës policie. Personeli i policisë duhet të jetë i vetëdijshëm që zbatimi i detyrës duhet të realizohet vetëm nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjit dhe kufizimeve të vendosura prej tij.

- Të drejtat procedurale të shtetasve të kufizuar nga liria nuk respektohen që në momentin e parë të kufizimit të lirisë, por fillojnë e zbatohen në momentin e marrjes në pyetje të personave në konflikt me ligjin. Ndonëse ka një ndërgjegjësim më të lartë të strukturave të policisë për trajtimin e grave dhe të të miturve, ende hasen raste gjatë monitorimit që të tilla garaci ligjore nuk plotësohen, sic është evidentuar në pikën 2.1.3 të këtij raporti. KShH sugjeron që autoritetet drejtuese të policisë të udhëzojnë vazhdimisht personelin e tyre për nevojën e trajtimit të diferencuar të të miturve në konflikt me ligjin, si dhe të zbatimit të duhur të standardeve të vendosura në ligj të procedurës së marrjes në pyetje të personave të kufizuar nga liria.
- KShH shpreh shqetësimin e tij në lidhje me proporcionalitetin e forcës së ushtruar nga forcat e policisë, në përputhje me nenin 93 të ligjit “Për policinë e shtetit”, në të cilin sanksionohet se *“Masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë dhe ajo nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur”*. KShH sugjeron që ndaj strukturave të policisë që përfshihen në të tilla situata të merren masat e duhura, për t’i dhënë fund veprimeve arbitrare të keqpërdorimit të pushtetit.
- Nga konstatimet e vëzhgimeve ka rezultuar problematikë me transferimet e personave të ndaluar/arrestuar për në institucionet e paraburgimit sidomos në institucionet e Tiranës. Nga informacioni zyrtar i marrë gjatë tryezës së prezantimit të versionit parapak të raportit të monitorimeve, u konfirmua se ky problem ishte zgjidhur për sa i takon institucioneve relevante të Tiranës. Megjithatë, KShH sugjeron që drejtuesit e institucioneve të policisë dhe ato të sistemit të burgjeve të gjejnë zgjidhje efektive dhe afat-gjata sa i takon vonesave për transferimin e personave që kanë marrë dënim më vendim të formës së prerë nga gjykata. KShH sugjeron krijimin e një procedure të qartë për transferimin, me qëllim që të bëhet e mundur nxjerrja e përgjegjësave kur transferimi nuk realizohet në kohë.
- Duke e vlerësuar si një të drejtë universale dhe kushtetuese të drejtën për kërkesë-ankesë, KShH sygjeron që strukturat drejtuese të DPPSH dhe të drejtorive apo komisariateve të policisë së vendit, t’i japin rëndësinë e nevojshme mbajtjes së rregullt të dokumentacionit dhe repektimin e procedurave standarde të kërkesë-ankesave. KShH sugjeron që garancitë ligjore që sjell zbatimi i kësaj procedure, të mos konsiderohen si përmbushje sipërfaqësore e një detyrimi formal, por të krijohet praktikë e unifikuar dhe efektive në të gjitha komisarariatet e policisë nëpërmjet së cilës shtetasit të ndiejnë që kërkesat dhe/ose ankesat e tyre dëgjohen dhe trajtohen me seriozitet.

E drejta e njoftimit/informimit (të akuzës dhe njoftimit të familjarëve)

- Njoftimi i akuzës, si dhe familjarëve apo personave të tjerë të kontaktit, qendron ofrojnë themel të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të

privuar nga liria. KShH vlerëson pozitivisht vendosjen e pankartave informuese me të drejtat e personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar në mjediset e komisariateve, si dhe praktikën e dhënies së deklaratës së të drejtave të tyre. Megjithatë, KShH sugjeron që të realizohet komunikimi me gojë i këtyre të drejtave, që në momentin e parë të kufizimit të lirisë, sikurse garantohet në legjislacionin në fuqi.

E drejta për t'u mbrojtur me avokat

- Sigurimi i të drejtës për t'u mbrojtur me avokat mundëson në mënyrë efektive të drejtën e mbrojtjes që iu duhet ofruar personave të shoqëruar /ndaluar /arrestuar. KShH sugjeron se e drejta për mbrojtje ligjore përmes avokatit duhet të garantohet që në momentet e para të shoqërimit/ndalimit/arrestimit. Garant të saj duhet të jenë së pari vetë punonjësit e strukturave të policisë, të cilët në zbatim të ligjit, duhet të njoftojnë dhe të marrin masat e tjera teknike për garantimin efektiv të kësaj të drejte themelore.

E drejta për shërbim shëndetësor

- Aksesi i menjëhershëm tek një mjek i personit të shoqëruar/arrestuar/ndaluar merr rëndësi thelbësore sidomos në rastet e evidentimit të individëve që kanë nevojë për kujdes shëndetësor, edhe për shkak të konflikteve me forcat e policisë. Evidentimi dhe ndjekja mjekësore e këtyre rasteve duhet të mbetet përgjegjësi parësore e mjekut të institucionit të policisë. Kjo shërben si garanci për parandalimin dhe raportimin e rasteve kur përdorimi i dhunës ka ndodhur. Gjithashtu, KShH sugjeron evidentimin dhe bërjen prezent të menjëhershëm të të gjitha rasteve me shenja dhune tek organet e prokurorisë. për të përmbushur respektimin e të drejtës për shërbimin e duhur shëndetësor, KShH sugjeron mbështetjen me burime njerëzore dhe materiale (pajisje për realizimin e detyrës dhe/ose medikamente) të strukturave shëndetësore në varësi të Policisë së Shtetit.

Konstatime të tjera

- Duke marrë parasysh që shtetasit e ndaluar/arrestuar mund të rrinë për disa ditë në mjedise të izoluar, atyre duhet t'u krijohet mundësia për kryerjen e ajrimit në mjedise të përshtatshme. Kjo është një e drejtë ligjore dhe për rrjedhojë duhen marra masa të menjëhershme për sigurimin në praktikë të kësaj të drejte për të gjithë personat që mbahen në këto mjedise të mbyllyra.
- KShH dëshiron të vlerësojë pozitivisht praktikën e furnizimit me ushqim të personave të ndaluar në disa prej komisariteve të policisë të vëzhguara. Ndaj sugjeron që kjo praktikë të shtrihet në të gjithë komisaritet e policisë së vendit.

- Mungesa e personelit femër përbënte problem për ofrimin e shërbimit në raste të shoqërimit /ndalimi /arrestimit të grave /vajzave. Ndonëse pritet shtim personeli femëror, KShH sugjeron përshejtimin e procedurave, në mënyrë që efektivisht të zgjidhet ky problem, sidomos në institucionet e policisë të rretheve të largëta.
- I mituri në konflikt me ligjin gëzon disa të drejta shtesë, që rrjedhin nga parimi kushtetues i “Interesit me të lartë të fëmijës”. Ndaj, KShH sugjeron respektim rigoroz nga ana e strukturave të policisë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, për kryerjen e veprimeve procedurale me personat e mitur (*shoqërimi, marrja e deklarimeve, kryerja e veprimeve të tjera procedurale*) në të cilat kërkohet të realizohen domosdoshmërisht me praninë e prindërve/kujdestarit ligjor, mbrojtësve ligjorë dhe të psikologut.
- Problematike mbetet situatat sa i përket trajtimit të personave të sëmurë mendorë. KShH sugjeron që t’i kushtohet më shumë vëmendje shoqërimeve të kryera nga forcat e policisë të të sëmurëve për në spitalet psikiatrike. Nevojitet një përgatitje me e mirë profesionale e forcave policore që shoqërojnë të sëmurët mendorë nëpër spitalet psikiatrike, për të bërë një neutralizim profesional të këtyre të sëmurëve, me qëllim dëmtimin sa më pak të tyre. Po ashtu, personave të sëmurë mendorë në konflikt me ligjin, që qëndrojnë në ambientet policore, të mund t’u ofrohet një trajtim i diferencuar, në përputhje me nevojat specifike që ata kanë.
- Duke marrë parasysh sa më sipër, KShH evidenton nevojën e mëtejshme të rritjes profesionale të strukturave të policisë sa i takon aspekteve teorike dhe praktike të zbatimit të ligjit. KShH sugjeron realizimin e trajnimeve bazë dhe vazhduese që të adresojnë edhe çështjet e ngritura në këtë raport.

PJESA E DYTË SITUATA NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

III Gjetje lidhur me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në institucionet penitenciare

Standardet ndërkombëtare dhe zhvillimet e sotme të së drejtës penale orientojnë shtetet të përdorin kufizimin e lirisë/burgimin si masë të fundit, duke marrë në konsideratë hetimin për veprat kriminale dhe mbrojtjes së shoqërisë dhe viktimës. Praktikrat e mira evropiane na sjellin modele të devijimit nga masa “arrest me burg” për shtetas në konflikt me ligjin që përbëjnë rrezikshmëri të ulët për shoqërinë dhe në rastet e ndjekjeve penale për krime relativisht të lehta. Po ashtu, shtetet evropiane tentojnë të lehtësojnë politikrat e tyre penale, sidomos për një sërë veprash penale të lehta. Dënimet alternative janë gjerësisht të përdorura në kësi rastesh, duke vendosur një balancë të drejtë midis llojit të krimit dhe masës së dënimit që jepet për të. Veçanërisht në rastin e të miturve, standardet ndërkombëtare nxisin shmangien e dënimit me burgim për të miturit.

Nëpërmjet zbatimit të dënimit me burgim, individët humbin të drejtën themelore të lirisë së lëvizjes, por ata duhet të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tjera themelore të njeriu, si dhe të trajtohen në respekt të dinjitetit të tyre si qenie njerëzore.

3.1 Mbipopullimi;

Çështja më shqetësuese me të cilën po përballet sistemi i burgjeve në vendin tonë, aktualisht, është mbipopullimi. Rezulton se në institucionet e paraburgimit dhe në burgje gjenden të sistemuar 6022 persona, të privuar nga liria²⁸, ndërkohë që kapaciteti i mundshëm i gjithë sistemit është për 4537 persona, ose e shprehur ndryshe gjendja aktualisht është 32% mbi kapacitetin e lejuar. Kjo shifër shënon përqindjen më të lartë të mbipopullimit që ka përjetuar sistemi i burgjeve, deri më sot. Vëzhgimet e kryera nga

²⁸ Sipas të dhënave zyrtare të ofruar nga DPB datë 19 nëntor 2014.

KShH kanë konstatuar se në disa institucione burgimi e paraburgimi, mbipopullimi shkon deri në 100% mbi kapacitetin që lejon infrastruktura përkatëse²⁹.

Kjo situatë alarmante e mbipopullimit krijon kushte për cenimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe për trajtimin çnjerëzor, e poshtërues të tyre, në kuptimin e nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga monitorimet e KShH është konstatuar se mbipopullimi ka shkaktuar mosrespektim të normës ligjore të hapësirës, që personat me liri të kufizuar duhet të kenë në dispozicion; vendosjen e tyre për të fjetur në tokë dhe me shtresa tejet të konsumuara; vonesa në marrjen e shërbimit shëndetësor, ose uljen e cilësisë së këtij shërbimi; pamundësi për të gëzuar të drejtat në masën dhe cilësinë e sanksionuar me ligj, si p.sh përdorimin e banjave, dusheve, mjediseve të ajrimit, pjesëmarrjen në aktivitete sportive-argëtuese dhe në ato me karakter social, si dhe përfitimin e lejeve.

Këto pasoja janë bërë më të rënda edhe për faktin se mbipopullimi nuk është shoqëruar me shtimin e personelit, shtimin e buxhetit financiar, shtimin e furnizimit me medikamente të këtyre institucioneve, ose shtimin e pajisjeve dhe nevojave të tjera që ato kanë.

KShH është i mendimit se mbipopullimi në këto institucione ka ardhur si rrjedhojë e disa faktorëve. Të tillë përmendim zbatimin me përparësi të masës së sigurimit "*Arrest me burg*" nga ana e gjykatave edhe kur rrezikshmëria e veprës së kryer dhe e personit të akuzuar mund të justifikonin masa sigurie më të lehta; zbatimi në masë të ulët i dënimeve alternative me burgimin; tej zgjatja e proceseve gjyqësore; ndërlikimi dhe vështirësimi i procedurës për të kërkuar faljen e dënimit; dërgimi, në mënyrë të kundraligjshme, i personave me masë mjekësore "*mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor*" për ta vuajtur masën pranë institucioneve të burgimit; si dhe probleme të administrimit të të burgosurve dhe paraburgosurve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Shkak tjetër i rëndësishëm, që ka çuar në shtimin e popullatës në institucionet e burgimit, paraburgimit janë dhe ndryshimet e shumta ligjore, të viteve të fundit, që kanë ashpërsuar masat e dënimeve penale, si dhe rritja e presionit ndaj institucioneve zbatuese të ligjit, për të ashpërsuar masat e sigurimit e të dënimit ndaj veprimeve të paligjshme si, vjedhja e energjisë elektrike, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, ndërtimet pa leje etj..

KShH është i vetëdijshëm që zbatimi i politikës penale është kompetencë e organeve të drejtësisë, por ne kemi ardhur në dijeni të eksperiencave më të mira botërore, të cilat tregojnë se një politikë penale, që synon uljen e kriminalitetit, është më efektive në se përdoren më mirë masat parandaluese, përdoret drejtësia restauruese dhe zgjerohet

²⁹ Përveç Qendrës Spitalore të Burgjeve dhe IP Kukës dhe Tropojë, të gjithë institucionet e tjera të vëzhguara ishin nivele të ndryshme mbipopullimi, ndër më të lartat u vërejt në IP Tepelenë, me kapacitet mbi 140% e kapacitetit të lejuar.

aplikimi i dënimeve alternative me burgimin. Në këtë drejtim mendojmë se, krahas masave të tjera, duhen informuar e sensibilizuar, veçanërisht, gjyqtarët e prokurorët.

3.2 Kushtet e jetesës në institucionet penitenciare;

Kushtet e jetesës në burg përfshijnë një gamë të gjerë objektesh dhe pajisjesh të nevojshme në një regjim burgimi, të tilla si, mjediset e banimit në regjimin e brendshëm, mjediset e jashtme, dhomat e observimit, dhomat e veçimit, dhomat e të burgosurve, mjedisi i ajrimit, tualetet dhe dushet, mjediset e rikrijimit. Me pak fjalë, të gjitha mjediset e institucionit në të cilat zhvillohet dinamika e përditshme e jetesës në institucion.

Në përmbushje të nenit 31 “Diferencimi i institucioneve për qëllime trajtimi caktimi dhe grupimi i të dënuarve” të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 të ndryshuar, KShH evidenton si pozitive masat e marra gjatë periudhës shtator-dhjetor 2014 nga DPB për të sistemuar disa kategori të paraburgosurve si të miturit dhe gratë në IP “Jordan Misja”, të cilët për shkak të kushteve të këqija në këtë institucion, janë vendosur përkatësisht në I EVP Kavajë dhe I EVP “Ali Demi”.

Gjithashtu, pozitive janë edhe masat e marra për mbylljen e IP Kukës dhe për ta kaluar këtë institucion në një mjedis më të përshtatshëm infrastrukturor³⁰. KShH inkurajon DPB-në për të përshpejtuar hapat për fillimin e procedurës së marrjes së mjedisit të ri. Kalimi nga IP Berat në institucionin e ri të ndërtuar dhe inaguaruar së fundmi është gjithashtu për t’u përshëndetur. Kalimi i të paraburgosurve nga IP Tropojë tek ndërtesa e re për këtë qëllim, është një tjetër hap pozitiv i hedhur në përmirësimin e kushteve të jetesës për të para/burgosurit në këto institucione.

Ka një dallim midis situatës së mjediseve të jashtme të institucioneve dhe atyre të brendshme, ku këto të fundit ishin më të varfra sa i takon higjienës dhe rregullit të përgjithshëm. Vlen të evidentohen si pozitive marrja e masave për përmirësimin e paraqitjes së institucioneve në Lezhë, në Tropojë, në Korçë, “Jordan Misja” Tiranë etj., gjithsesi, mbetet problem higjiena e mjediseve të brendshme në disa institucione. Po ashtu, në thuajse të gjitha institucionet (*përveç IP Tropojë*) kishte nevoja urgjente për të pajisur një pjesë të të burgosurve me dyshekë, disa prej të cilëve, drejtuesit e institucioneve i kishin siguruar edhe privatisht.

Megjithatë, nga misionet e monitorimit, që KShH ka realizuar këtë vit në sistemin shqiptar të burgjeve ka rezultuar se ka problematika të qënësishme sa i takon kushteve të jetesës në institucionet e paraburgimit dhe burgjet e vendit, të ndikuara këto nga mipopullimi i lartë, si dhe mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme për ta përballuar këtë situatë.

³⁰ Janë masa që lidhen me negociata për marrjen e një godine të përshtatshme për mbajtjen dhe trajtimin e të paraburgosurve.

Problematikat kanë të bëjnë me prezencë të lagështirës në muret e kateve të para të ndërtesave, kushtet e varfra higjienike, vecanërisht të tualeteve dhe dusheve të përbashkëta (*përveç IP Durrës, në të gjitha institucionet e tjera të vëzhguara u konstatua ky problem*), mungesë të shtrojeve personale dhe pajisjeve të higjienës vetiake (*të gjitha institucionet e vëzhguara nuk kishin mundësi financiare për të blerë solucione higjienizimi të mjaftueshme për të mbajtur higjienën personale dhe të përbashkët*), mungesë uji të rrjedhshëm, papastërti në regjimet e brendshme dhe të jashtme të institucioneve (*u konsataua prezencë të plehrave në mjediset e jashtme në IEVP Peqin, Lezhë, Rrogozhinë, Lushnje etj.*).

- Mjediset e kuzhinës dhe cilësia e ushqimit;

Institucionet e vëzhguara kanë kuzhinën e tyre, për gatimin dhe shpërndarjen e ushqimit të burgosurit. Pozitiv paraqitet fakti se në kuzhinën e institucionit punonin edhe të burgosurit. Përgjithësisht, në mjediset e kuzhinave të institucioneve të vëzhguara u vu re rregull dhe pastërti. Kampionet e ushqimit ruheshin në bazë të standardeve të kërkuara. Standardi më i mirë i pastërtisë, i cilësisë dhe larmishmërisë së ushqimit ofruar të burgosurve u konstatua në IP Tropojë dhe IP Durrës. Ndërkohë linte për të dëshiruar situata e konstatuar në IEVP Rrogozhinë, Peqin, Tepelenë, Berat, etj. sa i takon pastërtisë së mjediseve dhe cilësisë së ushqimit. Vëzhguesit e KShH-së morën gjithashtu ankesa të të burgosurve për cilësinë e gatimit, si dhe për meny të varfër ushqimi (në IP Berat, IEVP Rrogozhinë).

Krahas ushqimit të përgatitur në institucion, të para/burgosurit lejoheshin të merrnin ushqim nga familja, sipas masës së lejuar në rregullore. Gjatë monitorimeve në disa institucione u vu re rradhë e gjatë e familjarëve që prisnin për takim dhe për futjen e ushqimeve në institucion. KShH edhe në konstatimet e paraqitura gjatë vitit 2013 ka evidentuar problematika lidhur me futjen e ushqimeve nga familjarët, gjë e cila ul sigurinë në institucionet penale si edhe krijon shumë probleme me ruajtjen e këtyre ushqimeve në kushte optimale në dhomat e banimit tek të para/burgosurit. Për këto dhe shumë arsye të tjera KShH ka sugjeruar që çdo institucion të marrë masa funksionimi të mirë të njësive tregtare si edhe të blerjes së ushqimeve nga këto njësi, ndërkohë që familjarët të arkëtojnë para në numrat e llogarisë së të para/burgosurve në vend të futjes së ushqimeve.

Njësitë tregtare funksiononin në çdo institucion. Në IEVP Rrogozhinë, KShH mori ankesa nga të burgosurit për çmime më të larta krahasuar me ato të tregur të asortimenteve që tregtoheshin në këtë njësi. Kishte lista të shpallura me çmimet relevante, por pretendimi i të burgosurve lidhej me faktin që çmimet bazë të tregut merreshin ato më të larta.

- Tualetet dhe dushet;

“Aksesi i nevojshëm për përdorimin e tualetit dhe mirëmbajtja e standardeve të mira të higjienës, janë komponentet thelbësore të një ambienti human.....më tej, të burgosurit duhet të kenë akses të përshtatshëm për përdorimin e dusheve ose tualeteve. Është gjithashtu e dëshirueshme të ketë ujë të rrjedhshëm, si dhe të jetë në dispozicion brenda dhomave të të burgosurve³¹.

Në lidhje me këtë, KShH konstaton se situata e përgjithshme e aksesit që duhet të kenë të burgosurit në tualete dhe dushe nuk ka probleme. Në çdo institucion ka një regjim të brendshëm që disiplinon oraret e veprimeve. KShH nuk ka marrë akese apo pretendime për cenim të qëllimshëm të aksesit në këto ambiente. Megjithatë, dëshiron të theksojë nevojën e menjëhershme të ndërhyrjes për të përmirësuar situatën e higjienës në këto ambiente. Mungesa e ujit ose ardhja me orar e tij në disa institucione (në I EVP Krujë, në IP Kukës, I EVP Peqin, I EVP Lezhë, IP “Jordan Misja”, I EVP Korçë, IP Berat etj.), si dhe mungesa e detergjenteve pastrues dhe higjienizues, rëndonin edhe më shumë gjendjen e konstatuar.

KShH dëshiron të sjellë në vëmendje këtu një rast të konstatuar në I EVP Tepelenë, në njërën nga ambientet e kthyer në dhomë për të burgosurit, në të cilën qëndronin 8 persona, nuk kishte tualet funksional. Ndër ta, 2 të burgosur ishin të sëmurë mendorë, njëri prej të cilit, për tualet, përdorte një kovë. KShH shprehet e shqetësuar për rastin në fjalë, sepse së bashku me situatën e mbipopullimit, efekti kumulativ i këtij fenomeni sjell pasojë të dëmshme të shëndetit të të burgosurve dhe për më tepër çon në trajtim degradues të këtyre shtetasve.

Përgjithësisht në institucionet e vëzhguata ofrohej ujë i ngrohtë. Por jo gjithmonë të burgosurit kishin akses të dushet, së pari për shkak të amortizimit të pajisjeve hidro-sanitare të nevojshme dhe së dyti, për shkak të mbipopullimit, grafiku i hartuar nga personeli, diktonte të bërit dush edhe një herë në 10 dite (siç ishte rasti në I EVP Korçë, në sektorin e observimit, apo në I EVP Rrogozhinë). Shpesh, të burgosurit laheshin në tualetet e dhomave (në ato I EVP që kishin tualet në dhomë, duke i mbuluar me batanije), pasi mbushnin kova me ujë të ngrohtë nga dushet.

- Kushtet në dhoma;

Mbipopullimi i lartë me të cilin përballëshin institucionet e vëzhguara i ka shtrirë efektet negative në të gjithë elementet e jetesës në institucionet e paraburgimit /burgjet. Në pamundësi për të akomoduar të gjithë të burgosurit, drejtuesit e institucioneve i kishin kthyer mjediset e tjera të punës në mjedise banimi. Si pasojë, shumë të burgosur nuk kishin krevat personal, sikurse e kërkon ligji. Shpesh ata flinin përtokë, në ndonjë rast edhe pa dyshek (sic u konstatua në IP Berat etj..) por vetëm duke vendosur batanijet përtokë, ose në krevat.

Sidomos në institucionet e vjetra ende në funksion, me mbipopullim të lartë (si I EVP Tepelena, IP Berat, I EVP Rrogozhinë, I EVP Lushnjë etj..) kushtet në dhoma nuk plotësonin standardet minimale të dritës, hapësirës personale etj..

³¹ Standardet e KPT-së, fq.19. paragrafi 49.

KShH dëshiron të evidentojë edhe një herë rëndësinë kyçe që ka infrastruktura e institucioneve të burgjeve në realizimin e misionit që ka në vetvete sistemi i burgjeve shqiptare. Ka shumë nevojë që kjo situatë të ndryshojë sa më parë, duke mbajtur parasysh se të tilla kushte, në vetvete, përbëjnë bazë për trajtim jo në respekt të dinjitetit njerëzor të të burgosurve.

3.3 Siguria dhe të ndjerit të sigurt

“Kur një shtet privon individin nga liria e tij, krijon detyrën e përkujdesjes për të siguruar që dinjiteti i atij personi, të respektohet. Shtetet duhet gjithashtu të sigurojë që burgjet janë të sigurta dhe të burgosurit, personeli, vizitorët dhe komunitetit i jashtëm të ndihen të sigurt gjithashtu. Këto dy detyrime nuk janë kontradiktore, por shkojnë krahas me njëri-tjetrin. Siguria dhe të ndjerit të sigurt mund të krijohen më mirë në një sistem të mirëdrejtuar dhe administruar me drejtësi, ku të burgosurit trajtohen me humanizëm dhe drejtësi”³².

Pra, klima e sigurt është një element kyç në mbarëvajtjen e jetës së të para/burgosurve dhe personelit në burgje. Sa i takon këtij aspekti, KShH dëshiron të sjellë në vëmendje rastet e konstatuara në disa institucione të tentativave për vetëvrasje apo të vetëvrasjeve.

Problematike paraqitej situata në institucionin Zahari, Krujë, ku para rreth tre muajsh kishte pasur një vetëvrasje të një të dënuari. Po ashtu, para një viti një tjetër i dënuar kishte vrarë veten. Tentativat për vetëvrasje ishin më të shpeshta, sidomos nga tre të dënuar, të cilët i kishin përsëritur tentativat deri në 5 herë³³ (dy ditë para vëzhgimit të KShH-së kishte ndodhur tentativa më e fundit). Ajo çka ishte shqetësuese, ishte mungesa e ndërhyrjeve psikosociale për të rehabilituar traumën që zakonisht pason këtë incident. Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen e autoriteteve përkatëse për të përdorur Udhëzuesit Administrativ “Mbi vetëvrasje”, të miratuar për përdorim që në vitin 2013.

Një tjetër institucion ku u konstatuan dy tentativa vetëvrasjeje, ishte I EVP Fushë-Krujë. Shqetësues ishte fakti se motivet e njërit prej të dënuarve për të realizuar tentativën për vetëvrasje ishte presioni i vazhdueshëm i të dënuarve të tjerë të dhomës, që ta largonin nga ajo dhomë.

Sigurisht, tentativat për vetëvrasje apo vetëvrasjet kanë arsye të ndryshme pse ndodhin, por krijimi i një atmosfere ku si shtatasit e paraburgosur dhe ata të dënuar nga njëra anë dhe personeli nga ana tjetër duhet të bashkëjetojnë dhe bashkëpunojnë në kushtet ku të gjithë të ndihen të sigurt, është baza e një funksionimi të mirë të institucionit që parandalon situata dhe incidente të rënda.

³² Andreë Coyle, *A Human Rights Approach to Prison Management: Handbook for Prison Staff* (International Centre for Prison Studies, 2002) fq.58.

³³ Pra, rreth 15 tentativa për vetëvrasje, të kryera nga tre të dënuar gjatë muajve të fundit.

3.4 E drejta e kërkesës dhe e ankesës;

E drejta e kërkesës dhe ankesës, si e drejtë universale, që sanksionohet nga Kushtetuta e RSH-së, gjen pasqyrim dhe në nenin 8 të ligjit nr. 8328, dt. 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" sipas formulimit të mëposhtëm:

"Të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale. Kërkesat dhe ankesat duhet t'i drejtohen si rregull organit kompetent sipas këtij ligji, por të dënuarit kur e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror, ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit".

Funksionimi i mirë i mekanizmit të kërkesë-ankesave në burgje tregon mirë-qeverisje të institucionit të burgut, tregon nivel transparence dhe marrëdhënie të mira midis personelit dhe të burgosurve. Duke qënë iniciatorë të krijimit të këtij mekanizmi të brendshëm në burgje, KShH dhe ekspertët e tij kanë trajnuar personelin e institucioneve penitenciare për rëndësinë dhe mënyrën e standardizuar të funksionimit të tij. Duam të sjellim në vëmendjen tuaj se udhëzuesi admistrativ i standartizuar për trajtimin e kërkesë ankesave për gjithë sistemin e burgjeve i parapriu edhe ndryshimeve ligjore të disa dispozitave lidhur me këtë të drejtë kushtetuese. Duke e vlerësuar si të rëndësishme këtë të drejtë, KShH po ashtu, ka monitoruar edhe funksionimin e këtij mekanizmi gjatë monitorimeve të realizuara.

Në të gjitha institucionet e vëzhguara janë monitoruar dokumentet përkatës që lidhen me funksionimin e kësaj të drejte. Është konstatuar një rregjistër që evidenton kërkesat apo ankesat e të dënuarve (përvec se në IP Berat), drejtuar personelit të institucionit. Përgjithësisht, të burgosurit (përvec një rasti në IEVP Korçë) nuk kishin ankesa në lidhje me funksionimin e këtij mekanizmi. Kërkesat apo ankesat mund të bëheshin me shkrim apo me gojë, dorëzoheshin dorazi tek personeli i sektorit të kujdesit social apo sigurisë, ose në zarf të mbyllur në kuti ankesash në institucion. Megjithatë duhet thënë se jo të gjitha institucionet e vëzhguara kishin kuti funksionale kërkesë-ankesash.

Nga kqyrja e regjistrit të Kërkesë - Ankesave u vu re se kërkesat dhe ankesat më të shpeshta ishin: takim me drejtorin, kërkesë për lejet, ankesë për procedurat e zgjatura gjyqësore, ankesa për korrupsion nga personeli dhe trajtime të diferencuara, kërkesa për për takime apo telefonata shtesë me familjarët dhe takime speciale etj..

3.5 Trajtimi i të dënuarve. Rehabilitimi dhe riintegrimi; individualizimi i dënimit; programi ditor.

Programi ditor i mbushur me aktiviteteve të larmishme (punë, arsim, sport, etj.) merr rëndësi të veçantë për mirëqenien e të burgosurve. Të gjitha të gjitha institucionet e

paraburgimit/burgjet apo institucionet e veçanta, siç janë institucioni i Krujës apo Qendra Spitalore e Burgjeve (për të dënuarit rezidentë) duhet të ofrojnë aktivitete të qënësishme dhe kuptimplota për personat që kanë nën kujdes.

Për të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit duhet të krijohet mundësia e realizimit të programeve të individualizuara të trajtimit, gjë që rezultoi të ishte e vështirë shpeshherë për t'u realizuar në institucionet e monitoruara në kushtet e mbipopullimit. Megjithatë, të burgosurit nuk mund të lihen të mbyllur në dhomat e tyre për një kohë të gjatë, dhe kjo pavarësisht faktit se në to mund të kenë kushtet të mira materiale.

“KPT-ja konsideron se institucionet duhet të synojnë sigurojnë që të burgosurit të jenë në gjendje të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës (8 orë ose më shumë) jashtë dhomave, të angazhuar në aktivitete të dobishme, të natyrave të ndryshme. Natyrisht, regjimi në institucionet për të dënuarit duhet të jetë edhe më i favorshëm³⁴.”

Po ashtu, legjislacioni ynë i brendshëm, i shprehur nëpërmjet nenit 9 të ligjit nr. 8328, dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” e sanksionon funksionin rehabilitues dhe ri-integrues si më poshtë:

“Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve synon rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga burgu. Institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale, në bashkëpunim me shërbimin e provës, shërbimet e mirëqenies sociale, organet vendore dhe organizatat jofitimprurëse hartojnë programe riintegrimi prag-lirimi për adresimin e çështjeve gjinore. Për të dënuarit dhe të paraburgosurit e mitur përgatitja për riintegrim realizohet në bashkëpunim me të miturin, punonjësën social, familjen ose kujdestarin e tij. Për të dënuarit dhe të paraburgosurit që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajt dhe personat pa shtetësi, për aq sa është e mundur, mundësohen programe që respektojnë kulturën e tyre”.

Nenet e mëspërme përbëjnë bazë të rëndësishme ligjore, në përputhje me standardet dhe kërkesat e sotme të vendeve demokratike, për trajtimin e këtij grupi individësh në konflikt me ligjin dhe shpesh, me sjellje antisociale.

Gjithashtu, neni 10 “Individualizimi i trajtimit” i po këtij ligji, sanksionon se “Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar dhe të paraburgosur...”.

Në një kuptim të përgjithëm të detyrimeve ligjore të sipërpërmendura, është përgjegjësi e të gjithë personelit të institucione të burgjeve hartimi dhe vënia në zbatim e një regjimi të larmishëm aktiviteteve ditore, në përputhje me specifikat e secilit institucion. Nuk është përgjegjësi vetëm e sektorit të kujdesit social puna në këtë aspekt, po më së shumti e ekipeve multidisiplinore, nëpërmjet bashkëpunimit dhe nxitjes së ideve të reja, të zbatueshme në këto institucione.

Gjithashtu, KShH përshëndet arritjen e marrëveshjes dypalëshë të fundvitit 2014, midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me objekt

³⁴ Standardet e KPT-së- fq.18. paragrafi 47.

përgatitjen për ri-integrim të personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim, nëpërmjet organizimit të formimit profesional në IP/IEVP, si dhe krijimit të mundësive për ri-integrim të këtyre personave në shoqëri pas lirit. Ky është një hap pozitiv i cili tregon për ushtrimin e përgjegjësive funksionale edhe të organizmave të tjerë shtetërorë, përpos atyre të burgjeve, për krijimin e mundësive reale dhe të nevojshme për individët që janë në proces/ kryejnë dënim penal.

Duke e vlerësuar të rëndësishëm funksionin rehabilitues dhe ri-integrues të burgjeve, KShH ka vëzhguar nga afër situatën në burgjet e monitoruara. Kështu, ka rezultuar që IEVP "Ali Demi", IVM Kavajë dhe IP Vlorë (për sektorin e të miturve) janë institucionet ku ofrohen më shumë aktivitete për grupet e të burgosurve që trajtohen në këto institucione. Programi ditor që zbatohet aty përfshinte disa lloje aktivitete brenda orarit të veprimeve, duke përfshirë arsimimin, kurset profesionale, rikrijim dhe lexim.

Për t'u vlerësuar janë gjithashtu përpjekjet e institucioneve për të lidhur marrëveshje me drejtoritë rajonale profesionale (si psh. në Lushnje, në Rrogozhinë, në Fushë-Krujë, në Korçë etj.) për të bërë të mundur ofrimin e kurseve profesionale (hidraulik dhe saldator) për meshkujt e rritur.

Megjithatë, nga vëzhgimet në institucione e tjera të vëzhguara (si psh. në IEVP Tepelenë, Lezhë, Peqin, IP "Jordan Misj" Tiranë, etj.) u konstatua varfëri e theksuar e mundësisë për të realizuar aktivitete me funksion rehabilitues apo ri-integrues. Aktivitetet sportive kryesisht realizoheshin gjatë kohës së ajrimi, si dhe mungonin ambientete dhe baza materiale e përshtatshme për të mundësuar realizimin e aktiviteteve të tjera me qëllim rehabilitimi. Aktiviteti sportiv më i zakonshëm ishte futbollin, që si pasojë e mbipopullimi të lartë, mundësohej më rrallë/për individ. Po ashtu, në disa institucione (si në IEVP Lezhë, Peqin, Korçë, Fushë-Krujë, Vlorë, Kavajë etj.) funksiononin palestrat, gjithashtu me grafik të paracaktuar. Bibliotekat me të organizuara u gjetën në IEVP "Ali Demi" Tiranë dhe në IVM Kavajë.

Megjithëse IVM Kavajë është evidentuar më sipër si një institucion që ka pasur prej vitesh një praktikë të mirë të një programi të larmishëm që vazhdonte edhe pasdite, kjo përvojë po cenohet kohët e fundit me kufizimin e veprimtarive brenda orës 16.00. I pyetur për këtë kthim prapa personeli i referohej një udhëzimi të ardhur nga DPB³⁵.

Nga monitorimi u vu re se sektorë të ndryshëm kishin kuptueshmëri të ndryshme për kuptimin dhe zbatimin e udhëzimit që vinte nga DPB për sa i takon kohëzgjatjes së veprimtarive, që duhet të realizohen me të miturit.

Një instrument i rëndësishëm organizativ i hartimit dhe zbatimit të planit të individual të dënimit është edhe dosja psikosociale e të burgosurve. Nga vëzhgimi u konstatua se hartimi dhe plotësimi në vijim i këtij dokumenti orienton një sërë çështjesh të cilat

³⁵ Në një letër drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve kemi prezantuar shqetësimin se një udhëzim i DPB-së për mbylljen e veprimtarive të ajrimit brenda orës 16.00 në të gjitha IEVP/IP në periudhën e dimrit ishte kuptuar nga ana e personelit të Kavajës si afati i fundit kur mbyllen të gjitha llojet e veprimtarive me të miturit përfshirë edhe ajrimin.

duhet të adresohen, të tilla si: plotësimi standard i dosjeve (dosjet ngjajnë si kopje të njera-tjetërs), varfëria në plotësimin e problematikave individuale dhe pasqyrimi kohë pas kohe i gjendjes së të dënuarit³⁶.

KShH në komunikimet zyrtare me DPB-në ka evidentuar nevojën e përdorimit të dosjeve psiko-sociale si mjete të qenësishme në rrugëtimin e trajtimit sipas nevojave specifike të personave të paraburgosur dhe të dënuar, sidomos kur bëhet fjalë për kategori të veçanta siç janë të miturit, gratë, të sëmurët mendorë etj.. Gjithashtu, në komunikimet zyrtare me DPB, KShH ka sugjeruar thjeshtësimin e dosjeve psiko-sociale dhe futjen e disa instrumenteve konkretë të vlerësimit të ecurisë për personat me probleme të shëndetit mendor. Në vijim të këtyre sugjerimeve të KShH-së, kjo e fundit vlerëson përpjekjet e DPB-së për të futur si pjesë e dosjeve psiko-sociale instrumente vlerësimi në përputhje me specifikat e personave të paraburgosur dhe të dënuar si edhe përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar shërbimet me natyrë trajtuese dhe ri-integruese të të burgosurve duke shtuar larmishmërinë e aktiviteteve të qenësishme në institucionet e paraburgimit dhe burgjet.

3.6 Kujdesi shëndetësor;

Për shkak të vetë mënyrës të jetesës në institucionet penitenciare, realizimi i kujdesit shëndetësor merr rëndësi të veçantë. Kufizimi i lirisë së të burgosurve, nuk ndikon në të drejtat e tjera që ata gëzojnë, njëra nga më thelbësoret prej të cilave është e drejta për shërbim shëndetësor.

Neni 33 i ligjit Nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", ndryshimi nr. 40/2014, sanksionon ndër të tjera se "... Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të paraburgosurve dhe të dënuarve. Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë:

1. Parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve;
2. Furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore në rastet e emergjencës shëndetësore ato kur nuk mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor;
3. Profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse;
4. Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të paraburgosurve dhe të dënuarve".

Po ashtu, në nenin 33, sanksionohet se "Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të ligjit në fuqi, dhe përfitojnë, pa pagesë, të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor, sipas këtij ligji".

³⁶ Shënimet në dosje psiko-sociale bëheshin vetëm atëherë kur procedura e kërkonte (çdo një/ose tre muaj).

KShH, ka monitoruar insticionet e burgjeve edhe sa i takon respektimit të kësaj të drejte. Nga vëzhgimet ngrihen një sërë çështjesh që nevojitet të adresohen nga autoritetet drejtuese të sistemit shqiptar të burgjeve dhe Ministria e Shëndetësisë.

Ndër më të rëndësishmet, është çështja e furnizimit me ilaçe të institucioneve penitenciare. Në të gjitha institucionet e monitoruara (përveç QSB dhe institucionit në Zahari, Krujë) vëreheshin mungesa në medikamente. Vëzhguesit e KSHH-së morën shumë ankesa nga të burgosurit për mungesë trajtimi me terapi mendikamentoze nga farmacitë e institucioneve. Shumica dërrmuese e tyre i siguronin mjekimet në rast sëmundjeve privatisht, kryesisht me mbështetje nga familjarët.

Për sa i takon personelit mjekësor, përgjithësisht, institucionet e vëzhguara e kishin zgjidhur mungesën e stafit mjekësor me anë të kontratave më kohë të pjesshme (si në Berat, Lushnjë, Tepelenë etj.) çka është për t'u vlerësuar pozitivisht. Megjithatë, KShH ka konstaur se ka nevojë të rritet cilësia e shërbimit shëndetësor sa i takon periodicitetit të vizitave mjekësore, mjediseve të vizitave mjekësore dhe pajisjes së tyre me mjetet e përshtatshme.

Siç është përmendur edhe në pjesën e parë të këtij raporti, në shumë prej institucioneve të vëzhguara është konstatuar gjendje e varfër e kushteve higjienike. Një nga detyrat e shërbimit shëndetësor është edhe *"Sigurimi i higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të të paraburgosurve dhe të dënuarve"*. Veçanërisht mbipopullimi i lartë e përkeqëson këtë gjendje dhe si pasojë, puna e shërbimit shëndetësor nevojitet të jetë në nivelet e duhura, për të ofruar kujdes shëndetësor si në planin parandalues, po ashtu në dhënien efektive të shërbimit të të sëmurëve në këto institucione.

Në disa institucione nevojitet shtim i personelit mjekësor, duke marrë për bazë numrin e të paraburgosurve që trajtohen në cdo institucion për vit, si dhe grupet e të burgosurve me nevoja specifike (si psh në I EVP Lezhë, Peqin, Zahari Krujë etj.). Po ashtu nevojitet shtim i shërbimit psikiatrik ofruar të burgosurve. Gjithashtu, në shumë institucione të vëzhguara u ngrit nga personeli nevoja e pajisjes me auto-ambulanca.

Shërbimi i stomatologjisë, përveç se në I EVP "Ali Demi" Tiranë dhe I EVP Fushë-Krujë, përgjithësisht mbulonte vetëm heqjen e dhëmbëve dhe asnjëlloj shërbimi tjetër. Në institucione lartpërmendur, dhomat e stomatologut ishin ristauruar me financime të subjekteve private.

Në vëmendje të vëzhgimeve të KShH-së, lidhur me shërbimin mjekësor ishte edhe dokumentacioni mjekësor i cili pasqyron dinamikën e këtij shërbimi. Në të gjitha institucionet e vëzhguara nuk u gjetën të burgosur pa kartelë mjekësore. Po ashtu, regjistri i vizitave plotësohej çdo ditë nga mjekët e institucioneve. Vlen këtu për t'u përmendur edhe situata në disa institucione (si psh IP Tepelenë etj.) e mospajisjes me

libreza shëndetësore e të burgosurve nga Shërbimi Rajonal i Sigurimeve Shëndetësore³⁷, si pasojë e mungesës së Kartave të Identitetit të tyre.

Një çështje e ngritur në intervistat me të burgosurit, është edhe mungesa e një kontrolli të plotë mjekësor të të burgosurve me hyrjen në institucion. Mjekët realizojnë një intervistë të shkurtër me të burgosurit e ardhur rishtazi, të historikut të tyre mjekësor, më së shumti për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar në kësi rastesh. Mungesa e laboratorëve për bërjen e analizave mjekësore në institucione, e vështirëson realizimin e kësaj procedure. Rëndësi të veçantë merr bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë sidomos për disa kategori të veçanta të tillë si personat me probleme të shëndetit mendor. Sipas nenit 29 të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” thuhet se “Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor, ofron sipas nevojave, të gjithë asistencën e nevojshme për diagnostikimin, kurimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor” dhe sipas po këtij ligji në nenin 33.2 e tij thuhet se “Ankesat për vendimet e ankesave të drejtuara institucioneve ku ofrohen shërbime të shëndetit mendor ankimohen te Ministri i Shëndetësisë brenda 10 ditëve, i cili duhet të shprehet brenda 10 ditëve”. Duke pasur parasysh se pranë IEVP/IP ka sektorë të kujdesit të veçantë ku trajtohet përkohësisht personat me probleme të lehta të shëndetit mendor, në IEVP Krujë dhe Qendrën Spitalore të Burgjeve trajtohen rastet më të rënda të pacientëve me probleme të shëndetit mendor, sugjerojmë që Ministria e Shëndetësisë të japë kontribut të vazhdueshëm konform dispozitave ligjore të sipërcituara në IP/IEVP ku ka persona me probleme të shëndetit mendor.

3.7 Politika disiplinore në institucionet vendore penitenciare;

KShH në vëzhgimet e këtij viti, i ka kushtuar një fokus të posaçëm zbatimit të politikës disiplinore në institucionet e paraburgimit/burgjet. Në përmbushje të punës së vazhdueshme për përmirësimin e standardeve të trajtimit në burgje, KShH ka hartuar një “Studim mbi politikën e masave disiplinore në institucionet e vëzhgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale”³⁸. Studimi prezanton një qasje të zgjeruar të standardeve evropiane dhe atyre kombëtare, si dhe gjetjet konkrete, të ngritura më pas në sugjerime për përmirësimin e situatës së konstatuar. Për më tepër gjatë vitit 2012 është miratuar një udhëzues administrativ për të rregulluar dhe standardizuar praktikën në IP/IEVP për përdorimin e masave disiplinore me fokus të veçantë të miturit dhe personat me probleme të shëndetit mendor.

³⁷ Shërbimi i Sigurime Shëndetësore në Tepelenë nuk njihet asnjë dokument tjetër identifikimi, përveç kartave të identitetit. Ndërkohë, gati gjysma e të burgosurve aty nuk mund të pajiseshin me libreza shëndetësore për shkak të këti ngërçi institucional.

³⁸ Studimi është realizuar me mbështetje të OSI Budapest dhe të Civil Rights Defenders. Kopje të studimit gjenden në zyrat e KShH-së.

“KPT-ja i ka kushtuar gjithmonë vëmendje të veçantë të burgosurve që qëndrojnë në izolim, vetëm, sepse ai mund të ketë një efekt jashtëzakonisht të dëmshëm për shëndetin mendor, somatik dhe social të tyre³⁹”.

Ligji nr. 8328, dt. 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve” në nenin 51 të tij ka parashikuar se “Regjimi disiplinor realizohet në mënyrë që të stimulojë sensin e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit”.

Është e rëndësishme që masa disiplinore të mos përdoret nga ana e stafit në institucionet penitenciare si një mjet frikësimi apo për të treguar pushtet mbi të burgosurit, por si një mjet ligjor që zbatohet sipas procedurës së bazuar në ligj. Po ashtu, dokumentacioni që shoqëron këtë procedurë rezulton të jetë i plotë në institucionet e vëzhguara. Çdo institucion ka regjistrin e masave disiplinore ku dokumenton masat disiplinore. Shembull pozitiv sa i takon kësaj çështjeje u konstatua në IP Tropojë, ku mbahej në mënyrë të qartë dhe të rregullt dokumentacioni dhe evidentoheshin qartë dhënia e masave disiplinore (që nga viti 2007 nuk kishte asnjë masë disiplinore të dhënë).

KShH në krahasim me gjetjet e monitorimit të vitit të kaluar, vëren një ndërgjegjësim të personelit të institucioneve në lidhje me zbatimin e duhur të politikës disiplinore. Megjithatë, dëshirojmë të sjellim në vëmendje disa çështje të rëndësishme të orientuara nga gjetjet e rezultuara nga vëzhgimet.

Së pari, mjediset e dhomave të veçimit linin shumë për të dëshiruar për sa i takon kushteve higjieno-sanitare dhe pajisjeve të tyre, në disa prej institucioneve të vëzhguara (si në IEVP Lëzhë, Peqin, Rrogozhinë, Kukës, Lushnje, Vlorë etj.). Sapo hyje në këto mjedise vihej re menjëherë mungesa e higjienës, ajëri i rënduar, mungesa e shtrojeve të pastra personale, lagështirë në mure, tualete të papastra.

Së dyti, në institucionet e vëzhguara, u vërejt mos-kujdes i personelit mjekësor dhe atij psiko-social, për të takuar çdo ditë personat e vendosur në veçim. Aty shkonte vetëm ndihmës-mjeku, në rast se kishte shpërndarje medikamentesh. Ndonjëherë, u vu re se punonjësi i kujdesit social që kishte përgjegjësi atë regjim kishte bërë takime tek këta të paraburgosur dhe të dënuar.

Së treti, në mjediset e veçimit ishin vendosur edhe persona të tjerë, të cilët, më së shumti për arsye sigurie, dhe me miratimin e tyre, qëndronin në këto sektorë/dhoma prej kohësh.

Standardet e KPT-së e konsiderojnë të lejueshme përdorimin e këtyre ambienteve për arsye mbrojtjeje apo sigurie të të burgosurve, por vendosja e tyre aty duhet të realizohet në bazë të procedurave ligjore dhe nënligjore të miratuara. Për t’i ardhur në ndihmë personelit të IEVP/IP për të ndjekur procedura të unifikuara për mirëmenaxhimin e dhomës së veçimit, KShH në bashkëpunim me DPB ka hartuar Udhëzuesin Administrativ për “Përdorimi i dhomës së veçimit” i cili ka hyrë në fuqi qysh prej vitit 2012.

³⁹ Standardet e KPT-së, fq 30, paragrafi 53.

Kohëzgjatja e qëndrimit e të burgosurve në të tilla mjedise, nuk duhet të jetë e gjatë, si dhe të rivlerësohet qëndrimi i tyre kohë pas kohe. Dukë marrë shkas edhe nga vëzhgimet në mjediset e veçimit në institucionet e Peqinit, Lezhës, Rrogozhinës, ku qëndronin një numër relativisht i lartë i të burgosurve “problematikë ose ata që kanë probleme përshtatshmërie me të tjerë të burgosur”, KShH shpreh shqetësim për sigurinë dhe të të ndjerit të sigurt të këtyre të burgosurve. KShH ka sugjeruar në komunikimet zyrtare me DPB-në dhe IP/IEVP-të e vëzhguara që të bëhet një punë më e mirë nga ana e personelit me uniformë dhe personelit të kujdesit psiko-social me këta persona që të evitohet sa të mundet qëndrimi i tyre në dhomat e veçimit.

Zbatimi i politikës disiplinore në institucionet e paraburgimit/burgjet duhet gjithmonë të reflektojë frymën e ligjit dhe të standardeve ndërkombëtare, si dhe të mos reflektojë arbitraritet gjë që mund të çojë në keqtrajtim apo trajtim degradues të personave që mbahen në këto mjedise. Ato duhet të shërbejnë për të vendosur dhe ruajtur rregullin dhe sigurinë në institucion dhe të mos përdoren si tregues i keqpërdorimit të pushtetit të personelit ndaj të burgosurve. Këtu, duhet të veçojmë ankesat e shumta të ngritura nga të burgosurit e institucionit të Peqinit, kundrejt personelit të sigurisë, i cili i sipas këtyre pretendimeve i përdorte masat disiplinore, pa pasur konflikte, duke i kërkuar më pas një sasi të caktuar parash në këmbim të heqjes së këtyre masave nga dosjet personale të të burgosurve. Këto pretendime duhet të merren në shqyrtim serioz nga DPB për të trajtuar me profesionalizëm dhe objektivitet ankesat e të burgosurve për këtë çështje dhe për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore personat përgjegjës për këto veprime të paligjshme, nëse rezultojnë të tilla pas shqyrtimit.

Një tjetër çështje shqetësuese, e cila u ngrit nga të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit e IEVP Tepelenë, kishte të bënte me mënyrën e ushtrimit të kontrollit nga strukturat e DAP-it në DPB. Përtej procedurave të miratuara të ushtrimit të kontrollit për sende të ndaluara, të paraburgosurit/të dënuarit u ankuan se gjatë kryerjes së kontrollit, nga kjo strukturë, ishte ushtruar presion psikologjik dhe dhunë fizike⁴⁰, si dhe çka është më e rëndë, u pretendua se punonjësit e DAP-it, u kishin marrë⁴¹ sende personale të paraburgosurve /dënuarve, pa vullnetin e tyre.

Nëse vërtetohet ky pretendim, për të cilin sugjerojmë të hetohet sa më parë nga ana e strukturave të DPB-së, mendojmë se përbën një sjellje tejet joprofesionale dhe e papajtueshme me ushtrimin e detyrës, prandaj ndaj saj duhet mbajtur qëndrim sipas ligjit. Në përmbushje të detyrave të tyre ligjore, struktura të tilla duhet të punojnë me profesionalizëm dhe të ofrojnë siguri për të gjithë dhe jo të ushtrojnë presione apo të godasin apo ushtrojnë dhunë ndaj të paraburgosurve/të dënuarve.

⁴⁰ Neni 57 i ligjit Nr. 8328, dt. 16.04.1998, i ameduar specifikon se “Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të dënuarve dhe të paraburgosurve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhëna”.

⁴¹ Pati pretendime për marrje të një sendi me vlerë të një të paraburgosuri, të tipit unazë floriri, si dhe të tjera sende të tipit paketa duhani, çamçakëzë etj,

KShH në korrespondencën zyrtare me DPB-në ka sugjeruar, në mënyrë të veçantë, të hetohet lidhur me pretendimin e marrjes me forcë të sendit personal në posedim të të paraburgosurit si dhe nevojën për ngritje profesionale të punonjësve të sigurisë së DAP, nëpërmjet trajnimeve vazhduese që duhen realizuar në këtë drejtim.

3.8 Lejet shpërblyese dhe ato të veçanta;

Nenet 59 “Lejet shpërblyese” dhe 60 “Leje të veçanta” të ligjit Nr. 8328, dt. 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ndryshimi nr. 40/2014, sanksionojnë të drejtën e të burgosurve të dënuar të marrin leje për të dalë nga mjediset e institucionit të burgut, bazuar në disa kriteret të paracaktuar ligjore që duhen përmbushur me përpikmëri. Në vetvete, kjo praktikë ligjore shërben si një urë komunikimi me botën jashtë burgut, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin ri-integrues të të burgosurve.

Kështu, kriteret ligjore të përcaktuara për të marrë leje shpërblyese promovojnë sjelljen e mirë në institucion “*Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, që janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegrimit dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit*”. Ndërsa dhënia e lejeve të veçanta tregon kujdes më së shumti për situatat sociale/familjare të të dënuarve, që janë po ashtu shumë të rëndësishme për çdo qenie njerëzore: “*Drejtori i institucionit mund t'u japë të dënuarve dhe të paraburgosurve leje të veçantë, në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, apo të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit*”.

Nga vëzhgimet e realizuara KShH ka marrë ankesa nga të burgosurit sa i takon procedurave të zbatuara nga drejtuesit e institucioneve të burgjeve. Ankesat lidhen më së shumti me pretendime të ngritura për korrupsion kundrejt personelit (siç ishte rasti i pretendimeve në IEVP Peqin) apo për vonesa procedurash dhe moskthim përgjigjesh nga zyrat juridike, apo edhe pengim të fillimit të procedurës për dhënie të lejeve për disa grupe të dënuarish që kanë kryer krime seksuale me të mitur.

Bazuar në ankesat që kemi marrë prej të dënuarve me burgim për mosdhënie të lejeve shpërblyese, u vumë në dijeni se në një Letër-Porosi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, përcaktohet se “*.. për disa të dënuar që kanë rrezik recidivizmi, si psh. kapitulli “Krime seksuale” i Kodit Penal, nenet 100 dhe 101, leja duhet të meritohet dhe të mos jepet si një lloj detyrimi*”.

KShH vlerëson faktin që DPB udhëzon institucionet vartëse për të vlerësuar, rast pas rasti, dhënien e lejeve shpërblyese, duke theksuar të merituarit e lejeve shpërblyese, por

gjithashtu dëshiron të nënvijëzojë se citimi i neneve të veçanta të Kodit Penal, lë hapësirë të kuptohet në ndonjë institucion, se personat e dënuar për veprat e cituara në Letër-Porosi duhen përjashtuar nga përfitimi i lejeve. KShH e ka ngritur këtë shqetësim edhe në një letër zyrtare drejtuar autoritete përkatëse.

Po ashtu, KShH i është drejtuar me letra zyrtare autoriteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe DPB-së lidhur me Udhëzimin e Ministrit të Drejtësisë nr. 103, dt. 14.02.2014 "Për rregullimin e disa çështjeve që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së lejeve shpërblyese apo të veçanta personave të dënuar me burgim". Në pikat 26, 27 dhe 28 të këtij Udhëzimi, midis të tjerave, përcaktohen disa detyra për përgjegjësit e sektorit të shëndetësisë të institucioneve penitenciare si: "...verifikimi i ekspertizës mjekësore për të kontrolluar elementët e vërtetësisë së saj, duke e ngarkuar të shprehet me shkrim për këtë". Më tej ata ngarkohen të "...vlerësojnë shkallën e rrezikshmërisë së sëmundjes së anëtarëve të familjes së të burgosurit që kërkon këtë leje". Ai gjithashtu duhet të bëjë propozim me shkrim për dhënien ose jo të lejes së veçantë në favor të të burgosurit, si dhe të hartojë raport të përbashkët me sektorin ligjor, atë të sigurisë dhe të kujdesit social.

Bazuar në juridiksionin e sistemit penitenciar dhe më konkretisht në nenin 33 "Shërbimi Mjekësor", të ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve", detyrat e shërbimit mjekësor fokusohet në ofrimin e shërbimit mjekësor tek të dënuarit dhe të paraburgosurit, që secili institucion ka në kujdes. Pra familjarët dhe të afërmit e burgosurve/paraburgosurve nuk përfshihen në këtë shërbim. Nga ana tjetër, nëse shërbimi shëndetësor i IEVP-ve, do të kryente detyra për të verifikuar dhe vlerësuar diagnozat e përcaktuara në akte mjekësore të familjarëve të të burgosurve, mendojmë se kjo do të konsumonte kohë pune të vlefshme të personelit mjekësor, duke reduktuar shërbimin ndaj të burgosurve/paraburgosurve të institucionit. Gjithashtu, detyra të tilla do të krijonin konflikt kompetence me shërbimin shëndetësor publik, që ofron ekspertizën mjekësore ndaj të afërmit të të dënuarit, që kërkon leje të veçantë.

KShH mendon se kompetenca e vlerësimit të situatës shëndetësore të familjarëve të të dënuarve duhet të mbetet përgjegjësi e mjekëve të shërbimit shëndetësor publik, i cili e përgatit dokumentacionin mbi bazë të ekzaminimit direkt të pacientit, gjë që është e pamundur për personelin mjekësor të IEVP-ve. Shkalla e rrezikshmërisë së një sëmundje është e varur edhe nga rrethana vetjake të pacientit, nga kohëzgjatja e sëmundjes, forma e saj etj. dhe këto janë elementë që personeli mjekësor i IEVP-ve nuk mund t'i njohë e vlerësojë pa shkuar pranë institucioneve ku janë kuroar ose kurohen familjarët e të burgosurve. Një gjë e tillë do të kërkonte bashkëpunim me institucionet e sistemit të shëndetit publik dhe për pasojë edhe udhëzimi duhej të ishte përgatitur e miratuar nga të dy Ministrat.

3.9 Punësimi;

Një drejtim i rëndësishëm i objektivave sociale të shtetit, që lidhet me *“punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë”*⁴² dhe që ka gjetur parashikimin e vet kushtetues në kapitullin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, është e drejta e individëve për të zgjedhur një profesion ose një aktivitet të caktuar.

Po ashtu, në nenin 34 të ligjit *“Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve”*, sanksionohet se *“Të gjithë të paraburgosurve dhe të dënuarve u njihet e drejta për të punuar. Puna organizohet nga drejtoria brenda dhe jashtë institucionit duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera....Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kritereve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave”*. Standardet e ofruara nga ky ligj sa i takon punësimin dhe kushteve të punës, pagesës së punës, kohëzgjatjes etj.. janë në përputhje me Kodin e Punës së RSH.

KShH përshendet nismat e fundit të DPB-së sa i takon krijimit të mundësive reale për punësimin e të burgosurve. Megjithatë, aktualisht në institucionet e burgjeve ka një numër të vogël të dënuarish në raport me numrin e përgjithshëm të të burgosurve për institucion që gjenden të angazhuar në veprimtari punësimi përgjithësisht si: mirëmbajtës, pjatolarës, kuzhinierë, shpërndarës ushqimi, sanitarë, bibliotekarë, kopshtarë etj..

KShH konstaton se ende është në zbatim ligji i vjetër sa i takon mënyrës së shpërblimit të punës së të dënuarve, dmth 3.9 ditë në muaj i zbritjeje dënimit të tyre. KShH dëshiron të nxisë përshpejtimin e vënies në zbatim të detyrimeve ligjore të pagesës së punës sipas standardeve të vendosura në ligj, si dhe për gjetjen e formave të larmishme të punësimin të të burgosurve. KShH së fundmi ka ofruar mendime ligjore për projekt-VKM për punësimin dhe shpërblimin e të dënuarve dhe shpreson që sugjerimet e ofruara të merren parasysh nga MD dhe autoritetet ligjvënëse.

3.10 Trajtimi i grupeve në pozita të dobëta: të miturit, gratë, të sëmuretë mendore etj

Të miturit, gratë, të sëmuretë mendore, të burgosurit LGBT, të dënuarit që kanë kryer krime seksuale etj. Janë disa nga grupet në pozita të dobëta në sistemin e burgjeve, për arsye se ata kanë nevojë të veçanta në raport me shumicën e të burgosurve të tjerë. Ndaj këtyre kategorive duhet ndjekur një kujdes më i veçantë shumëplanësh, për efekt të nevojave specifike që ata kanë, për shkak të përkatësisë në grupet ku bëjnë pjesë, si dhe për shkak të paragjyqimeve të të burgosurve të tjerë ndaj tyre.

Një trajtim i tillë nuk përkthehet në krijimin e privilegjeve për grupe të tilla, por për realizimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore ndaj grupeve të tilla. Një

⁴² Shih nenin 59, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

kuptueshmëri e tillë, është i rëndësishëm për përmbushjen e trajtimit të vëçantë të grupeve në nevojë, sidomos në jetesën e përditshme brenda institucioneve të burgjeve. KShH përshëndet përmirësimet ligjore në ligjin nr. 40/2014 "Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve" ku ka dispozita të veçanta për trajtim të individualizuar dhe sipas nevojave të disa kategorive të përmendura më sipër.

- Trajtimi i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor;

Në përputhje me këto ndryshime ligjore dhe më konkretisht në nenin 16 të ligjit nr. 40/2012 që parashikon se "*Trajtimi në seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet.....sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për shëndetit mendor*" doli nevoja e ngritjes së sektorëve të kujdesit të veçantë (SKV) në IEVP/IP, ku trajtohen përkohësisht personat me probleme të lehta të shëndetit mendor nga një ekip multidisiplinor i trajnuar paraprakisht për të ofruar trajtim mjekësor dhe psiko-social sipas nevojave të pacientëve. Qysh prej 2010 e deri më sot SKV funksiononte vetëm në IEVP "Ali Demi" Tiranë për sektorin e grave të dënuara, bazuar mbi përvojën e mirë të ardhur nga burgjet holandenze.

KShH përshëndet hapat e ndërmarrë nga DPB-ja sa i takon hapjes së sektorëve të kujdesit të veçantë në pesë burgje si në IEVP Lezhë, IP Elbasan, IP Berat, IP Durrës, IEVP Korçë, në IP "Jordan Misja" Tiranë dhe IEVP Peqin, si nismë pilote dhe dëshiron të mbështesë dhe nxisë DPB-në për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e vazhdueshme që duhet t'i jepet personelit të këtyre institucioneve në mënyrë që të konsolidojnë këtë përvojë të re për burgjet shqiptare. KShH, përmes korrespondencës zyrtare me DPB-në dhe IP/IEVP ku janë hapur tashmë këta sektorë, ka ofruar disa sugjerime për marrjen e masave organizative dhe përmbajtësore në lidhje me trajtimin e diferencuar e sipas nevojave për këtë kategori të burgosurish.

Në vijim të bashkëpunimit dhe ngritjes së kapaciteteve të personelit të sistemit shqiptar të burgjeve, KShH po realizon trajnime të personelit të IEVP/IP-ve për t'i mbështetur profesionalisht ekipet multi-disiplinore për realizimin e detyrës, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve ndihmues për vlerësimin individual të të paraburgosur/dënuarve me probleme të shëndetit mendor si edhe për hartimin e planeve fillestare të trajtimit dhe planeve të udhëzimit të trajtimit në vazhdimësi për këta persona. KShH sugjeron që këto instrumente të bëhen pjesë e praktikës së punës së përditshme më këta pacientë në IEVP.

Institucionet që trajtojnë një numër të madh të të sëmurëve mendorë janë institucioni i Zaharisë në Krujë, i Durrësit dhe QSB. Vlen të evidentohet se në vijim të sugjerimeve të KShH-së për pasyrimin e veprimtarive kuptimplotë për personat me probleme të shëndetit mendor, IP Durrës, ka marrë masa konkrete duke shtuar aktivitetet që

realizohen në mjediset e jashtme me këtë grup të burgosurish në pamundësi të mjediseve të brendshme për të tilla veprimtari. Ndërsa në institucionin në Zahari Krujë dhe në QSB kishte një mungesë të theksuar të aktiviteteve terapeutike dhe psiko-sociale që duhet të zhvillohen me këtë grup.

Edhe në institucionet e tjera, përveç atyre që kanë pilotuar SKV-të ka të burgosur me probleme të shëndetit mendor që nevojitet të trajtohen me kujdes më të shtuar, për shkak të çrregullimeve që kanë si në I EVP Peqin, Lushnjë, Tepelenë, etj.. Në të gjitha institucionet e vëzhguara u vërejt që këta pacientë trajtohen në dhoma me të burgosur të tjerë. Shpesh, këta të burgosur qëndronin në dhomat me standardet më të këqija të institucioneve, si dhe më higjienë të varfër vetiake, të shtrojave personale dhe të mjediseve rrethuese. Po ashtu, shërbimi shëndetësor i ofruar ishte jo cilësor (nuk kryheshin vizitat periodike, si edhe mjekimet e ofruara ishin të vjetëruara/jo medikamentet e reja që janë edhe më efektive në trajtim farmakologjik). Në raste axhitimi, ndaj tyre aplikoheshin terapi medikamentoze, duke i neutralizuar nëpërmjet forcave të sigurisë më parë. Personeli mjekësor i institucioneve të vëzhguara prezantoi vështirësitë e trajtimit të këtij grupi në nevojë, në mungesë të mjediseve të përshtatshme për trajtimin e tyre.

Përgjithësisht, në institucione në kishte të sëmurë mendorë, pjesën e shërbimit psiko-social e mbulonte psikologu i institucionit. Në disa I EVP/IP kishte mungesa të psikologëve si në I EVP Lushnje, I EVP Korçë. Trajtimi i ofruar konsistonte në takime individuale dhe seanca këshillimi. Duhet evidentuar rëndësia e punonjësve social në punën me këta pacientë në organizimin e veprimtarive me karakter social si terapi okupacionale, forcimin e lidhjeve me familjen etj. Ky grup i veçantë të burgosurish vuan më shumë edhe braktisjen nga familja, për shkak se shpesh, edhe vepra penale e kryer prej tyre lidhet me grupin e krimeve brenda familjes, ndaj puna për rivendosjen e lidhjeve me familjarët për këta pacientë nga ana e punonjësve socialë merr rëndësi të veçantë. Në përgjithësi, kishte një bashkëpunim të mirë të personelit mjekësor dhe atij psiko-social për shkëmbimin e informacionit të nevojave që mund të kishin këta të sëmurë. Gjithsesi, merr rëndësi hartimi i planeve individuale të dënimit në bashkëpunim të plotë me gjithë specialistët që trajtojnë këta pacientë.

Një tjetër problem tejet shqetësues mbeten mbajtja e personave me vendim gjyqësor me masë "Mjekim të detyrueshëm" dhe "Shtrim të përkohshëm" të cilët mbahen aktualisht në I EVP Krujë dhe QSB në shkelje flagrante me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

KShH e ka adresuar këtë problematikë të trajtimit të personave me masë mjekësore "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor", të cilat aplikohen nga gjykatat, bazuar në nenin 46 të Kodit Penal dhe ligjin "Për shëndetin mendor", tek autoritetet më të larta të vendit.

Legjislacioni në fuqi përcakton qartë se masat mjekësore jepen ndaj personave, që dyshohet se kanë kryer një vepër penale, por për shkak të sëmundjes mendore, nga e cila vuajnë, nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të

kundraligjshme, që kanë kryer. Për pasojë, ata janë shpallur nga gjykata të papërgjegjshëm penalisht, duke u përjashtuar nga gjykimi dhe dënimi për veprën që akuzohen.

Rezulton se, në harkun kohor të rreth 10 viteve të fundit, numri i personave që kanë marrë nga gjykata masën "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" është dyfishuar, duke shkuar në më tepër se 150.

Lidhur me vendin dhe mënyrën e zbatimit të kësaj masë mjekësore, pikat 1 dhe 2, të nenit 28, të Ligjit nr. 44/2012, "Për shëndetin mendor", përcakton se ajo, duke patur si qëllim kryesor mjekimin e personit, duhet të kryhet pranë institucioneve mjekësore **të posaçme, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar të Ministrisë së Shëndetësisë**. Të njëjtën gjë përcakton dhe neni 45 i ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" ku thuhet se: "Masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, mbi kërkesën e prokurorit..."

Për sa i takon mjekimit që do të aplikohet ndaj kësaj kategorie personash Kushtetuta (neni 55/1) ka sanksionuar se: "Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti", prandaj edhe ndaj kësaj kategorie personash duhet të zbatohen protokollat përkatëse, të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë, në të cilat përcaktohet se, këtyre pacientëve duhet t'u ofrohet kujdes shëndetësor në një mjedis sa më pak shtrëngues, se ata duhet të trajtohen nga ekipe multidisiplinore, të cilët duhet t'u përgjigjen nevojave komplekse që këta pacientë kanë dhe që janë të natyrës mjekësore, psikologjike, sociale dhe rehabilituese, me qëllim kurimin dhe ripërfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

KShH ka konstatuar se 148 persona me masë mjekësore, në kundërshtim me ligjin dhe nevojat e tyre për kurim, janë dërguar nga prokurorët për të kryer masën mjekësore, të dhënë nga gjykata, pranë IEVP. Ata ndodhen të sistemuar, kryesisht, në burgun e Krujës (Zahari) dhe në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (ish-Spitali i Burgjeve). Shumë prej këtyre personave qëndrojnë padrejtësisht në burgje për më shumë se 10 vjet.

Prokurorët, që kanë urdhëruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në mënyrë të kundraligjshme, justifikohen se kanë qenë të detyruar të kryejnë këtë veprim për shkak se institucionet shëndetësore nuk i kanë pranuar për kurim personat me masë mjekësore, duke u justifikuar me faktin se në sistemin e shëndetësisë **ende nuk ekziston "institucioni i posaçëm"** i cili përcaktohet në ligjin "Për shëndetin mendor" dhe që duhet të shërbejë për ofrimin e mjekimit të detyruar, në përputhje me vendimet gjyqësore.

Kjo situatë ka shkaktuar probleme të rënda në dy drejtime. **Së pari** shtetasve me masë mjekësore ju janë cenuar rëndë të drejtat e tyre, sepse nuk kanë marrë mjekimin e përshtatshëm, gjë që ka shkaktuar përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore, si dhe u është kufizuar e drejta e lirisë tej masës së parashikuar në ligj. **Së dyti** prania e kësaj kategorie shtetasish në burgje është një situatë e kundraligjshme, që vjen në kundërshtim me legjislacionin që rregullon funksionimin e këtyre institucioneve, si dhe ndikon në mbipullimin e burgjeve dhe përkeqësimin e klimës në to.

Nëpërmjet monitorimeve tona, veç sa më sipër, kemi konstatuar se sistemi i burgjeve nuk ka kapacitetet, mjediset, regjimin dhe personelin e duhur mjekësor për kurimin e këtyre personave, për pasojë gjendja e tyre rezulton në degradim të vazhdueshëm.

Në Raportin e Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor, dhe Degradues (KPT) të dt. 20 mars të vitit 2012, është nënvizuar fakti se: *“prej më shumë se 13 vjet pas vizitës së parë në Shqipëri, KPT-ja edhe një herë dëshiron të ngrejë çështjen e pranisë në Spitalin e Burgut të pacientëve psikiatrikë të deklaruar jo të përgjegjshëm dhe që i janë nënshtruar një mase mjekësore të detyrueshëm në përputhje me nenin 46, paragrafi 1, i KP, dhe e pacientëve të psikiatrisë që i janë nënshtruar një mase të shtrimit të përkohshëm në spital, në zbatim të nenit 239 të KPP. Këta pacientë ende mbahen në Spitalin e Burgut dhe jo në një institucion të specializuar mjekësor, ose në një institucion psikiatrik, siç është parashikuar në legjislacionin përkatës shqiptar. Deri më sot, autoritetet shqiptare kanë dështuar për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme për këtë problem, dhe ka pasur shumë pavendosmëri për të ngritur një institucion të veçantë në Durrës ose në Krujë.”*

Të njëjtat konstatime janë bërë dhe nga institucioni i Avokatit të Popullit, organizata “Amnesty International”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe organizata të tjera, por ky problem ende nuk ka gjetur zgjidhje.

Vendosja dhe trajtimi i këtyre shtetasve në institucione penitenciare, si dhe mungesa e trajtimit mjekësor të përshtatshëm për ta, në përputhje me gjendjen e shëndetit të tyre mendor, shkakton cenim të lirive dhe të drejtave të tyre.

Për raste të ngjashme, të shqyrtuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç janë dhe çështja “Dybeku kundër Shqipërisë”, ose “Groni kundër Shqipërisë”, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 3 të KEDNj, në formën e trajtimit çnjerëzor ndaj kërkuesit, sepse gjatë vuajtjes së dënimit me burg, ata nuk ishin trajtuar në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore. Mungesa e burimeve materiale dhe financiare nuk justifikon shkeljen e të drejtave themelore të shtetasve, shprehet në vendimet e saj ajo Gjykatë e nderuar.

Në këto rrethana, KShH po ndjek gjyqësish disa raste flagrante, duke kërkuar ndërprerjen e cenimit të të drejtave të shtetasve përkatës dhe dëmshpërblimin e tyre sipas ligjit.

- Trajtimi i të miturve;

Të miturit përbëjnë grupin më specifik në pozita të dobëta në institucionet e paraburgim/burgjeve. Specifikat e kësaj moshe në lidhje me formimin e personalitetit diktojnë regjim të ndryshëm burgimi në raport me të rriturit. Masa të tilla vijnë në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare të “Intersit më të lartë të fëmijës”.

Nisur nga sa më sipër, KShH përshëndet masat e marra nga DPB dhe institucioni i Kavajës për transferimin dhe akomodimin e të miturve që qëndronin tek IP “Jordan Misja” në Tiranë, për në IVM në Kavajë.

Sa i takon vëzhgimeve të realizuara nga KShH, rezultoi se në të gjitha institucionet ku mbaheshin të mitur (IVM Kavajë, në IEVP Lezhë, IP Vlorë dhe IEVP Korçë) mundësohej ofrimi i arsimit të detyrueshëm 9 vjeçar, në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Arsimit. Kishte mungesa të bazës didaktike dhe materiale në pothuajse të gjitha institucionet ku mbahen të miturit.

Po ashtu gama e aktiviteteve që realizoheshin me të miturit ishte më e gjera krahasuar me të rriturit e burgosur. Në të gjitha këto institucione ofroheshin po ashtu kurse profesionale të ndryshme (si për elektrikist, hidraulik, saldator etj), si dhe kurse të gjuhëve të huaja, kryesisht për anglisht. Është përmendur edhe më lart në këtë raport se megjithëse IVM Kavajë është evidentuar si një institucion që ka pasur prej vitesh një praktikë të mirë të një programi të larmishëm që vazhdonte edhe pasdite, kjo përvojë po cenohet kohët e fundit me kufizimin e veprimtarive brenda orës 16.00. I pyetur për këtë kthim prapa personeli i referohej një udhëzimi të ardhur nga DPB⁴³

Nga monitorimi u vu re se sektorë të ndryshëm kishin kuptueshmëri të ndryshme për kuptimin dhe zbatimin e udhëzimit që vinte nga DPB për sa i takon kohëzgjatjes së veprimtarive, që duhet të realizohen me të miturit.

Gjatë monitorimeve në këto institucione /sektorë u konsatuan probleme që lidheshin me higjienën në disa prej dhomave/mjedise të qëndrimit të të miturve. Shpesh, dhomat e tyre i gjeje rrëmujë, me tesha të hedhura gjithandej, krevate të pasistemuar, ushqime të vendosura për tokë etj.. Mungesa e detergjenteve pastrues ishte e dukshme, po ashtu mungonte edhe kujdesi i vetë të miturve kundrejt mbajtjes së higjienës personale dhe të mjedisit⁴⁴.

⁴³ Në një letër drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve kemi prezantuar shqetësimin se një udhëzim i DPB-së për mbylljen e veprimtarive të ajrimit brenda orës 16.00 në të gjitha IEVP/IP në periudhën e dimrit ishte kuptuar nga ana e personelit të Kavajës si afati i fundit kur mbyllen të gjitha llojet e veprimtarive me të miturit përfshirë edhe ajrimin.

⁴⁴ Neni 26 i ligjit Nr. 8328, dt. 16.04.1998, i ameduar “Të paraburgosurit dhe të dënuarit i sigurohen mjediset, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë vetjake, në përpjesëtim me numrin e përdoruesve, që të garantojë në mënyrë sa më optimale higjienën vetjake. Çdo institucion siguron shërbime periodike të pastrimit të mjedisëve, veshmbathjes dhe pajisjeve vetjake, si dhe të qethjes dhe të rruajtjes. Higjiena vetjake, qethja dhe rruajtja mund të bëhen me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjiëno-sanitare, sipas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër

Lidhur me punën konkrete me të miturit, sugjerojmë që të vihen objektiva konkretë⁴⁵, në planin individual të dënimit të gjithsecilit të mitur⁴⁶ dhe më tej të punohet nga të gjithë sektorët për arritjen e këtyre objektivave. Lidhur me sa më sipër, sugjerojmë rivënien në punë të teknikës së formateve të aftësive sociale, një teknikë tejet praktike dhe e dobishme për t'i aftësuar të miturit të fitojnë disa aftësi sociale për përkujdesin ndaj vetes dhe të bashkëjetesës në komunitet. Sugjerojmë gjithashtu që familjarët⁴⁷ e të miturve të mund të përfshihen më shumë, në procesin e hartimit të planit individual të dënimit, si dhe në vijimësi të trajtimit të të miturve në institucionet ku mbahen të miturit.

Një çështje tjetër që nevojitet të adresohet ishte përdorimi i duhanit nga të miturit, thuajse në të gjitha mjediset e qëndrimit të tyre. Ndonëse në mure ishin prezent shenja që njoftonin ndalimin e përdorimit të duhanit, sikurse ligji e kërkon, faktikisht në këto sektorë pihej duhan gjithandej.

Po ashtu, zbatimi i politikës disiplinore me të mitur kërkon më së pari, zbatimin e masave edukuese, sikurse është udhëzuar edhe nga sektori i problemeve shoqërore në DPB në përputhje me udhëzuesin administrativ për politikën disiplinore për të miturit. Jo në të gjitha rastet zbatohet kjo procedurë, më së shumti për shkak të ndryshimeve konceptuale të sektorëve të sigurisë dhe atij të kujdesit social. KShH sugjeron trajnime të vazhdueshme të personelit që punon me të miturit me këtë udhëzues për të pasur një kuptueshmëri të njëjtë dhe realizim korrekt të tij në praktikë nga gjithë personeli me uniformë dhe ai civil.

Vlen të evidentohet se të miturit në IVM Kavajë nuk përfitonin kohën e përcaktuar në ligj për ajrim⁴⁸. Për më tepër, të miturit që qëndronin në dhomat e veçimit bënin ajrim vetëm 30 minuta në ditë dhe nuk përfshiheshin në asnjë aktivitet tjetër gjatë gjithë kohë-qëndrimit të tyre të veçuar. Kjo situatë, që është në mospërputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të trajtimit të të miturve, përbën dhe shkelje të të drejtave të tyre, prandaj sugjerojmë marrjen e masave të menjëhershme për të rivënë në vend të drejtën e cenuar. Për të gjithë të miturit që qëndrojnë në institucione të tilla,

të drejtorit të institucionit.

⁴⁵ KShH ka realizuar disa trajnime me fokus trajtimin e të miturve, si dhe ndryshimin e sjelljes së tyre dhe rritjen e aftësive sociale të gjithsecilit që nuk i ka të tilla aftësi”.

⁴⁶ Neni 11 i ligjit Nr. 8328, dt. 16.04.1998, i ameduar thekson se “Për çdo të mitur të paraburgosur ose të dënuar përgatitet një plan individual rehabilitimi dhe riintegrimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur kurse profesionale ose për të avancuar në arsim”.

⁴⁷ Neni 40 i ligjit Nr. 8328, dt. 16.04.1998, i ameduar specifikon se “...Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur dhe për gratë që kanë fëmijë të mitur, bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen”.

⁴⁸ Neni 28 i ligjit Nr. 8328, dt. 16.04.1998, i ameduar specifikon se “...Të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim jo më pak se 3 orë në ditë, përveç kohës për veprimtari social- edukative. Ajrimi për këtë kategori kryhet veçmas nga të rriturit”.

duhet të ofrohet kujdes i njëjtë, pa diskriminim, në kuptimin e respektimit të të drejtave të gjithsecilit në mënyrë të barabartë.

- Trajtimi i grave;

Gratë në burgje përfaqësojnë grup në pozitë të dobët. KShH përshëndet vendimin e marrë nga DPB për të grupuar në një institucion të vetëm të mbajtjes së grave dhe vajzave të paraburgosura/dënuara. Trajtimi i tyre në një institucion të vetëm do të sjellë standardizim të trajtimit, si dhe do të mundësojë më shumë shërbime specifike për këtë grup në nevojë.

Nga vëzhgimi në IEVP "Ali Demit" në Tiranë u konstatua së gratë e dënuara trajtoheshin në regjim të hapur, i cili mundëson një jetesë ditore me larmishmëri aktivitësh. Vlerësohen po ashtu si aspekte pozitive, realizimi i kurseve profesionale (parukeri, rrobaqepërsi, pikturë etj. dhe punë të ndryshme të cilat realizoheshin në bashkëpunime me shoqata apo fondacione të jashtme. Aty funksiononte edhe sera e institucionit ku kultivoheshin lule dhe zarzavate të stinës. Biblioteka, si dhe prania e vazhdueshme e stafit psiko-social plotësonte një pjesë të mirë të nevojave të tyre për angazhim kulturor dhe këshillim psikologjik.

Problem i konstatuar në këtë institucion përbëntë amortizimi i lartë i ndërtesës, i cili shoqërohej me lagështiri të theksuar në dhomat e të dënuarave, si dhe në mjediset e tualeteve dhe dusheve.

Vlen të evidentohet se KShH realizoi një vëzhgim specifik në IP Jordan Misja së bashku me deputetë, përfaqësues të nënkomitetit për të drejtat e njeriut në Kuvendin e Shqipërisë krahas vëzhgimit të tij të planifikuar në këtë institucion. Në IP "Jordan Misja" gratë e paraburgosura qëndronin në mjedise të mbipopulluara në mjedise tejet të amortizuara.

Kohëzgjatja e qëndrimit të grave në pritje të vendimit të formës së prerë nga gjykata ishte në shumë raste e gjatë. Koha e qëndrimit të grave në paraburgim varionte nga 14 muaj deri në 2 vjet. Gratë e intervistuar u ankuan për cilësinë e shërbimit të avokatëve të caktuar kryesisht si edhe për takimet e rrolla ose të munguara me prokurorët e çështjeve.

Të pyetur se çfarë bënin nga ora 8 e mëngjesit deri në ora 16.00 qe ishte orari i veprimeve, gratë e paraburgosura pohuan se përveç ajrimit dhe tre herë në javë volejball, vrisnin furrtalet që kalonin në qeli dhe luanin me letra me njëra-tjetrën. Biblioteka ishte shume e varfër. Televizorë nuk kishin të gjitha nëpër dhoma dhe ato që nuk kishin duhet t'i blinte familja një TV të re, pasi kështu është rregulluar një udhëzim nga DPB që të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit duhet të sigurojnë një TV të ri!!!! Ky udhëzim vë në vështirësi shumë të paraburgosur dhe të dënuar me probleme financiare që nuk arrijnë të blejnë një TV të ri. KShH gjatë vëzhgimit të tij i parashtroi

autoriteteve të DPB-së dhe IP “Jordan Misja” një sugjerim konkret për të evituar këto situata.

Shërbimi shëndetësor linte për të dëshiruar në këtë institucion pasi mjeku nuk bënte vizita periodike. Kishte shumë ankesa për shërbime të specializuara si shërbime gjinekologjike. Të gjitha gratë e pyetura që kishin një periudhë të konsiderueshme në IP Jordan Misja përveçse vizitës së parë gjinekologjike nuk u ishte mundësuar një vizitë e mëvonshme gjinekologjike. Kishte ankesa se kishin pritur gjatë në QSB, për një ndërhyrje kirurgjikale nga mjekët e spitalit civil.

Të pyetura për kërkesë-ankesat gratë e paraburgosura thanë që nuk kishin guxim të ankoheshin pasi personeli u bënte raport shërbimi për shkelje të rregullave të institucionit.

Nga këqyrja e dosjeve psiko-sociale u vu re se ato ishin plotësuar formalisht dhe rishikuar një herë në 6 muaj dhe për më tepër objektivat e trajtimit nuk konsultoheshin me të paraburgosurën. Të paraburgosurat e pyetura nëse konsultoheshin për të bërë me to një plan dënimi pohuan se ato as nuk e dinin se çfarë ishte ky plan. Moskonsultimi me të paraburgosurat u vu re qartë nga mënyra se si plotësohen formalisht dosjet psiko-sociale.

Disa gra kishin shqetësime për fëmijët që i kishin jashtë IP. Midis të tjerave ishte rasti i H. K. që kishte edhe bashkëshortin në burg dhe për fëmijët nuk kishte asnjë informacion për 21 muaj që ishte në IP se ku i kishte fëmijët, aq me tepër që ajo vinte nga një familje që ishte ne gjak.

KShH evidenton faktin pozitiv se ligji 40/2014 ka disa dispozita konkrete që tregojnë ndjeshmëri më të lartë në trajtimin dhe rehabilitimin e grave të paraburgosura dhe të dënuara sipas nevojave të tyre të veçanta që përshijnë trajtim shëndetësor të specializuar, rehabilitim për traumat e dhunës në familje, trajtim të çrregullimeve mendore si edhe trajtim psiko-social në përputhje me nevojat e tjera specifike të grave. KShH inkurajon punonjësit që punojnë me gratë në I EVP/IP të njihen nga afër me këto dispozita të reja dhe përmirësime ligjore për t’i realizuar kërkesat e ligjit sa më mirë në praktikën e përditshme. Një rëndësi të veçantë i punës me gratë merr edhe përgatitja e tyre për lirim që duhet të fillojë që me ditën e parë kur ato vendosen në paraburgim dhe duhet të realizohen në bashkëpunim me struktura të tjera të kujdesit në nivel vendor dhe rajonal.

3.11 Të tjera;

Bashkëpunimi midis punonjësve të sektorëve të ndryshëm të institucioneve të burgjeve, si dhe bashkëpunimi midis drejtuesve të nivelit të lartë, të mesëm dhe punonjësve të rolit bazë është me rëndësi kyçe për mbarëvajtjen dhe mirë-qeverisjen e institucioneve. Përgjithësisht, punonjësit e institucioneve të vëzhguara pohonin se

kishin bashkëpunim të mirë midis tyre. Megjithatë, mosmarrëveshjet në lidhje me mënyrën e zbatimit të planeve të sigurisë së institucionit, sillte edhe pengesa në dëm të realizimit të aktiviteteve të planifikuara nga sektorët e kujdesit social.

Qëndrueshmëria në punë dhe trajnimi i personelit të burgjeve është një tjetër element shumë i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve të ofruara aty. Është me rëndësi që personelit të këtyre institucioneve t'u krijohet mundësia e rritjes profesionale në punë, nëpërmjet promovimit të punës dhe trajnimeve të vazhdueshme në funksion të nevojave të përgjithshme dhe specifike të çdo institucioni.

IV. Sugjerime për përmirësimin e respektimit të të drejtave në institucionet penitenciare

Nëpërmjet zbatimit të dënimit me burgim, individët humbin të drejtën themelore të lirisë së lëvizjes, por ata duhet të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tjera themelore të njeriu, si dhe të trajtohen në respekt të dinjitetit të tyre si qenie njerëzore.

KShH, nisur nga gjetjet dhe konstatimet e vlerësuara gjatë monitorimeve të realizuara në institucionet e sistemit shqiptar të burgjeve, si edhe pas një diskutimi të hapur me autoritetet drejtuese të burgjeve të versionit paraprak të raportit të monitorimit, prezanton më poshtë sugjerimet e tij.

Mbipopullimi

- Aktualisht, mbipopullimi përbën problemin më shqetësues dhe emergjent që ka sistemi shqiptar i burgjeve, i pasqyruar gjerësisht në pikën 3.1 të këtij raporti. Të gjitha shërbimet e ofruara nga sistemi i burgjeve përkeqësohen nën ndikimin e mbipopullimit. Për uljen e mbipopullimit, KShH sugjeron një ndërhyrje me plan të gjerë, e cila do të duhet të përfshijë aktorë të ndryshëm të politikëbërjes dhe të zbatimit të ligjit. Masa konkrete duhet të ndërmerren, në një kohë sa më të shpejtë, për të përmirësuar situatën gati alarmante që prezanton sot ky sistem. KShH është i vetëdijshëm që zbatimi i politikës penale është kompetencë e organeve të drejtësisë, por ne kemi ardhur në dijeni të përvojave më të mira botërore, të cilat tregojnë se një politikë penale, që synon uljen e kriminalitetit është më efektive, nëse përdoren më mirë masat parandaluese, përdoret drejtësia restauruese dhe zgjerohet zbatimi i dënimeve alternative me burgimin. Në këtë drejtim mendojmë se, krahas masave të tjera, duhen informuar e sensibilizuar, veçanërisht, gjyqtarët e prokurorët. Strukturat e pushtetit gjyqësor, ekzekutiv dhe atij legjislativ duhet të bashkëpunojnë për përmirësimin e një situatë të tillë të rënduar, e cila sjell pasoja si për shtetasit e dënuar, personelin e burgjeve edhe për shoqërinë në tërësi.

Kushtet e jetesës në institucionet e sistemit shqiptar të burgjeve

- KShH vlerëson masat e marra gjatë fundvitit 2014 nga DPB për sistemimin e të miturve dhe grave të paraburgosura , përkatësisht në IVM Kavajë dhe IEVP “Ali Demi” Tiranë. Po ashtu, transferimi i të paraburgosurve të IP Tropojë në mjediset e institucionit të ri të Tropojës, si dhe marrja e masave për të mbyllur së shpejti IP Kukës dhe për ta kaluar në një ndërtesë më të përshtatshme janë hapa të rëndësishëm për të sjellë trajtim të përshtatshëm për shtetasit e paraburgosur. Këto hapa të ndërmarrë kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e trajtimit të të paraburgosurve dhe grupeve të veçanta si të miturit dhe gratë. Gjithashtu, ato kanë kontribuar në rritjen e bashkëpunimit mes sistemit të burgjeve dhe strukturave të policisë së Tiranës për transferimin e personave që kanë marrë masën “Arrest me burg” nga gjykata.
- Megjithatë, KShH ka kontaktuar problematika të qënësishme të kushteve të jetesës në institucionet e vëzhguara, të prezantuara më gjerësisht në pikën 3.2 në këtë raport. Si një aspekt i rëndësishëm i arritjes së standardeve të trajtimit, KShH sugjeron që të merren masa konkrete për përmirësimin e kushteve të jetesës në institucionet me këtë problematikë. Për këtë qëllim, nevojitet rritja e burimeve financiare dhe për këto institucione nga buxheti i shtetit.
- Gjithashtu, po e njëjta rëndësi i duhet dhënë mirëmbajtjes së mjediseve të regjimeve të brendshme të institucioneve, përpos asaj të jashtme. Nevojitet të rritet kujdesi për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë nëpër sektorë dhe në ambientet e realizimit të aktiviteteve sportive, ajrimit etj..
- Duhet të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të drejtuesve të institucioneve lloji/cilësia e ushqimit që i ofrohet të burgosurve, nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme që duhet të realizojnë në kuzhinat e institucioneve të tyre. Në vëmendjen e tyre duhet të jenë gjithashtu njësitë tregëtare në institucione sa i takon asortimenteve që tregtojnë dhe çmimeve përkatëse për asortiment, që t’i japin fund abuzimeve të mundshme me cilësinë dhe çmimet e tregtuara.
- KShH dëshiron të theksojë nevojën e menjëhershme të ndërhyrjes për të përmirësuar situatën e higjienës në mjediset e tualeteve dhe dusheve të përbashkëta. Mungesa e ujit ose ardhja me orar e tij në disa institucione të përmendura në f.28 të këtij raporti, si dhe mungesa e detergjenteve pastrues dhe higjienizues, rëndonin edhe më shumë gjendjen e konstatuar në disa institucione. Së bashku me situatën e mbipopullimit, efekti kumulativ i të cilit rëndon situatën, duke sjellë pasoja të dëmshme të shëndetit të të burgosurve dhe për më tepër çon në trajtim degradues të këtyre shtetasve.
- KShH dëshiron të evidentojë edhe një herë rëndësinë thelbësore që ka infrastruktura e institucioneve të burgjeve në realizimin e misionit që ka në vetvete sistemi i burgjeve shqiptare. Nevojitet që kjo situatë të ndryshojë sa më parë, duke mbajtur parasysh se kushtet siç ekzistojnë sot në një pjesë të konsiderueshme të

institucioneve të paraburgimeve dhe burgjeve, në vetvete, përbëjnë bazë për trajtim ç'njerëzor të të burgosurve.

Siguria dhe të ndjerit të sigurt

- KShH sugjeron që drejtuesit e DPB dhe të institucioneve vendore penale të synojnë drejt krijimit të një klime të mirë dhe të sigurt, ku si shtetasit e paraburgosur dhe ata të dënuar nga njëra anë dhe personeli nga ana tjetër, duhet të bashkëjetojnë dhe bashkëpunojnë në kushtet ku të gjithë të ndihen të sigurt. Kjo është baza e një funksionimi të mirë të institucionit që parandalon situata dhe incidente të rënda. Komunikimi i mirë dhe profesional mes personelit dhe të burgosurve dhe siguria dinamike përbëjnë bazën e klimës së sigurt në një institucion.

E drejta e kërkesës dhe e ankesës

- KShH vlerëson përgjithësisht në mënyrë pozitive situatën e konstatuar të menaxhimit të sistemit të kërkesë-ankesave. Edhe një herë dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj që gjithë institucionet penale të garantojnë përdorimin e udhëzuesit admisnitrativ për trajtimin e kërkesë ankesave të personave të paraburgosur dhe atyre të dënuar..

Trajtimi i të dënuarve. Rehabilitimi dhe riintegrimi; individualizimi i dënimit; programi ditor

- KShH vlerëson ndjeshmërinë në rritje për kujdes ndaj larmishmërisë së aktiviteteve ditore të ofruara në paraburgime/burgje. Me ndryshimet e fundit të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve, KShH sugjeron që t'i jepet prioritet realizimit të programeve të individualizuara të trajtimit, gjë që nga monitorimi rezultoi të mbetej ende larg realizimit në praktikë. KShH tërheq vëmendjen e autoriteteve të burgjeve që të burgosurit nuk mund të lihen të mbyllur në dhomat e tyre për një kohë të gjatë. Gjithashtu, KShH sugjeron që veprimtaritë në institucione të mos përfundojnë brenda orës 16.00, apo edhe më shpejt në shumë institucione të vëzhguara. Çdo institucion inkurajohet të vlerësojë mundësitë konkrete dhe nevojat specifike të grupeve të veçanta për të zgjatur dhe bërë më të larmishëm e kuptimplotë programin ditor..
- KShH edhe një herë sugjeron thjeshtësimin e dosjeve psiko-sociale dhe futjen e disa instrumenteve konkretë të vlerësimit të ecurisë për personat me probleme të shëndetit mendor⁴⁹. Në vijim të këtyre sugjerimeve, KShH gjithashtu vlerëson

⁴⁹ Gjatë komunikimeve zyrtare me DPB-në, është ofruar sugjerime dhe instrumente konkrete relevante.

përpjeket e DPB-së për të futur si pjesë e dosjeve psiko-sociale instrumente vlerësimi në përputhje me specifikat e personave të paraburgosur dhe të dënuar si edhe përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar shërbimet me natyrë trajtuese dhe ri-integruese të të burgosurve duke shtuar larmishmërinë e aktiviteteve të qenësishme në institucionet e paraburgimeve dhe burgjeve.

Kujdesi shëndetësor

- Ndër problematikat më të mprehta sa i takon këtij shërbimi, është çështja e furnizimit me ilaçe të institucioneve penitenciare. Në të gjitha institucionet e monitoruara (*përveç QSB dhe institucionit në Zahari, Krujë*) vëreheshin mungesa në medikamente. Ndaj, KShH sugjeron një rishikim të mënyrës së funksionimit të këtij shërbimi të rëndësishëm, për garantimin e një të drejte ligjore themelore që kanë të burgosurit.
- KShH sugjeron gjithashtu krijimin e mundësive motivuese për të nxitur mjekët për të punuar në institucione ku ka nevojë për shtim personel mjekësor. Gjithashtu, KShH sugjeron gjetjen e mundësive për të pajisur institucionet me mjetet e domosdoshme për realizimin e ekzaminive bazë, si dhe me auto-ambulanca.
- Duke pasur parasysh se pranë IEVP/IP ka sektorë të kujdesit të veçantë ku trajtohet përkohësisht personat me probleme të lehta të shëndetit mendor, sugjerojmë që Ministria e Shëndetësisë të japë kontribut të vazhdueshëm konform dispozitave ligjore përkatëse në institucionet ku ka persona me probleme të shëndetit mendor.
- Sugjerohet që në sektorët e kujdesit të veçantë të cilat janë ngritur gjatë vitit 2014 në disa institucione penale të konsolidohet kjo praktikë e mirë përmes zgjerimit të dijeve të marra gjatë trajnimeve vazhduese për çështjet e shëndetit mendor, përdorimit të instrumenteve vlerësues, planeve të dënimit individual dhe planeve të udhëzimit individual për personat që trajtohen në këta sektorë.

Politikat disiplinore në institucionet e paraburgimit e burgje

- KShH rithekson faktin që masa disiplinore nuk duhet të përdoret si një mjet frikësimi apo për të treguar pushtet nga ana e personelit të burgjeve mbi të burgosurit, por si një mjet ligjor që zbatohet sipas procedurës së bazuar në ligj. Po aq rëndësi ka edhe dokumentacioni që shoqëron këtë procedurë. KShH vëren një ndër-gjegjësim të personelit të institucioneve në lidhje me zbatimin e duhur të politikës disiplinore.

- Megjithatë, sa i takon këtij aspekti, KShH dëshiron të sugjerojë që institucionet të tregojnë kujdes më të shtuar kundrejt kushteve higjieno-sanitare dhe pajisjeve të këtyre mjediseve të banimit, me gjithçka nevojitet të kenë. Veçimi i këtyre personave në vetvete është pjesë e ndëshkimit, ndaj brenda standardeve të vendosura nga ligji, duhet që të tilla mjedise të përmbushin kërkesat ligjore të hapësirës, dritës, pajisjeve të nevojshme, higjienës etj..
- KShH sugjeron gjithashtu që, kundrejt personave që gjenden në veçim të ketë kujdes nga personelit mjekësor dhe ai psiko-social, sikurse ligji e kërkon, nëpërmjet takimeve të përditshme.
- KShH shpreh shqetësim për sigurinë dhe të ndjerit të sigurt të të burgosurve të cilët, më së shumti për arsye sigurie, dhe me miratimin e tyre, qëndronin në këto dhoma për një kohë relativisht të gjatë. KShH sugjeron edhe një herë që nga ana e DPB-së dhe IP/IEVP-ve të vëzhguara, të bëhet një punë më e mirë e personelit me uniformë dhe personelit të kujdesit psiko-social me këta persona, që të evitohet sa të mundet qëndrimi i tyre në dhomat e veçimit.
- KShH tërheq vëmendjen që ndaj të miturve dhe ndaj personave me probleme të shëndetit mendor ky mjet disiplinimi duhet të përdoret si masë e fundit pasi janë ezauruar të gjitha mjetet e tjera të këshillimit dhe masat pedagogjike. Nëse këta persona vihen në dhomë veçimi si masë disiplinore, duhet të synohet nga ana e personelit të burgjeve mbajtja sa më pak në kohë e tyre në këto mjedise. Ka tashmë një udhëzues administrativ që rregullon procedurën disiplinore për të miturit dhe për personat me probleme të shëndetit mendor. Thënë këtë, KShH sugjeron që gjithë personeli i burgjeve të njihet dhe të trajnohet në vazhdimësi për zbatimin korrekt të këtyre politikave disiplinore.
- Po ashtu, KShH sugjeron që DPB-ja të marrë në konsideratë mënyrën e ushtrimit të kontrollit nga strukturat e DAP-it në DPB, në raste ankesash nga të burgosurit për ushtrim dhune ndaj tyre gjatë kontrollit. KShH ka shprehur shqetësimin e ngritur nga të burgosurit nëpërmjet komunikimeve zyrtare edhe më herët, ndaj sugjeron që të tilla sjellje të ndërpriten dhe në rast verifikimi të rasteve të përdorimit të dhunës, të merren masa administrative dhe/ose penale, kundrejt personave përgjegjës.

Lejet shpërblyese dhe ato të veçanta

- KShH ka marrë ankesa nga të burgosurit sa i takon proceduarave të zbatuara nga drejtuesit e institucioneve të burgjeve, me pretendime të ngritura për korrupsion kundrejt personelit, apo për vonesa procedurash dhe moskthim përgjigjesh nga zyrat juridike të institucioneve penitenciare. Ndaj, sugjerojmë që të tilla pretendime të rrisin vëmendjen e DPB-së dhe institucioneve penitenciare kundrejt problematikës së parashtruar, duke i shkuar verifikimeve efektive deri në fund

dhe marrjen e masave për parandalim dhe vënien përpara drejtësisë së personave që verifikohen të kenë kryer veprën penale të korrupsionit..

- KShH vlerëson faktin që DPB udhëzon institucionet vartëse për të vlerësuar, rast pas rasti, dhënien e lejeve shpërblyese, duke theksuar se lejet shpërblyese duhet të meritojnë në bazë të sjelljes së mirë të të dënuarve kur këta të fundit përmbushin edhe detyrimet e tjera të përcaktuara në ligj. Por, nga ana tjetër, KShH sugjeron që Letër-Porosia (shih pikën 3.8 të raportit) e DPB-së drejtuar gjithë institucioneve penale duhet rishikuar në frymën që të mos lërë hapësirë për të marrë vendime apriori duke përjashtuar nga dhënia e lejeve shpërblyese të dënuar të cilët kanë kryer disa vepra penale të cilët citohen në këtë Letër-Porosi. KShH sugjeron që vendimet të bazohen mbi kriteret ligjore, të zbatohen me profesionalizëm dhe pa diskriminim..
- Sa i takon lejeve të veçanta, KShH mendon se kompetenca e vlerësimit të situatës shëndetësore të familjarëve të të dënuarve duhet të mbetet përgjegjësi e mjekëve të shërbimit shëndetësor publik, i cili e përgatit dokumentacionin mbi bazë të ekzaminimit direkt të pacientit. Personeli mjekësor i I EVP-ve e ka të pamundur për ta kryer këtë verifikim.. KShH i është drejtuar MD-së dhe DPB-së nëpërmjet letrave zyrtare për rishikim të aktit përkatës nënligjore të nxjerrë nga MD.

Punësimi

- KShH përshendet nismat e fundit të DPB-së sa i takon krijimit të mundësive reale për punësimin e të burgosurve. Megjithatë, aktualisht në institucionet e burgjeve ka një numër të vogël të dënuarish në raport me numrin e përgjithshëm të të burgosurve për institucion që gjenden të angazhuar në veprimtari punësimi
- Gjithashtu konstatohet se ende është në zbatim ligji i vjetër sa i takon mënyrës së shpërblimit të punës së të dënuarve, dmth 3.9 ditë në muaj i zbritej dënimit të tyre. KShH dëshiron të nxisë përshpejtimin e vënies në zbatim të detyrimeve ligjore të pagesës së punës sipas standardeve të vendosura në ligj, si dhe për gjetjen e formave të larmishme të punësimit të të burgosurve. KShH së fundmi ka ofruar sugjerime lidhur me projekt-VKM për punësimin dhe shpërblimin e të dënuarve dhe shpreson që sugjerimet e ofruara të merren parasysh nga MD dhe autoritetet ligjvënëse.

Trajtimi i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor

- KShH përshendet hapat e ndërmarrë nga DPB-ja sa i takon hapjes së sektorëve të kujdesit të veçantë në pesë burgje si në I EVP Lezhë, IP Elbasan, IP Berat (institucionin e ri), IP Durrës, I EVP Korçë, në IP “Jordan Misja” Tiranë dhe I EVP Peqin, si nismë pilote. KShH inkurajon DPB-në që të mbikëqyri dhe mbështesë në vazhdimësi personelin e këtyre institucioneve në mënyrë që të konsolidojnë këtë

përvojë të re për burgjet shqiptare. KShH, përmes korrespondencës zyrtare me DPB-në dhe IP/IEVP ku janë hapur tashmë këta sektorë, ka ofruar disa sugjerime për marrjen e masave organizative dhe përmbajtësore në lidhje me trajtimin e diferencuar e sipas nevojave për këtë kategori të burgosurish.

- Po ashtu, në vijim të bashkëpunimit dhe ngritjes së kapaciteteve të personelit të sistemit shqiptar të burgjeve, KShH po realizon trajnime të personelit të IEVP/IP-ve për t'i mbështetur profesionalisht ekipet multi-disiplinore për realizimin e detyrës, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve ndihmues për vlerësimin individual të të paraburgosur/dënuarve me probleme të shëndetit mendor si edhe për hartimin e planeve fillestare të trajtimit dhe planeve të udhëzimit të trajtimit në vazhdimësi për këta persona. KShH sugjeron që këto instrumente të bëhen pjesë e praktikës së punës së përditshme me këta pacientë në IEVP.
- Pavarësisht nismës së mirë të ndërmarrë, KShH sugjeron që ndaj këtyre të sëmurëve të tregohet kujdes i vecantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave të qëndrimit, ndaj higjienës së varfër vetiake, të shtrojave personale dhe të mjediseve rrethuese. Në të njëjtën kohë, shërbimi shëndetësor i ofruar duhet të përmirësojë cilësinë e mjekimeve të ofruara, dhe të vizitave mjekësore periodike kundrejt këtyre pacientëve.
- Një tjetër problem tejet shqetësues mbetet mbajtja e personave me vendim gjyqësor me masë "Mjekim të detyrueshëm" dhe "Shtrim të përkohshëm" të cilët mbahen aktualisht në IEVP Krujë dhe QSB në shkelje flagrante me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Rezulton se, në harkun kohor të rreth 10 viteve të fundit, numri i personave që kanë marrë nga gjykata masën "Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor" është dyfishuar. KShH ka konstatuar se 148 persona me masë mjekësore, në kundërshtim me ligjin dhe nevojat e tyre për kurim, janë dërguar nga prokurorët për të kryer masën mjekësore, të dhënë nga gjykata, pranë IEVP, ku shumë prej këtyre personave qëndrojnë padrejtësisht në burgje për më shumë se 10 vjet. Kjo situatë ka cenuar rëndë të drejtat e tyre, sepse nuk kanë marrë mjekimin e përshtatshëm, gjë që ka shkaktuar përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore, si dhe u është kufizuar e drejta e lirisë tej masës së parashikuar në ligj. Prania e kësaj kategorie e shtetasve në burgje është një situatë e kundraligjshme, që vjen në kundërshtim me legjislacionin që rregullon funksionimin e këtyre institucioneve, si dhe ndikon në mbipopullimin artificial të burgjeve dhe përkeqësimin e klimës në këto institucione. Në këto rrethana, KShH po ndjek në rrugë gjyqësore disa raste të tilla flagrante, duke kërkuar ndërprerjen e trajtimit çnjerëzor të këtyre personave të mbajtur në burgje, ka kërkuar si të kundraligjshëm ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga prokurorët e çështjeve konkrete të cilët i vendosin këta persona në burgje dhe njëkohësisht është kërkuar edhe dëmshpërblimi civil i këtyre personave ashtu siç parashikohet në ligj.

- Në këtë situatë, KShH i bën edhe një herë thirrje të gjithë institucioneve shtetërore relevante të gjejnë zgjidhje të shpejta dhe efektive për të vënë në vend cenimin flagrant dhe të vazhdueshëm të të drejtave të këtij grupi në pozita të dobëta të shoqërisë. KShH sugjeron vënien në punë të sektorëve të veçantë të institucioneve mjekësore (psh. tek spitali psikiatrik), nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat e MD për çështje të sigurisë së jashtme. Kjo situatë do të mund të zgjidhë paligjshmërinë vazhduese të mbajtjes së këtyre personave në burgje, derisa të gjendet një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme.

Trajtimi i të miturve

- KShH vlerëson hapat pozitivë të ndërmarrë nga DPB për transferimin e të miturve të paraburgosur të IP "Jordan Misja" Tiranë për në IVM Kavajë. Po ashtu vlerëson qasjen e përgjithshme që kanë institucionet ku ka të mitur për një kujdes të shtuar ndaj tyre, qoftë sa i takon arsimimit dhe formimit të tyre profesional, qoftë sa i takon larmishmërisë së aktiviteteve që iu ofrohen të miturve në burgje.
- Megjithatë, bazuar në gjetjet e monitorimeve, KShH dëshiron të sugjerojë për më shumë vëmendje sa i takon problemeve që lidheshin me higjienën në disa prej dhomave/mjediseve të qëndrimit të të miturve. Për të përmirësuar gjendjen sa i takon këtij aspekti, KShH sugjeron të vihen objektiva konkrete, në planin individual të dënimit të gjithsecilit të mitur dhe më tej të punohet nga të gjithë sektorët për arritjen e këtyre objektivave. Arritjen e këtyre objektivave do ta ndihmonte rivënia në punë e teknikës së formateve të aftësive sociale, një teknikë tejet praktike dhe e dobishme për t'i aftësuar të miturit të fitojnë disa aftësi sociale për përkujdesin ndaj vetes dhe të bashkëjetesës në komunitet.
- Me rëndësi për këtë grupmoshë në konflikt me ligjin, merr rëndësi përfshirja e familjarët/të afërmeve të të miturve në procesin e hartimit të planit individual të dënimit, si dhe në vijimësi të trajtimit të të miturve në institucionet ku mbahen të miturit.
- KShH dëshiron të ritheksojë edhe një herë rëndësinë që ka ndalimi (mos) përdorimi i duhanit nga të miturit, thujse në të gjitha mjediset e qëndrimit të tyre. Ndonëse në mure ishin prezent shenja që njoftonin ndalimin e përdorimit të duhanit, sikurse ligji e kërkon, faktikisht në këto sektorë pihej duhan gjithandej. KShH sugjeron që drejtuesit e institucioneve që trajtojnë të miturit, të marrin hapa/masa konkrete, për të iniciuar dhe çuar deri në fund zbatimin e ligjit Nr. 76/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar.
- Po ashtu, zbatimi i politikës disiplinore me të mitur kërkon më së pari, zbatimin e masave edukuese/pedagogjike, sikurse është udhëzuar edhe nga sektori i

problemeve shoqërore në DPB në përputhje me udhëzuesin administrativ për politikat disiplinore për të miturit. KShH sugjeron trajnime të vazhdueshme të personelit që punon me të miturit me këtë udhëzues për të pasur një kuptueshmëri të njëjtë dhe realizim korrekt të tij në praktikë nga gjithë personeli me uniformë dhe ai civil.

- Vlen të evidentohet se nëpërmjet një Urdhri të DPB, i cili kufizonte kohë për realizimin e veprimtarive gjatë pasditeve, të miturit nuk përfitonin kohën e përcaktuar në ligj për ajrim. Për këtë, KShH sugjeron marrjen e masave të menjëhershme për të rivënë në vend të drejtën e cenuar.
- Për të gjithë të miturit që qëndrojnë në institucione të tilla, duhet të ofrohet kujdes i njëjtë, pa diskriminim, në kuptimin e respektimit të të drejtave të gjithsecilit në mënyrë të barabartë.

Trajtimi i grave

- KShH përshëndet vendimin e marrë nga DPB për të grupuar në një institucion të vetëm të mbajtjes së grave dhe vajzave të paraburgosura/dënuara. Trajtimi i tyre në një institucion të vetëm do të sjellë standardizim të trajtimit, si dhe do të mundësojë më shumë shërbime specifike për këtë grup në nevojë. Gjithashtu KShH inkurajon DPB që të ndër marrë hapa konkretë për ndërtimin e një institucioni të ri ku të akomodohen gratë e paraburgosura /dënuara, sepse IEVP 'Ali Demi' ka një infrastrukturë shumë të vjetruar dhe me probleme të ndryshme që ndikojnë negativisht në kushtet e jetesës për gratë në burgje.
- KShH sugjeron rishikimin e udhëzimit të DPB-së për lejimin në institucion vetëm të TV të rinj, të blerë nga familjarët e të burgosurve, të cilët, bazuar në nivelin ekonomik familjar, mund të vihen në vështirësi ekonomike për të bërë të mundur blerjen. Për më tepër, ky fakt çon në cenimin e aksesit të barabartë tek informacioni përmes krijimit të premisave jo të barabarta bazuar në kushtet ekonomike të ndryshme që kanë gratë dhe të burgosurit në përgjithësi në këtë drejtim.
- KShH inkurajon punonjësit që punojnë me gratë në IEVP/IP të njihen nga afër me dispozitat e reja ligjore, për të përmbushur kërkesat e ligjit sa më mirë në raport me specifikat e trajtimit të grave. Hartimi i planeve individuale të dënimit duhet të hartohen në konsultim me gratë e burgosura si dhe duhet të reflektojnë hapat konkretë/specifikë të punës së realizuar për arritjen e objektivave. Gjithashtu, programet e përgatitjes për lirim të tyre duhet të fillojë që me ditën e parë kur ato vendosen në paraburgim dhe duhet të realizohen në bashkëpunim me struktura të tjera të kujdesit të shërbimeve sociale dhe punësimit në nivel vendor dhe rajonal.

- Kohëzgjatja e qëndrimit të grave në pritje të vendimit të formës së prerë dhënë nga gjykata, në shumë raste ishte e gjatë. Kohëqëndrimi i tyre në paraburgim varionte nga 14 muaj deri në 2 vjet. Po ashtu, KShH mori ankesa për profesionalizëm të ulët të avokatëve të caktuar kryesisht, si edhe për takimet e rralla ose të munguara me prokurorët e çështjeve të tyre penale. KShH i sugjeron drejtuesve të strukturave gjyqësore dhe atyre të prokurorisë të ndërmarrin inspektime/kontrolle të vazhdueshme sa i takon çështjeve të lartpërmendura për të garantuar në mënyrë të plotë të drejtat procedurale që kanë gratë në procesin penal.

Të tjera

- KShH, së fundmi dëshiron të nënvijëzojë edhe një herë rëndësinë e bashkëpunimit midis sektorë të ndryshëm të punës në burgje. Fryma bashkëpunuese brenda IEVP-ve dhe IEVP-ve dhe DB-së është faktor kyç për krijimin e një klime të mirë pune dhe për mundësi zhvillimi profesional të punonjësve të burgjeve. Në vijim, qëndrueshmëria në punë e punonjësve është element i domosdoshëm për përmbushjen me cilësi dhe profesionalizëm të detyrave funksionale të tyre.

SHTOJCAT

Shtojca Letra dërguar autoriteteve shtetërore

- Shkresë Nr. Prot 121, datë 06.05.2014 drejtuar Z.Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shetit, për trajnimet e punonjësve të policisë organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- Shkresë Nr. Prot 181, datë 26.06.2014 drejtuar Z.Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shetit, mbi trajnimet e strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me kuptimin dhe parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues.
- Shkresë Nr. Prot 182, datë 26.06.2014 drejtuar Z.Saimir Tahiri, Ministër i Punëve të Brendshme, mbi trajnimet e strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me kuptimin dhe parandalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues
- Shkresë Nr. Prot 121, datë 08.07.2014 drejtuar Z.Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shetit, për trajnimet e punonjësve të policisë organizuar nga Komiteti Shqiptar I Helsinkit.

- Shkresë Nr.Prot 210, datë 08.07.2014 drejtuar Z.Artur Zoto, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Burgjeve, lidhur me vëzhgimin në Institucionet e Ekzekutimeve Penale të Peqinit dhe Lezhës.
- Shkresë Nr. Prot 211, datë 08.07.2014 drejtuar Z.Kanto Ndoj, Drejtor i IEVP Lezhë, lidhur me vëzhgimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të Lezhës.
- Shkresë Nr. Prot 212, datë 08.07.2014 drejtuar Z.Fatos Veliu, lidhur me vëzhgimin në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale të Peqinit.
- Shkresë Nr. Prot 253 datë 31.07.2014, drejtuar z.Nasip Naço, Ministria e Drejtësisë, mbi nevojën e diskutimit rreth pengesave për transferimin, brenda afateve ligjore, të personave të arrestuar në IEVP-të përkatëse.
- Shkresë Nr. Prot 335 datë 09.10.2014, drejtuar z.Alfred Çepo, Shef i Komisarariatit Gjirokastër, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Vlorë dhe Gjirokastër.
- Shkresë Nr.Prot 336 datë 09.10.2014, drejtuar z.Agim Basha, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Vlorë.
- Shkresë Nr. Prot 337, datë 09.10.2014 drejtuar Z.Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shetit, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Nr.5 Tiranë dhe Komisariatin Tropojë.
- Shkresë Nr.Prot 338, datë 09.10.2014, drejtuar z.Preng Laska, Shef i Komisarariatit Tropojë, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Tropojë.
- Shkresë Nr. Prot 339, datë 09.10.2014, drejtuar z.Fatmir Lleshaj, Shef i Komisarariatit Nr.5 Tiranë, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Nr.5 Tiranë.
- Shkresë Nr. Prot 340, datë 09.10.2014 drejtuar Z.Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shetit, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Sarandë.
- Shkresë Nr. Prot 341, datë 09.10.2014, drejtuar z.Arianit Arapi, Shef i Komisarariatit Sarandë, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Sarandë.
- Shkresë Nr. Prot 386, datë 21.12.2014, drejtuar z. Nasip Naço, Ministër i Drejtësisë, lidhur me disa aspekte të vërejtura gjatë vëzhgimeve të kryera në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale.
- Shkresë Nr. Prot 379, datë 12.11.2014, drejtuar z. Avni Sulaj, Drejtor i IEVP Tepelenë, lidhur me disa aspekte të vërejtura gjatë vëzhgimit të kryer në IEVP Tepelenë.

- Shkresë Nr. Prot 378, datë 12.11.2014, drejtuar Z. Përparim Daiu, Drejtor i IVM Kavajë, lidhur me disa aspekte të vërejtura gjatë vëzhgimit të kryer në IVM Kavajë.
- Shkresë Nr. Prot 376, datë 11.11.2014, drejtuar z. Artur Zoto, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, lidhur me disa aspekte të vërejtura gjatë vëzhgimeve të kryera në IEVP Tepelenë dhe IVM Kavajë.
- Shkresë Nr. Prot 419, datë 05.12.2014, drejtuar z.Xhezair Zaganjori, Kryetar i Gjykatës së Lartë, lidhur me situatën e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit, të burgimit dhe komisariatet e policisë.
- Shkresë Nr. Prot 418, datë 05.12.2014, drejtuar z.Adriatik Llalla,Prokuror i Përgjithshëm, lidhur me situatën e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit, të burgimit dhe komisariatet e policisë.
- Shkresë Nr. Prot 417, datë 05.12.2014, drejtuar z.Nasip Naço, Ministër i Drejtësisë, lidhur me situatën e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit, të burgimit dhe komisariatet e policisë.
- Shkresë Nr. Prot 416, datë 05.12.2014, drejtuar z.Edi Rama, Kryetar i Këshillit të Ministrave, lidhur me situatën e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit, të burgimit dhe komisariatet e policisë.
- Shkresë Nr. Prot 415, datë 05.12.2014, drejtuar z.Bujar Nishani, President i Republikës së Shqipërisë, lidhur me situatën e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit, të burgimit dhe komisariatet e policisë.
- Shkresë Nr. Prot 414, datë 02.12.2014, drejtuar z.Artan Didi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, lidhur me vëzhgimin në Komisariatin e Policisë Berat dhe Lushnje
- Shkresë Nr. Prot 413, datë 04.12.2014, drejtuar z.Artur Zotot, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, lidhur me disa aspekte të vërejtura gjatë vëzhgimit të kryer në IEVP Berat.
- Shkresë Nr. Prot 387, datë 21.12.2014, drejtuar z.Artur Zotot, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, lidhur me disa aspekte të vërejtura gjatë vëzhgimeve të kryera në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale.